












# 2019 Raporti Vjetor



# AKEP


AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

[www.akep.al](http://www.akep.al)





# RAPORTI VJETOR 2019



**AKEP**

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

# TABELA E PËRMBAJTJES



<b>1. FJALA E KRYETARIT TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE</b>	<b>5</b>
<b>2. KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR</b>	<b>9</b>
2.1. Referencat në ligjet mbi të cilat mbështetet veprimtaria e institucionit	9
2.2. Ndryshimet e kuadrit ligjor	9
<b>3. INTEGRIMI EVROPIAN</b>	<b>11</b>
3.1. Implementim i detyrimeve që burojnë nga aktet ndërkombëtare	11
3.2. Kontributi në kuadrin e Integrimit Evropian	11
<b>4. ZHVILLIMET E TREGUT</b>	<b>14</b>
4.1. Tregu i komunikimeve elektronike	14
4.2. Vendimmarrjet lidhur me tregun e komunikimeve elektronike dhe masat rregullatore përgjatë vitit 2019	31
4.3. Tregu postar	37
<b>5. SISTEMI I AUTORIZIMEVE, ADMINISTRIMI I FREKUENCAVE DHE DOMAIN-EVE</b>	<b>41</b>
5.1. Regjimi i Autorizimit të Përgjithshëm	41
5.2. Autorizimet Individuale	43
5.3. Administrimi i domain-it “.al”	47
5.4. Autorizimet, licensat dhe certifikatat për shërbimet ajrore/detare etj	48
<b>6. INSPEKTIMI DHE MONITORIMI</b>	<b>49</b>
6.1. Inspektimi i sipërmarrësve të komunikimeve elektronike	49
6.2. Inspektimi i ofruesve të shërbimeve postare	53
6.3. Monitorimi i spektrit të frekuencave	54
<b>7. MBROJTJA E KONSUMATORIT</b>	<b>59</b>
7.1. Rregullimi i roamingut ndërkombëtar me Republikën e Kosovës dhe vendet e Ballkanit Perëndimor	59
7.2. Rregullorja e Mbrojtjes së Konsumatorit	65
7.3. Trajtimi i ankesave të përdoruesve	66
<b>8. RAPORTI PËR STATUSIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL</b>	<b>69</b>
8.1. Statusi i Shërbimit Universal për komunikimet elektronike	69
8.2. Statusi i Shërbimit Universal Postar	71
<b>9. STATUSI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE</b>	<b>75</b>
9.1. Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të RSH	75
9.2. Rekomandime të dhëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit	77
9.3. Rekomandime të dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës	88
<b>10. BASHKËPUNIMI ME ENTE TË TJERA RREGULLATORE DHE INSTITUCIONE PUBLIKE</b>	<b>91</b>
<b>11. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL</b>	<b>93</b>
<b>12. REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË</b>	<b>95</b>
<b>13. PROCESET GJYQËSORE</b>	<b>99</b>
<b>14. MARRJA E MASAVE PËR SIGURINË E RRJETEVE DHE\OSE SHËRBIMEVE</b>	<b>101</b>
14.1. Sistemi i përqendruar i informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike (ATLAS)	102
<b>15. FUSHAT KRYESORE DHE PRIORITETET STRATEGJIKE TË AKEP PËR VITIN 2020</b>	<b>107</b>
<b>ANEKS 1</b>	<b>108</b>
Raport lidhur me nivelin e zbatimit të rezolutës dhe rekomandimeve të Kuvendit të RSH për AKEP për vitin 2019	108
<b>ANEKS 2</b>	<b>126</b>
Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP për vitin 2019	126

○ **Tomi Frashëri**  
Kryetar i AKEP



# 1.

## **FJALA E KRYETARIT TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Kuvendit të Shqipërisë i dorëzohet sot Raporti vjetor i veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2019.

Ky moment përfaqëson për AKEP jo vetëm përmbushjen e një detyrimi ligjor, por edhe mundësinë për të përmirësuar gjithmonë e më shumë komunikimin, llogaridhënien dhe shprehjen e përgjegjshmërisë ndaj autoritetit që kornizon pavarësinë e institucioneve dhe demokracinë përfaqësuese në Republikën e Shqipërisë.

Raporti vjetor i AKEP, në përputhje me kërkesat ligjore, paraqet një pasqyrë të qartë të veprimtarisë së institucionit për vitin 2019.

Kjo veprimtari është udhëhequr, gjatë vitit pararendës, nga angazhimi maksimal për jetësimin dhe përmbushjen e disa detyrave parësore, si:

- Zbatimi i detyrimeve dhe jetësimi i objektivave rregullatore të përcaktuar në legjislacionin material;
- Mbështetja ndaj zhvillimit të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave;
- Ndjekja e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi;
- Harmonizimi me direktivat e Komisionit dhe Parlamentit Evropian si dhe standardizimi i punës në përputhje me aktet rregullatore të organizmave ndërkombëtarë si BEREC, ERGP, ITU etj.

Në këtë kuadër, AKEP i ka kushtuar, gjatë vitit të kaluar, një vëmendje të posaçme zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi përmes Rezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2018”. Institucioni është përpjekur t’i përmbushë këto rekomandime me rigorozitet dhe ka informuar Kuvendin se ndërkohë që 2 prej tyre nuk janë realizuar ende, 2 të tjera janë realizuar pjesërisht dhe pjesa dërrmuese, 12 rekomandime, janë përmbushur plotësisht.

Gjithashtu dhe në të njëjtën mënyrë, gjatë vitit 2019, puna ka vazhduar për implementimin e katër orientimeve kryesore strategjike të AKEP:

- krijimi i kushteve të favorshme për investime të qëndrueshme;
- nxitje e konkurrencës së ndershme dhe të lirë në treg;
- promovim i të drejtave të pajtimtarëve dhe përdoruesve të komunikimeve dhe shërbimeve elektronike;
- përforcim i efikasitetit në mirëfunksionimin e brendshëm të institucionit dhe i partneritetit ndërinstitucional, brenda dhe jashtë vendit.

Implementimit të këtyre katër orientimeve apo shtyllave strategjike, një përmbledhje e të cilave parashtrohet në vijim, AKEP i është përkushtuar me të gjithë mjetet ligjore dhe materiale që disponon. Megjithatë, nuk do të ishte me vend t'i shmangeshim faktit që tërësia e këtyre mjeteve shfaq, 12 vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit 9918/2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", caqet e veta.

AKEP, sikundër edhe kuadri ligjor i cili e përligj, e udhëheq në veprimtarinë e vet dhe e pajis me instrumentat e duhur për të përmbushur misionin e tij specifik, shfaqin nevojën e domosdoshme për një evoluim organik të përhershëm, me fjalë të tjera një reformë strukturore domethënëse. Fusha e veprimtarisë së tij, e cila gjithmonë e më shumë po shndërrohet në platformën kryesore të ndërveprimit të shoqërisë njerëzore, kërkon kapacitete përshtatjeje dhe ripërtëritje funksionale në kohë reale, sa më pak burokraci administrative dhe sa më shumë zhdërvjelltësi në menaxhimin e çështjeve teknologjike, ekonomike dhe juridike që karakterizojnë sektorin e komunikimeve elektronike dhe atë të shërbimeve postare.

Në kushtet kur ka filluar implementimi i Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike në vendet e BE, proces që do të shtrihet në gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor, kur vendi ynë po përballet me sfidën e hapjes ndaj teknologjive të brezit të 5-të (5G) dhe në momentin kur kriza sanitare madhore, si ajo e COVID-19, po përshpejtojnë digjitalizimin e marrëdhënieve sociale dhe profesionale, AKEP gjykon të sjellë në vëmendjen e Kuvendit dhe të aktorëve të tjerë institucionalë dhe sektorialë, nevojën mjaft emergjente të rishikimit dhe përditësimit të dispozitivit ligjor dhe material që siguron dhe garanton të tashmen dhe të ardhmen e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.

AKEP dhe organet e tij drejtuese shprehin vullnetin dhe gatishmërinë e tyre të plotë për ta kthyer momentin e dorëzimit të këtij Raporti vjetor, në një momentum vendimtar për të gjallëruar bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë, duke synuar sinergji dhe mbështetje për përmirësimin e domosdoshëm të kuadrit ligjor të komunikimeve dhe shërbimeve elektronike në vendin tonë.

## **Addendum:**

### **Katër orientimet/shtyllat strategjike të AKEP gjatë vitit 2019**

---

#### **1. Për sa i takon krijimit të kushteve të favorshme për investime të qëndrueshme**

AKEP ka qenë plotësisht i fokusuar në nxitjen e investimeve nga sipërmarrësit, sepse pa investime nuk mund përdoren shërbimet moderne të komunikimeve elektronike, të cilat janë në proces zhvillimi të vazhdueshëm.

Investimet në infrastrukturën e rrjeteve celularë shënuan nivelin rekord të 10 viteve të fundit duke arritur në shifrën rreth 6.35 miliard lekë nga rreth 4 miliardë në vitin 2018, pra 56 % më shumë se viti i kaluar.

Për sa i përket treguesve financiarë të operatorëve celularë kemi një rritje të treguesve për vitin 2019 në ndryshim nga viti i kaluar. Rezultatet financiare pozitive në nivel tregu ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme mundësinë e operatorëve për të rritur investimet dhe për të përmirësuar teknologjitë në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit për konsumatorët fundorë.

Tregu i komunikimeve elektronike dhe postare ka shënuar zhvillime pozitive në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve që u ofrohen përdoruesve duke ndjekur trendin drejt shërbimeve të bazuara në internet dhe rritjes së shërbimeve postare nga tregtia elektronike (e-commerce).

Tregu i shërbimeve të komunikimeve elektronike për vitin 2019 ka shënuar një xhiro prej rreth 35 miliard lekë ku dominojnë shërbimet celulare me rreth 26.3 miliardë lekë ndërkohë që për rrjetet fikse të ardhurat janë rreth 8.7 miliardë lekë.

Vendosja në përdorim e frekuencave të brezit 800 MHz, gjatë vitit 2019 nga dy sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a dhe Telekom Albania sh.a është shoqëruar edhe me investime në teknologji të reja nga këta operatorë. Për shkak se implementimi teknik i frekuencave në terren kërkon kohë të konsiderueshme, investimet e operatorëve në teknologjitë e reja do të vijojnë edhe përgjatë vitit 2020. Frekuencat e brezit 800 MHz ofrojnë kapacitete më të larta në rrjetet celulare dhe kjo ka bërë të mundur edhe përmirësimin e shërbimeve të këtyre operatorëve, në veçanti rritjen e shpejtësisë të shërbimit internet kundrejt pajtimtarëve.

Bazuar në zhvillimet dhe situatën e brezit 800 MHz, AKEP gjatë vitit 2020 do të vijojë koordinimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për dhënie në përdorim për të drejtën e fundit të brezit 800 MHz, në mënyrë që edhe ky brez i paalokuar të mund të shfrytëzohet sa më parë.

Pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së AKEP është edhe autorizimi i sipërmarrësve të komunikimeve elektronike e postare, në përmbushje të kërkesave ligjore si dhe monitorimi e inspektimi i tyre. Janë kryer si inspektime në terren tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike ashtu edhe inspektime në distancë lidhur me plotësimin e detyrimeve rregullatore, duke marrë edhe masa përkatëse ndaj sipërmarrësve për mosrespektim të detyrimeve të përcaktuara në aktet rregullatore. Gjithashtu janë inspektuar edhe subjekte që ofrojnë shërbime postare përfshirë edhe ofruesin e shërbimit universal postar, ku janë lënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e shërbimeve të ofruara ndaj përdoruesit.

## **2. Për sa i takon nxitjes së konkurrencës**

AKEP është përqendruar në krijimin e një ambienti sa më të ekuilibruar për të gjithë operatorët në treg, duke garantuar dhe vendosur detyrime rregullatore. Në kuadër të bashkëpunimit edhe me institucionet përgjegjëse (DPT, QKB) në funksion të formalizimit të aktiviteteve tregtare në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe promovimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg si dhe luftën kundër informalitetit, gjatë vitit 2019 janë verifikuar 123 subjekte të cilat kanë si veprimtari të tyre komunikimet elektronike dhe postare.

AKEP gjithashtu i ka kushtuar vëmendje të veçantë hartimit të dokumenteve të analizës së tregut celulare, duke ndjekur me rigorozitet procedurën specifike të këshillimit të përcaktuar në ligjin nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”, administrimit të komenteve të palëve të interesuara/sipërmarrësve, vendimeve/rekomandimeve të dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës si dhe vendimarrjes përkatëse.

## **3. Promovim dhe mbrojtje e të drejtave të konsumatorit**

Gjatë vitit 2019, puna e AKEP në drejtim të mbrojtjes dhe rritjes së përfitimeve të konsumatorit u fokusua në prioritetet e mëposhtme:

Rregullimin e roamingut ndërkombëtar me Republikën e Kosovës dhe vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, ku fokusi i AKEP ishte hartimi dhe miratimi i akteve rregullatore për implementimin e marrëveshjeve përkatëse të roamingut, vendosja e tarifave përkatëse si dhe ndjekja e zbatimit të tyre nga operatorët.

Hartimi i Rregullores së re për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike e cila synon një mbrojtje më të mirë të konsumatorit dhe përdoruesve të tjerë fundorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike nëpërmjet vendosjes së rregullave më të qarta për të drejtat e përdoruesve në marrëdhëniet me operatorët. AKEP pas përfundimit të këshillimit publik dhe shqyrtimit të komenteve të palëve të interesuara, shumë shpejt do të miratojë edhe versionin final të rregullores.

Një aspekt i rëndësishëm i mbrojtjes së konsumatorëve të komunikimeve elektronike dhe postare është trajtimi i ankesave të përdoruesve individualë si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve pajtimtarë-operatorë. Ankesat kryesisht janë depozituar në rrugë elektronike nga pajtimtarët dhe në disa raste edhe nga agjenci të mbrojtjes së konsumatorit (Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit apo dhe Shoqata për mbrojtjen e konsumatorit), pas trajtimit kanë marrë edhe zgjidhjet përkatëse.

## **4. Lidhur me efikasitetin e brendshëm institucionit**

Përgjatë vitit 2019 ka vijuar të implementohet struktura dhe organika e miratuar nga Kuvendi i RSH, por kjo nuk mjafton. Objekti i punës së AKEP dhe detyrimet rregullatore të tij të cilat burojnë nga aktet ligjore dhe direktivat evropiane, kërkojnë standarde të larta institucionale të barasvlefshme me autoritetet rregullatore të BEREC e vendeve të Bashkimit Evropian. Por për këtë nevojiten ndryshime në ligjin organik duke u garantuar pavarësia e plotë institucionale dhe financiare e institucionit në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe praktikat më të mira të autoriteteve rregullatore të komunikimeve elektronike dhe postare.

## 2. KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR

### 2.1. Referencat në ligjet mbi të cilat mbështetet veprimtaria e institucionit

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Roli, funksionet dhe kompetencat institucionale si organ rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar përcaktohen në legjislacionin material për komunikimet elektronike dhe shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë.

- **Ligjin nr.9918, datë 19.05.2008** “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;
- **Ligjin nr. 46/2015** “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”;
- **Ligjin nr.120/2016** “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.

Gjithashtu, veprimtaria e AKEP normohet nga tërësia e akteve nënligjore që përcaktojnë politikat e zhvillimit të sektorit si dhe aktet rregullatore të miratuara nga Këshilli Drejtues, i AKEP si organi drejtues i Institucionit, rekomandimeve të Kuvendit të RSH, Direktivat e Komisionit dhe Parlamentit Evropian, akteve të BEREC, ITU, ERPG etj.

### 2.2. Ndryshimet e kuadrit ligjor

Ligji nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, gjatë vitit 2019 ka pësuar ndryshime të pasqyruara në Ligjin nr.92/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 18.12.2019, dhe hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ndryshimet ligjore janë diktuar nga nevoja për të reflektuar ndryshimet e propozuara në ligjin nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me rregullimin e shërbimeve të publikimeve elektronike dhe mediave elektronike, për shkak të rritjes së impaktit të tyre në aspektin social, kulturor, ekonomik dhe politik të shoqërisë shqiptare.

Ndryshimet ligjore vendosin në thelb detyrimin e çdo sipërmarrësi që ofron shërbime të internetit (Internet Service Provider-ISP) për të respektuar në çdo rast kërkesën e AKEP për kufizimin e transmetimeve të përcaktuara me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, bazuar kjo në nenin 12 pika 3 ku parashikohet se: “AKEP-i bashkëpunon me AMA-n në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe dispozitave të tjera nënligjore, si dhe siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe organeve të tjera të AMA-s, duke detyruar ofruesit e shërbimeve të aksesit në

*internet të zbatojnë aktet/vendimet përkatëse të këtyre autoriteteve, sipas afateve dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi”.*

AKEP nuk mund të gjykojë, kërkojë apo të vendosi me iniciativën e tij (*motu proprio*), për kufizime në transmetimet me përmbajtje të paligjshme apo të dëmshme, por mund t'i drejtohet sipërmarrësit, që ofron rrjetin dhe/ose shërbimet e komunikimit elektronik, për ndërprerjen dhe bllokimin e transmetimit të kësaj përmbajtje vetëm në bazë dhe për zbatim të një akti administrativ të një organi/institucioni përgjegjës për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së përmbajtjeve të transmetimeve.

Roli i AKEP në këtë proces, kufizohet vetëm për sa i përket inspektimit dhe mbikëqyrjes të veprimtarisë së sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike, nëse kanë kryer kufizimet në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme në përputhje me vendimet që kanë përcjell organet përgjegjëse.

## 3. INTEGRIMI EVROPIAN

### 3.1. Implementim i detyrimeve që burojnë nga aktet ndërkombëtare

Lidhur me transpozimin e Direktivës së re të Pajisjeve Radio 2014/53/EU (RED), të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, AKEP përgjatë 2019 ka ndërmarrë pjesëmarrje aktive në hartimin dhe draftimin e akteve nënligjore përkatëse.

Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 378 datë 5.6.2019, ka miratuar Rregullin Teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara. VKM kjo e përafuar pjesërisht me Direktivën e mësipërme.

Këshilli Drejtues i AKEP, bazuar në këtë Direktivë dhe VKM-në e sipërcituar, ka miratuar për këshillim publik nëpërmjet VKD nr. 40 datë 15.11.2019 dokumentin “Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”. Pas përfundimit të këshillimit publik AKEP me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.7, datë 22.04.2020 ka miratuar dokumentin përfundimtar “Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”, duke përcaktuar në mënyrë të detajuar detyrat përkatëse të AKEP bazuar në aktin nënligjor.

*AKEP ndjek në vazhdimësi:*

- a) zhvillimet më të fundit dhe veçanërisht rregullat dhe standardet e përcaktuara në Rregulloret e ITU, Publikimet e CEPT për radiofrekuencat dhe ECA Table (The European Table of Frequency Allocations and Applications);
- b) përditësimin e akteve rregullatore për zbatimin e direktivave dhe akteve ndërkombëtare.

### 3.2. Kontributi në kuadrin e Integritimit Evropian

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional me autoritetet rregullatore ndërkombëtarë dhe ato rajonale, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka vazhduar të nxisë dinamikën e bashkëpunimit në shkallë ndërkombëtare, duke marrë pjesë aktivisht në takimet e organizatave, të forumeve të rregullatorëve sektoriale në Evropë (BEREC, ITU, ERGP etj.) si dhe ka ndërmarrë nismat përkatëse bilaterale, për shkëmbimin e përvojave dhe të praktikave më të mira.

Konkretisht, AKEP ka ndjekur dhe ka siguruar pjesëmarrjen e stafit të tij si dhe ka dhënë kontribut në takimet e grupeve teknike dhe seancave plenare të BEREC, të cilat janë konkluduar në raportet dhe dokumentat e rëndësishëm të këtij institucioni Evropian.

Gjithashtu janë ndjekur takimet e Grupit Rregullator Evropian të Shërbimit Postar “ERGP”, duke siguruar pjesëmarrjen në takimet e ekspertëve të pasuar nga takimet plenare.

Përfaqësues të AKEP kanë marrë pjesë në aktivitetet kryesore të ITU për vitin 2019, si dhe në takimet, seminarët dhe workshop të WRC-ITU 2019 dhe WSIS-19.

Në kuadër të proceseve të integritimit, AKEP është angazhuar maksimalisht për zbatimin e rekomandimeve të dhëna:

- a) Për Komitetin e Stabilizim - Asociimit mbi zhvillimin e tregut të telekomunikacionit në kuadër të zbatimit të MSA.
- b) Për nënkomitetin BE-Shqipëri në kuadër të Kapitullit 3 të PKIE - “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime“- Pjesa mbi Shërbimet Postare.
- c) Për Raport Progresin e Komisionit Evropian për vitin 2019.
- ç) Për nënkomitetin BE-Shqipëri “Inovacionin, Shoqërinë e Medias dhe Politikave Sociale”, në kuadër të Kapitullit 10 të PKIE - “Shoqëria e Informacionit dhe Media”- Pjesa mbi komunikimet elektronike, takimi i 11 i nënkomitetit BE-Shqipëri.
- d) Ndjekjen e rekomandimeve të BE-së për lirimin e brezit 700MHz për rrjetet celulare deri në vitin 2021.
- dh) Angazhimin për finalizimin e një marrëveshje ndërkufitare me Italinë për të shmangur ndërhyrjet e valëve (interferencat) midis dy vendeve.

## 4. ZHVILLIMET E TREGUT

### 4.1. Tregu i komunikimeve elektronike

#### 4.1.1. Treguesit financiarë, të ardhurat dhe investimet


Bazuar në raportimet e sipërmarrësve që ushtrojnë aktivitet në fushën e komunikimeve elektronike, të ardhurat totale nga ofrimi i shërbimeve të komunikimeve elektronike për vitin 2019 janë rreth 35 miliard lekë, pothuajse në të njëjtin nivel sa viti 2018.

Pjesën më të madhe të të ardhurave e përbëjnë ato të gjeneruara nga aktiviteti i telefonisë celulare, konkretisht rreth 26.3 miliardë lekë, me një rënie me rreth 2% nga viti 2018.

Për sa i përket të ardhurave nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike nga rrjetet fikse, të ardhurat janë rreth 8.7 miliardë lekë, shifër kjo rreth 5% më e lartë se ajo e vitit të kaluar.

Në grafikun në vijim paraqiten të ardhurat nga shërbimet e komunikimeve elektronike për vitin 2019 sipas operatorëve kryesorë.

GRAFIKU NR. 1 SHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE TË SIPËRMARRËSVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE (2019)




Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP.

Nga të dhënat e paraqitura në grafikun sa më sipër, evidentohet se:

- operatori me peshën më të madhe të të ardhurave në fushën e shërbimeve të komunikimeve elektronike është Vodafone Albania sh.a me rreth 41% të totalit të të ardhurave;
- ndjekur nga Telekom Albania sh.a me rreth 23%;

- në vendin e tretë sipërmarrësi Albtelcom sh.a me rreth 22% të tregut për të dy rrjetet fikse dhe mobile;
- pjesa tjetër rreth 14% u takon operatorëve të tjerë të rrjeteve fikse.

GRAFIKU NR. 2 TË ARDHURAT TOTALE TË OPERATORËVE CELULARË (2011-2019)



Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP.

Gjatë vitit 2019 të ardhurat e gjeneruara nga ofruesit e shërbimeve mobile paraqiten në nivel të përafërt me atë të vitit 2018, me një rënie prej rreth 2%. Rënien më të madhe e ka shënuar Telekom Albania prej rreth 5%, Vodafone Albania me 1%, ndërsa Albtelcom është në të njëjtin nivel si në vitin e kaluar.


Për sa i përket rezultatit financiar neto vjetor, në ndryshim nga viti i kaluar ku Telekom Albania shënonte humbje, këtë vit kjo shoqëri është shfaqur me rezultat neto pozitiv (fitim) rreth 285 milionë lekë.

Rezultat pozitiv ka raportuar edhe Vodafone Albania me rreth 1 miliardë e 400 milionë lekë, shifër kjo sa dyfishi i fitimit të realizuar vitin e kaluar.

Në ndryshim nga dy sipërmarrësit e tjerë Albtelcom gjatë vitit 2019 ka raportuar rezultat financiar negativ me rreth 645 milionë lekë, duke e thelluar humbjen nga rreth 330 milionë lekë humbje që ka raportuar për vitin 2018.

**Rezultatet financiare pozitive në nivel tregu prej 1.04 miliardë lekë** ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme mundësinë e operatorëve për të rritur investimet dhe për të përmirësuar teknologjitë në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit për konsumatorët fundorë.

GRAFIKU NR. 3 TË ARDHURAT NGA SHËRBIMET ME PAKICË DHE SHUMICË TË RRJETEVE CELULARE 2011-2019




Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP.

Siç vërehet në grafikun sa më sipër të ardhurat nga shërbimet e ofruara me shumicë kanë pësuar rënie të theksuar gjatë tre viteve të fundit, duke arritur nivelin më të ulët që nga viti 2011. E kundërta ka ndodhur me të ardhurat e gjeneruara nga shërbimet me pakicë të cilat gjatë periudhës 2017-2019 kanë pësuar rritje të lehtë.

## Investimet

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e investimeve të tre sipërmarrësve në infrastrukturë të rrjeteve celulare në periudhën 2011-2019<sup>1</sup>.

GRAFIKU NR. 4 ECURIA E INVESTIMEVE TË SIPËRMARRËSVE NË RRJETE CELULARE (2011-2019)



BURIMI: TË DHËNAT E OPERATORËVE TË DEKLARUARA NË AKEP.

<sup>1</sup> Këtu nuk përfshihen shpenzimet e sipërmarrësve për licenca/autorizime.

**Gjatë vitit 2019 investimet në infrastrukturën e rrjetit celular u rritën me rreth 56% duke arritur në shifrën rreth 6.35 miliard lekë, nga rreth 4 miliardë në vitin 2018, duke arritur vlerën më të lartë që pas vitit 2011.**

Kjo rritje është ndikuar nga:

- rritja e investimet e kryera të Vodafone Albania sh.a, i cili ka investuar në vitin 2019 rreth 3.5 miliardë lekë;
- ndjekur nga Telekom Albania me rreth 2.6 miliardë lekë;
- Albtelecom ka investuar rreth 160 milionë lekë.

Ecuria e investimeve në rrjetet celulare ndër vite tregon se në dy vitet 2016-2017 ka pasur një rënie të ndjeshme të investimeve, e ndikuar edhe nga diz-investimet e sipërmarrësit Plus Communication sh.a, (shitja e asetëve), për t'u ndjekur më pas nga një rritje gjatë vitit 2019.

Rritja e investimeve në rrjetin e shërbimeve celulare do ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së shërbimeve te konsumatorëve fundorë.

Domosdoshmëria për investime gjithnjë e më të mëdha nga ana e sipërmarrësve afektohet në dy drejtime:

- nga njëra anë kërkesa konsumatore gjithnjë e në rritje për shërbime sa më cilësore, për të bërë të mundur ofrimin e shërbimeve standarde dhe nivele si ato në vendet e tjera më të zhvilluara,
- nga ana tjetër është presioni i nivelit të ulët të të ardhurave dhe fitimeve të sipërmarrësve gjë e cila ndikon drejtpërdrejtë në aftësitë e tyre për të investuar në rrjete me cilësi më të lartë shërbimi siç janë rrjetet 4G dhe ato 5G.

#### 4.1.2. Shërbime të rrjeteve celulare

Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2015-2019 dhe norma e ndryshimit vjetor për vitin 2019 paraqiten në tabelën e mëposhtme.

**TABELA NR. 1 TREGUESIT KRYESORË TË VOLUMIT TË SHËRBIMEVE CELULARE 2015-2019**

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2018
<b>Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:</b>						
– Sipas kartave SIM	4,777,885	5,280,990	5,558,492	4,143,603	3,378,886	-18.46%
– Përdorues aktivë	3,442,665	3,490,686	3,625,699	2,714,878	2,630,076	-3.12%
<b>Numri përdoruesve me akses broadband 3G/4G:</b>						
– Totali	2,049,072	2,739,550	3,345,045	2,657,015	2,462,057	-7.34%
– Përdorues aktivë	1,297,281	1,686,354	2,030,978	1,809,996	1,789,158	-1.15%
Thirrje telefonike dalëse të përdoruesve celularë (minuta)	7,381,147,348	6,793,769,155	6,619,674,715	6,019,006,073	5,494,296,034	-8.72%
Thirrje hyrëse kombëtare (minuta)	1,388,340,601	2,522,840,417	2,893,847,082	2,525,099,112	2,318,816,619	-8.17%
Thirrje hyrëse ndërkombëtare (minuta)	420,253,147	300,227,063	168,753,020	164,608,604	213,311,650	29.59%
Numri mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit	1,598,702,865	1,610,322,977	1,400,142,526	1,212,559,068	967,833,263	-20.18%
Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjete celulare (GB)	12,740,073	26,753,639	45,901,117	60,051,808	69,135,490	15.13%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Treguesit që kanë shënuar rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2019:

- volumi i trafikut të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare i cili ka shënuar rritje me rreth 29% krahasuar me vitin 2018;
- volumi i të dhënave të transmetuara nëpërmjet internetit në rrjetet mobile, volum i cili është rritur me rreth 15 % krahasuar me vitin 2018.

Për sa i përket rritjes së thirrjeve hyrëse ndërkombëtare gjatë vitit 2019, rritjen më të madhe e ka shënuar sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a, i cili zë edhe pjesën më të madhe të këtij trafiku me 83%, ndërsa dy operatorët e tjerë kanë shënuar ulje të trafikut të terminuar të thirrjeve ndërkombëtare krahasuar kjo me vitin 2018.

Gjatë vitit 2019, rritjen më të madhe të volumit të të dhënave *Data* e ka pasur Vodafone Albania sh.a me rreth 19 pp<sup>2</sup> ndjekur nga Telekom Albania sh.a me rreth 7 pp, ndërkohë Albtelecom është përafërsisht në të njëjtat nivele si viti 2018.

Për vitin 2019 vërehet se ka pasur rënie të treguesve kryesorë krahasuar me vitin 2018 për:

- numrin e pajtimtarëve sipas kartave SIM (rreth 18% më pak);
- numri i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare (rreth 3% më pak);
- numri total i përdoruesve me akses broadband nga rrjetet mobile (rreth 7% më pak);
- numri i përdoruesve aktivë të internetit (rreth 1% më pak);
- volumin e thirrjeve dalëse celulare (rreth 8% më pak);
- numrin e SMS të dërguara nga përdoruesit (rreth 20% më pak);
- volumin i thirrjeve hyrëse kombëtare të cilat (rreth 8% më pak).

Edhe pse treguesit e numrit të pajtimtarëve sipas kartave SIM dhe përdoruesve aktivë mobile kanë shënuar rënie, kjo rënie ka qenë dukshëm më e vogël se ajo e një viti më parë.

Për sa i përket rënies së numrit të SMS-ve dhe minutave të komunikimit *Voice*, kjo ka ardhur edhe si rezultat i përdorimit në masë të aplikacioneve OTT (*whatsapp, Viber, Messenger, Skype etj.*) nëpërmjet të cilëve dërgohen mesazhe tekst dhe kryhen thirrje zanore dhe ‘*video calls*’. Komunikimi nëpërmjet këtyre aplikacioneve ka ardhur gjithnjë në rritje edhe për shkak të përmirësimit të shërbimeve të ofruara nga rrjetet 4G dhe 4G+ të cilat mundësojnë transmetim me cilësi më të mirë si të mesazheve ashtu edhe të thirrjeve nëpërmjet këtyre aplikacioneve.


## **Numri i përdoruesve celularë**

Nga të dhënat e ecurisë së numrit të përdoruesve celularë sipas viteve vërehet se numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare kanë shënuar rritje nga viti 2014 deri në fund të vitit 2017, për t’u ndjekur nga një rënie e theksuar të këtyre treguesve nga tremujori i parë 2018 e në vijim deri në fundin e vitit 2019.

---

<sup>2</sup> Pikë përqindje

GRAFIKU NR. 5 NUMRI I PËRDORUESVE CELULARË AKTIVË DHE KARTA SIM 2014-2019



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Disa prej faktorëve kryesorë që kanë ndikuar në rënien e treguesve të mësipërm gjatë vitit 2019, i atribuohen:

- i. ndryshimit të politikës së zbatuar nga sipërmarrësit në lidhje me jetëgjatësinë e kartave SIM për numrat me parapagesë duke shkurtuar periudhën gjatë të cilës një numër mund të qëndrojë aktiv në rrjet pa kryer rimbushje;
- ii. ndryshimit të politikave të kompanive për sa i përket fushatave promovionale për ofrimin e numrave falas, duke dekurajuar përdoruesit që të përdorin karta SIM për një kohë të shkurtër;
- iii. reduktimit të numrit të kartave nga ana e përdoruesve të cilët mbanin dy ose më shumë karta SIM.

**Shërbimet e aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G**

Numri total i përdoruesve të rrjeteve celulare që kanë përdorur aksesin broadband në internet gjatë vitit 2019 konsistonte:

- rreth 2.4 milion përdorues që e kanë përdorur rrjetin të paktën një herë gjatë vitit 2019;
- rreth 1.7 milion përdorues aktivë (përdorim të internetit në tre muajt e fundit).

TABELA NR. 2 NUMRI I PAJTIMTARËVE ME AKSES BROADBAND 3G/4G

	Telekom Albania	Vodafone Albania	Albtelecom	Plus Communications	Total	Norma e penetrimit për popullsi
2011	55,000	228,249	-	-	283,249	10%
2012	240,715	408,998	-	-	649,713	23%
2013	311,566	634,293	285,400	-	1,231,259	43%
2014	225,346	550,196	132,433	-	907,975	32%
2015	375,973	706,880	214,428	-	1,297,281	46%
2016	460,221	921,854	231,321	72,958	1,686,354	60%
2017	613,886	1,030,614	282,077	104,401	2,030,978	72%
2018	605,984	931,730	272,282	-	1,809,996	63%
2019	567,572	940,949	280,737	-	1,789,258	63%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.


Operatorët me rrjete 3G/4G kanë pasur rënie të numrit të përdoruesve aktivë të shërbimeve akses broadband nëpërmjet aparateve celulare, ku në fund të vitit 2019 kjo shifër arriti në 63% duke ruajtur të njëjtin nivel me vitin 2018.

Ndërsa numri i përdoruesve nëpërmjet kartave USB/modem për vitin 2019 arriti në rreth 127 mijë përdorues duke shënuar një rënie me rreth 12 % në krahasim me vitin 2018. Rënia e përdorimit të internetit nëpërmjet kartave USB/modem ndikohet nga rritja e ofrimit të shërbimit të internetit nëpërmjet pajisjeve celulare si edhe rritja mjaft e madhe e ofrimit të shërbimit broadband nga rrjetet fikse.

### Trafiku telefonik

Sasia totale e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga përdoruesit celularë gjatë vitit 2019 ishte rreth 5.5 miliard minuta, e cila përbën një rënie me 9% në krahasim me vitin 2018 (6 miliard minuta).

GRAFIKU NR. 6 STRUKTURA E THIRRJEVE DALËSE CELULARE SIPAS DESTINACIONIT




Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Edhe gjatë vitit 2019, volumi i thirrjeve kombëtare drejt rrjeteve celulare (on-net dhe off-net) ka shënuar rënie, krahasuar me vitin 2018:

- sasia e thirrjeve on-net u reduktua me 9%;
- thirrjet off-net u reduktuan me 8%.

**GRAFIKU NR. 7 ECURIA TRAFIKUT MUJOR ON-NET/OFF-NET 2014-2019**




Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Rritjet e ndjeshme të nivelit dhe peshës së thirrjeve off-net në totalin e thirrjeve celulare dhe reduktimet në thirrjet on-net në periudhën 2015-2019 kanë ndodhur si rrjedhojë e zbatimit të detyrimit të operatorëve celularë për mos-diskriminim në tarifën e thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare, që filluan të zbatohen në korrik 2015.

Vërehet se gjatë viteve 2018-2019 pesha e thirrjeve on-net dhe off-net është stabilizuar në kufijtë përkatësisht rreth 41% off-net dhe rreth 56% on-net.

**GRAFIKU NR. 8 ECURIA E THIRRJEVE (NË MINUTA) DALËSE DHE HYRËSE NËRKOMBËTARE NË RRJETET CELULARE**



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Rënia e madhe e trafikut të thirrjeve dalëse ndërkombëtare për periudhën 2016 – 2019 ka ardhur si pasojë e:

- rritjes së përdorimit të shërbimit të internetit (mobile dhe fiks);
- përdorimit masiv të aplikacioneve OTT që shfrytëzojnë internetin për thirrje, mesazhe, video calls etj;
- ndryshimeve në ofertat/paketat e operatorëve celularë për thirrjet ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe si pasojë e ndryshimeve në tarifatat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare në vendet e BE-së.

### Terminimi i thirrjeve dhe SMS-ve

Sasia totale e thirrjeve hyrëse (nga rrjetet e tjera) të terminuara në rrjetet celulare në vitin 2019 ishte rreth 2.5 miliard minuta, që përbën rënie me 6% në krahasim me vitin paraardhës.

Terminimi i thirrjeve kombëtare u ul me 1% për thirrjet nga rrjetet fikse dhe pësoi një rënie prej 8% për thirrjet nga rrjetet e tjera celulare.

Siç mund të vihet re trendi rritës i përdorimit të *Data-ve* është në kah të kundërt me trendin e përdorimit të shërbimeve tradicionale të thirrjeve dhe SMS-ve, duke evidentuar efektin zëvendësues të këtyre shërbimeve tradicionale me shërbimet e ofruara nga aplikacionet OTT që mundësohen nga aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G.

### Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

TABELA NR. 3 PËRDORIMI MESATAR MUJOR I THIRRJEVE TELEFONIKE CELULARE 2012-2019

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2018
Thirrje dalëse	152	156	172	182	166	155	158	171	8%
Thirrje të marra	168	167	168	171	169	156	161	177	10%
MOU	319	324	341	353	335	311	319	348	9%
SMS Dalese	35	39	43	39	39	33	31	30	-3%
Trafik Data (GB)	N/A	0.22	0.48	0.96	1.49	2.06	2.6	3.4	31%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Gjatë vitit 2019, një përdorues celular aktiv (që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit) ka kryer mesatarisht 171 minuta thirrje dalëse, ka dërguar 30 mesazhe SMS në muaj dhe ka konsumuar rreth 3.4 GB në internet broadband.

Faktorët kryesorë që ndikojnë në mesataren e thirrjeve/SMS janë reduktimi i bazës së përdoruesve aktivë të shërbimeve mobile, si edhe rritja e përdorimit të shërbimeve të komunikimit (sms, voice, video) nëpërmjet aplikacioneve OTT.

Këto vlera përdorimi janë më të vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit total të përdoruesve sipas kartave SIM.

## Pjesët e tregut

Pjesët e tregut të operatorëve celularë për vitin 2019:

1. Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a vazhdon të jetë operatori me pjesën më të madhe të tregut për të gjithë treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile duke shënuar rritje për pjesën më të madhe të treguesve krahasuar me vitin 2018, konkretisht pjesët e tregut për vitin 2019 variojnë me:
  - mbi 50 % të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card;
  - mbi 47 % të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktiv;
  - mbi 59 % të pjesëve të tregut për volumin e SMS dhe trafikut të internetit;
  - mbi 52% të tregut për trafikun e minutave dhe përdoruesve aktiv të internetit;
  - 54% të tregut për të ardhurat totale;
  - 55% për shërbimet me pakicë.
2. Në vend të dytë është sipërmarrësi Telekom Albania sh.a, që ka shënuar rënie të lehtë të pjesës dërmuese të treguesve kryesorë me rreth 1-2 (pikë përqindje), pjesët e tregut për vitin 2019 variojnë si vijon:
  - 26-34% pjesë të tregut për të gjithë treguesit e përdoruesve aktivë, pajtimtarë të kartave SIM, thirrje dalëse, SMS, trafik interneti, përdorues aktivë të broadband;
  - 31% të tregut për të dy treguesit të ardhurat totale dhe ato nga shërbimet me pakicë.
3. Sipërmarrësi me pjesën më të vogël të tregut është Albtelecom i cili ka shënuar rritje të lehtë (rreth 1 pikë përqindje) të treguesve kryesorë krahasuar me vitin 2018, rënie ka shënuar për treguesin e trafikut të të dhënave nëpërmjet internetit. Pjesët e tregut për vitin 2019 variojnë:
  - 12-17% % pjesë të tregut për të gjithë treguesit e përdoruesve aktivë, pajtimtarë të kartave SIM, thirrje dalëse, SMS, trafik interneti, përdorues aktivë të broadband;
  - 14% të tregut për të dy treguesit të ardhurat totale dhe ato nga shërbimet me pakicë.

TABELA NR. 4 INDEKSI HERFINDAHL-HIRSCHMAN SIPAS TREGUESVE TË PJESËVE TË TREGUT

	Viti	Përdorues shërbime celulare	Përdorues Aktivë të shërbimeve celulare	Përdorues aktivë broadband	Thirrje dalëse	SMS dalëse	Trafiku të dhëna (Gbyte)	Të ardhura totale	Të ardhura retail
HHI	2011	3,052	3,493	6,871	4,074	4,890	3,099	3,987	3,882
	2012	3,085	3,549	5,335	4,094	5,766	3,857	4,120	3,751
	2013	3,525	3,600	3,831	4,180	5,796	4,063	3,744	3,815
	2014	3,399	3,460	4,501	3,797	4,898	3,632	3,665	3,926
	2015	3,222	3,499	4,082	3,642	4,787	3,727	3,582	3,894
	2016	3,691	3,724	3,944	3,940	4,988	3,937	3,522	4,052
	2017	3,676	3,620	3,708	3,619	4,325	3,970	3,549	3,746
	2018	3,954	3,842	3,842	4,093	4,602	4,086	4,136	4,173
	2019	3,883	3,849	4,018	4,112	4,483	4,113	4,148	4,158

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut.

Indeksi i HHI<sup>3</sup> është në nivele mbi 3,800 për të gjithë treguesit e marrë në analizë, gjë e cila sipas përcaktimeve të këtij treguesi, tregon se ndodhemi në një treg me përqendrim shumë të lartë.

Vërehet se indeksi HHI ka pësuar rritje të vazhdueshme nga viti 2017 e në vijim, duke rritur përqendrimin e tregut dhe duke ulur konkurrueshmërinë në treg.

Ndikim në përkeqësimin e indeksit të përqendrimit ka pasur edhe daljen e sipërmarrësit Plus Communication sh.a nga tregu, duke bërë që në këtë treg tashmë të operojnë vetëm tre operatorë, nga katër deri në vitin 2017.

Bazuar në sa më sipër, vërehet se indeksi i përqendrimit HHI për të gjithë treguesit e marrë në analizë është dukshëm më i lartë sesa kufiri 2500 pikë, kufi mbi të cilin tregu konsiderohet mjaft i përqendruar, rritja e të cilit tregon për ulje të konkurrueshmërisë midis sipërmarrësve në këtë treg.

Ndryshe nga tregu shqiptar i telefonisë celulare ku pjesa e tregut e operatorit lider në treg ka tendencë në rritje, dinamika e tregjeve në vendet e BE-së ka lëvizur në kah të kundërt pasi pjesa e tregut e operatorit kryesor celular në vendet e BE-së mesatarisht ka qenë në reduktim. Ndërkohë, nga te dhënat e Komisionit Evropian në Digital Agenda rezulton se tendenca e pjesës së tregut të operatorit lider celular (Mesatarja) ka tendencë gjithnjë në rënie.

## Tarifat celulare

### i. Tarifat standarde për njësi komunikimi (pay as you go)

Bazuar në analizat e tregut, AKEP ka evidentuar si problematikë diferencën e lartë të tarifave për shërbimet e konsumuara për njësi (lekë/minutë, SMS) me tarifat e shërbimeve të përfshira në pagesën fikse si pjesë e ofertave.

Këto tarifa rezultojnë të jenë shumë herë më të larta se tarifat mesatare që aktualisht paguajnë përdoruesit celularë. Siç theksohet në seksionin e ARPM, çmimi që një përdorues celular ka paguar mesatarisht për një minutë thirrje telefonike nga rrjete celulare në vitin 2019 ishte 4 lekë/minutë me TVSH, ndërsa tarifat standarde të thirrjeve jashtë paketave janë deri 7 - 10 herë më të larta se kjo vlerë mesatare (tarifa mesatare standarde që aplikohet varion nga 29 - 39 lekë/minutë). Në mënyrë të ngjashme edhe tarifimi për aksesin broadband jashtë paketave tregon për nivel shumë të lartë të tyre dhe diferenca të mëdha me aksesin broadband në paketa (parapagim/paspagim).

TABELA NR. 5 TARI FAT ST AN D AR D E T Ë A P L I K U A R A N G A O P E R A T O R Ë T M O B I L E N Ë S H Q I P Ë R I

Operatori	Min dalëse (Lek/min)	Min Hyrëse (Lek/min)	SMS (Lek/SMS)	Internet (Lek/MB)
Albtelecom	29	0	16.2	10.24
Telekom Albania	39	0	12	9.994
Vodafone Albania	39/29 (on-net/off-net)	0	13	99.94

Burimi: Tarifat e publikuara nga operatorët mobile.

Megjithatë duhet theksuar se pjesa më e madhe e përdoruesve me parapagim (93%) përdorin paketa *bundle* që përfshijnë sasi të konsiderueshme thirrjesh dhe SMS, dhe kjo ka bërë që të reduktohet ndjeshëm masa e aplikimit të tarifimit standard.

<sup>3</sup> Treguesi kryesorë që përdoret për krahasimin e konkurrueshmërisë në treg është indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) i cili paraqet indikacione nëse një treg i caktuar është në konkurrencë efektive apo ka shtrëngime dhe shtrembërime të saj. Në tabelën më sipër është paraqitur indeksi Herfindahl-Hirschman për treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile.

Njëkohësisht, operatorët celularë për të shmangur fatura tejet të larta për aksesin broadband, shpesh aplikojnë politikat tarifore të ashtuquajtura FUP (Fair Usage policy), ku ofrohet internet “pa limit”. Pas konsumit të një sasive të caktuar GB apo MB, përdoruesi vazhdon të ketë internet pa limit, por me shpejtësi të reduktuar deri në 128/256 kbps. Praktikë e ngjashme aplikohet edhe nga operatorët e tjerë në rajon dhe me gjerë, kjo nëpërmjet ofrimit të paketave *bundle*.

## ii. Tarifat e thirrjeve on-net/off-net

Nga monitorimi i vazhdueshëm i publikimit të tarifave në faqet e internetit të operatorëve sipas masave rregulluese dhe rregullores mbi publikimin e informacionit për tarifatat e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike rezulton se:

- Sipërmarrësit kanë barazuar tarifën e thirrjeve on-net/off-net me përjashtim të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a i cili, vazhdon të mbajë në fuqi tarifën on-net me 39 lekë/minutë kundrejt 29 lekë për thirrjet off-net.

Gjatë vitit 2019 ka pasur disa ndryshime në tregun e shërbimeve celulare me pakicë. Në muajin shkurt 2019, tre sipërmarrësit celularë kanë nxjerrë në treg:

- paketën ditore 150 lekë nga 100 lekë që ishte më parë;
- paketën javore 500 lekë nga 300 lekë që ishte më parë.

Rritja e çmimeve të këtyre paketave është shoqëruar me rritjen e njësisive të komunikimit minuta/SMS/internet.

Tarifatat standarde që aplikohen pas ezaurimit të njësisive të paketave *bundle* që nuk kanë pësuar ndryshim gjatë vitit 2019 janë si më poshtë:

- Altelecom sh.a aplikon tarifën prej 29 lekë/minutë për thirrjet kombëtare brenda dhe jashtë rrjetit;
- Telekom Albania sh.a aplikon tarifën 39 lekë/minutë;
- Vodafone Albania sh.a ka një diferencim tarife 39 lekë/minutë për thirrjet brenda rrjetit dhe 29 lekë/minutë për thirrjet drejt destinacioneve të tjera kombëtare.

## iii. Tarifatat për shërbimet e aksesit broadband celular

Nga ofertat/paketa tarifore të disponueshme nga operatorët celularë vihet re se pesha e përdoruesve me parapagim ka pësuar rënie gjatë vitit 2019 duke shkuar në rreth 81% nga rreth 90% që ishte në vitin 2018.

Operatorët celularë kanë dizenuar paketa të ndryshme për përdoruesit me parapagim duke ju dhënë mundësi zgjedhjeje për të përfitur aksesin në internet në celular:

- Të integruar së bashku me shërbime telefonike duke filluar nga 150 lekë/ditë deri në 2,200 lekë/muaj;
- Si shërbim më vete, me paketa që fillojnë nga 100 lekë/ditë deri në 500 lekë/muaj me kapacitete të ndryshme download të mjaftueshme për akses broadband funksional në internet.

#### iv. Treguesit ARPM/ARPU<sup>4</sup>

Operatorët celularë ofrojnë një sërë shërbimesh dhe paketash tarifore. Është shpesh e vështirë krahasimi i tarifave për shërbime të veçanta dhe/ose për njësi për shkak të rritjes së përdorimit të shportave (bundles) me një shërbim ose me shumë shërbime (paketa të integruara).

Ecuria e tarifave me pakicë të tregut celular analizohet në dy drejtime kryesore:

- Të ardhura mesatare për minutë/përdorues (ARPM/ARPU);
- Tarifat nominale me pakicë të operatorëve.

Theksojmë faktin që ky tregues nuk është shumë i saktë kur kemi parasysh shkallën e lartë të përdorimit të paketave *bundle* të cilat përveç minutave përmbajnë edhe njësi të tjera komunikimi si SMS, internet etj. Edhe vetë sipërmarrësi nuk mund ta ndajë dot se cila pjesë e çmimit të paketës i takon minutave.

TABELA NR. 6 ECURIA E ARPM DHE ARPU 2010-2019

Vitet	ARPM (Leke/Minutë)	ARPU (Leke/përdorues)	ARPM Ndryshimi vjetor (%)	ARPU Ndryshimi vjetor (%)
2010	6.49	8,594	N/A	N/A
2011	5.35	8,319	-18%	-3%
2012	3.92	7,132	-27%	-14%
2013	3.13	5,863	-20%	-18%
2014	2.63	5,447	-16%	-7%
2015	2.36	5,125	-10%	-6%
2016	2.53	4,750	7%	-8%
2017	2.60	5,091	3%	7%
2018	2.89	6,482	11%	27%
2019	3.33	7,024	15%	8%

Burimi: AKEP.

Rritja e treguesit ARPU me një përqindje të konsiderueshme gjatë viteve 2018-2019, ka ardhur si rezultat i rritjes së të ardhurave me pakicë të sipërmarrësve nga njëra anë dhe rënia e numrit të përdoruesve nga ana tjetër. Ky tregues gjenerohet si raport i të ardhurave me pakicë me numrin e përdoruesve aktivë. Bazuar në të ardhurat me pakicë të raportuara nga sipërmarrësve mobile rezulton se ka pasur rritje gjatë viteve 2018-2019, sikundër baza e përdoruesve aktiv ka shënuar rënie me rreth 25% gjatë të njëjtës periudhë.

Ndërkohë ndryshimi i treguesit të ARPM është ndikuar ndjeshëm nga rënia e bazës së përdoruesve, e cila ka pësuar rënie të konsiderueshme gjatë viteve 2018-2019, me më shumë se 25% krahasuar me periudhat paraardhëse.

Megjithatë, niveli i këtyre treguesve në Shqipëri mbetet më i ulët se niveli mesatar në vendet e BE dhe në rajon.

<sup>4</sup> Treguesi i ARPU (Average Revenue Per User) rezulton si raport i të ardhurave nga shërbimet me pakicë me numrin total të përdoruesve aktivë dhe tregon të ardhurat mesatare vjetore të sipërmarrësit për një përdorues. Ky tregues është një mesatare e thjeshtë pasi varion shumë nga një përdorues tek tjetri.  
ARPM (Average revenue Per Minute) del si raport mes të ardhurave nga shërbimet me pakicë me sasinë e minutave dalëse dhe tregon të ardhurat e sipërmarrësit për një minutë. Ky tregues është çmimi që paguan një përdorues për një minutë kohë bisede.

### 4.1.3. Shërbimet nga rrjetet fikse


#### Telefonia fikse

Shërbimet e rrjeteve fikse në Shqipëri ofrohen nga rreth 181 sipërmarrës (të cilët kanë raportuar se kanë pasur aktivitet gjatë 2019), të cilët zotërojnë rrjetet/infrastrukturën e tyre, përfshirë rrjetin e aksesit apo të lidhjes direkte me përdoruesit fundorë.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në vitin 2019 ka pësuar një rënie të lehtë rreth 2%, saktësisht nga 248 mijë në fund të vitit 2018 në 242 mijë në fund të vitit 2019.

Norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) në fund të vitit 2019 arriti në 8.46%, që është shumë më e ulët se vendet e zhvilluara të cilat e kanë rreth 40%.

GRAFIKU NR. 9 ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË TELEFONISË FIKSE 2000-2019



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit.

Sipërmarrësi me pjesën më të madhe të tregut të telefonisë fikse vazhdon të jetë Albtelcom, i cili zotëron rreth 73%, një rritje e lehtë me 2 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2018.

Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 31% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në qarkun e Tiranës. Diferenca në nivelin e përdorimit në zona urbane dhe rurale është e madhe.

Sasia e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga pajtimtarët e rrjetit fiks të Albtelcom në vitin 2019 u reduktua me 19% në krahasim me vitin 2018, ndërsa mesatarja e minutave të thirrjeve në muaj për përdorues të rrjetit fiks të Albtelcom është reduktuar nga 44 minuta në vitin 2018 në 35 minuta në vitin 2019.


#### 4.1.4. Aksesit broadband nga rrjetet fikse

##### Numri i pajtimtarëve

Megjithëse shërbimet e telefonisë nga rrjetet fikse kanë pësuar reduktim të ndjeshëm vitet e fundit, shërbimet e aksesit broadband nga rrjete fikse kanë pësuar rritje të qëndrueshme vjetore gjatë kësaj periudhe kohore.

Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks në fund të vitit 2019 arriti në rreth 433 mijë, që përbën një rritje me rreth 20% në krahasim me vitin 2018.

**GRAFIKU NR. 10** ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË AKESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE 2010-2019



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.


Grafiku më sipër paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve me akses broadband në periudhën 2010-2019 për operatorët kryesorë në treg.

Për vitin 2019 operatorët me pjesët më të mëdha të tregut fiks janë renditur si më poshtë:

- Albtelecom zotëron rreth 31% pjesë të tregut;
- Abcom zotëron 17% pjesë të tregut;
- ASC zotëron 12% pjesë të tregut;
- Abissnet me rreth 9% pjesë tregu;
- Rritje të ndjeshme gjatë viteve 2018 – 2019 ka shënuar kategoria OA (operatorë) të tjerë, e cila përbën rreth 30% të tregut gjatë vitit 2019, duke arritur në më shumë se 130 mijë pajtimtarë (operatorët më pjesën më të madhe në këtë kategori janë Digicom me rreth 4% të pjesës totale të tregut dhe Nisatel me rreth 3.2%).

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse për popullsi dhe për numër familjesh gjatë periudhës 2011-2019. Në vitin 2019 norma e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse ishte rreth 58% për familje dhe 15.5% për popullsi. Megjithëse numri i pajtimtarëve me akses broadband është në rritje të qëndrueshme, normat e penetrimit janë shumë më të ulëta se në vendet e BE dhe të rajonit.

**GRAFIKU NR. 11 PENETRIMI I AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE SIPAS POPULLSISË DHE FAMILJEVE (2011-2019)**



Burimi: Të dhënat e ardhura nga operatorët dhe popullsia Censusi i vitit 2011 të INSTAT.


Bazuar në të dhënat rajonale në vitin 2019, vërehet se qarqet me normat më të larta të penetrimit urban janë Tirana dhe Korça, përkatësisht me nga 36.73% dhe 22.42%, ndërsa Durrësi është qarku që ka normën më të lartë të penetrimit rural rreth 15%, i ndjekur nga Tirana dhe Shkodra me nga rreth 7%.

**Të ardhurat nga ofruesit e shërbimeve nga rrjetet fikse**

Bazuar në të dhënat e raportuara nga sipërmarrësit që ofrojnë shërbimet e komunikimeve elektronike nga rrjetet fikse, për vitin 2019 rezulton se në këtë treg janë realizuar rreth 8,687 milionë lekë të ardhura, shifër kjo rreth 5% më e lartë se të ardhurat e raportuara për vitin 2018.

Në grafikun në vijim, paraqitet shpërndarja e të ardhurave sipas operatorëve kryesorë.

**GRAFIKU NR. 12 TË ARDHURAT NGA OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË RRJETEVE FIKSE 2019 (MLN/LEKË)**



Burimi: Të ardhura nga operatorët. Përpunimi nga AKEP.

Nga të dhënat e paraqitura më sipër, vërehet se Altelecom është sipërmarrësi me pjesën më të madhe të të ardhurave të këtij tregu rreth 46%, i ndjekur nga Abcom me rreth 17% të tregut, ASC me rreth 7% dhe Abissnet me rreth 5%, ndërsa sipërmarrësit OA të tjerë zënë rreth 16% të të ardhurave të këtij tregu për vitin 2019.

## Paketat e integruara (*Bundles*)


Të dhënat e mësipërme tregojnë se shërbimi telefonik prej disa vjetësh rezulton të ketë marrë rol dytësor në shërbimet nga rrjete fikse. Nxitësi kryesor i zhvillimit të këtyre rrjeteve tashmë janë shërbimet e aksesit broadband dhe sidomos shërbimet e integruara (duo, triple dhe quad play).

Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa (*bundles*) të shërbimeve të aksesit në internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV), rezulton të jetë forma predominuese e konkurrencës midis operatorëve të rrjeteve fikse.

Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/ TV) në fund të vitit 2019 arriti në rreth 261 mijë, rreth 16% më shumë se në vitin 2018.

Në vitin 2019 pajtimtarët me paketa të integruara përbënin 61% të pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse, ndërsa 25% e pajtimtarëve me paketa të integruara janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

GRAFIKU NR. 13 NUMRI I PAJTIMTARËVE QË KANË AKSES NË SHËRBIME TË INTEGRUARA (TELEFONI, INTERNET DHE TV)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Gjatë vitit 2019, numri total i përdoruesve që përdorin shërbime të integruara arriti në rreth 261 mijë, duke shënuar rritje me rreth 16%.

Numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara në shporta triple play (Telefoni, Internet dhe TV), u rrit rreth 2% krahasuar me vitin 2018. Altelecom sipërmarrësi me pjesën më të madhe të këtij tregu pati një rritje me 10% krahasuar me një vit më parë në shportën Telefoni fikse dhe Internet, ndërkohë që 63% e përdoruesve me akses broadband të Altelecom ishin me paketa trefishe.

Tregu i ofrimit të shërbimeve broadband nga rrjetet fikse karakterizohet nga një numër i lartë pjesëmarrësish dhe si rezultat në këtë treg konkurrueshmëria është e lartë. Vetëm disa nga subjektet pjesë e këtij tregu kanë shtrirje të gjerë në disa qarqe të vendit, pjesa tjetër konkurrojnë në segmente më të vogla kryesisht janë ofrues lokalë.

Nga të dhënat e paraqitura në figurën e mësipërme, vërehet se përdorimi i shërbimeve të integruara

(Telefoni, Internet dhe TV) rezulton të jetë më i përdoruri ndër tre klasifikimet dhe është shoqëruar me një rënie gjatë vitit 2019 në krahasim me vitin 2018 (rreth 6 pikë përqindje), sikundër rritje të konsiderueshme ka pasur përdorimi i shërbimeve të integruara (Internet dhe TV) i cili arriti në rreth 66 mijë gjatë vitit 2019 në krahasim me vitin 2018. Ndërkohë që pjesa e tregut për shërbimet e integruara (Telefoni fikse dhe internet) është në të njëjtin nivel sa viti 2018 (rreth 41%).

## Teknologjia e përdorur

Teknologjia kryesore për ofrimin e aksesit broadband në rrjete fikse është DSL e ndjekur nga FTTH/FTTB. Shumica e lidhjeve DSL janë me rrjete të kombinuara fibër optike dhe bakri (FTTN/FTTC). Në Shqipëri lidhjet DSL përbëjnë 49% të totalit të lidhjeve broadband fikse dhe shumica e tyre është me kombinim fibër optike + linjë bakri apo FTTN/FTTC.


Lidhjet me fibër optike në Shqipëri (FTTH/B) për vitin 2019 përbëjnë 28% të totalit të lidhjeve dhe kanë një rritje prej rreth 4 pikë përqindje krahasuar me vitin 2018. Ofrimi i shërbimit të internetit nëpërmjet fibrës optike ofron marrjen e shërbimit me cilësi dhe qëndrueshmëri më të lartë.

## Shpejtësia e aksesit broadband

Tabela e mëposhtme tregon shpërndarjen e pajtimtarëve me akses broadband në internet në rrjetet fikse sipas shpejtësive të përdorura në 2015-2019. Siç mund të vihet re shpejtësia më e përdorur nga pajtimtarët është 4-10 Mbps me 55% në vitin 2019.

Në vitin 2019 rritjen më të madhe e kishte pjesa e pajtimtarëve me lidhje broadband me shpejtësi 1 Gbps në rreth 553 pajtimtarë.

GRAFIKU NR. 14 SHPËRNDARJA E PAJTIMTARËVE ME AKSES BROADBAND FIKS SIPAS SHPEJTËSISË 2015-2019



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Nga të dhënat e mësipërme vërehet se rreth 99% e pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse kanë akses me shpejtësi mbi 2Mbps.

Pjesa e pajtimtarëve me shpejtësi më të ulët se 2 Mbps është rreth 1% në vitin 2019 dukë shënuar një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2018.

Nga të dhënat mësipërme, konstatohet se gjatë viteve 2018-2019 është rritur ndjeshëm numri i pajtimtarëve që kanë akses broadband nga rrjetet fikse me shpejtësi 10-30 Mbps, gjë e cila përkthehet në cilësi më të lartë shërbimi për konsumatorët fundorë.

Gjithashtu, konstatohet trendi rritës drejt përdorimit të rrjetit me shpejtësi të lartë, ku pjesët me rritjen më të shpejtë janë pajtimtarët që përdorin shpejtësi nga 100 Mbps në 1 Gbps dhe pajtimtarët që përdorin 1 Gbps ose më shumë.

Vlen të theksohet se volumi i trafikut të internetit është rritur ndjeshëm gjatë vitit 2019 duke arritur në rreth 450 milionë Gbyte, nga rreth 200 milionë Gbyte që rezultonte në vitin 2018.

#### **4.1.5. Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës**

Në infrastrukturën aktive të shërbimeve të internetit nga rrjetet fikse me pakicë numri i bizneseve është 4,598 ndërkohë që numri i linjave të dhëna me qira është 3,810 me kapacitet total rreth 147 mijë mbit/s. Ndërkohë numri i operatorëve që ofrojnë akses me shumicë është 64 me 2,295 linja që arrijnë kapacitetin 208 mijë mbit/s.

Për sa i përket infrastrukturës pasive kontribuesi kryesor është Albtelecom, i cili ka rritur aksesin në vitin 2019 me 1244 km dark fibër dhe 73 km tubacione.

Sipërmarrësit e tjerë që kanë rritur aksesin në dhënie me qira të fibrës optike të pandriçuar (dark fibër) janë ATU me 202 km, Abcom me 130 km, ASC me 129 km dhe Abissnet me 89 km.

Albtelecom është ofruesi kryesor i aksesit me shumicë në elementët aktivë dhe pasivë të infrastrukturës në rrjete fikse.

Për vitin 2019, rreth 66% e fibrës optike dhe 95% e aksesit në tubacione janë ofruar nga Albtelecom.

#### **4.2. Vendimmarrjet lidhur me tregun e komunikimeve elektronike dhe masat rregullatore përgjatë vitit 2019**

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare gjatë vitit 2019 i ka kushtuar vëmendje të veçantë hartimit të dokumenteve të analizës së tregjeve celulare.

AKEP ka ndjekur me rigorozitet procedurën specifike të këshillimit të përcaktuar në nenet 34 dhe 35 të ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar vendimet për daljen në këshillim publik të dokumenteve të analizës së tregut si më poshtë:

- Vendimi Nr.10, datë 17.04.2019, miratimi për Këshillim Publik i dokumentit “*Analizë Tregu e Telefonisë Celulare për Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare, përfshirë Terminimin e Thirrjeve Hyrëse Ndërkombëtare*”.
- Vendimi Nr.11, datë 17.04.2019, miratimi për Këshillim Publik i dokumentit “*Analizë e Tregut me Shumicë të Aksesit dhe Origjinimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare*”.

Të dy dokumentet për vetë rëndësinë që paraqesin kanë dalë në këshillim publik për një periudhë dy mujore (18.04.2019 – 20.06.2019), për të cilat janë paraqitur komente/mendime nga Autoriteti i Konkurrencës dhe sipërmarrësit.

Dinamika e analizave të tregut në mënyrë kronologjike është zhvilluar si vijon:

## I. Tregu me shumicë i akses-origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare

Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin Nr.11, datë 17.04.2019 miratoi për Këshillim Publik dokumentin “Analizë e Tregut me Shumicë të Aksesit dhe Origjinimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare”.

Në procesin e analizës së tregut me shumicë të Akses Origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare, është përfshirë për efekt analize edhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare, por kjo vetëm për efekt të evidentimit të problemeve të konkurrencës (plotësimi të Testit të Tre Kriteve<sup>5</sup> dhe nëse plotësohet ky test, përcaktimit të sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) dhe vendosjes së masave rregullatore përkatëse).

Sipas udhëzuesit të Komisionit Evropian për analizën e tregjeve, rregullimi ex-ante duhet të vendoset vetëm në rastet kur masat që mund të aplikohen nëpërmjet ligjit të konkurrencës janë të pamjaftueshme për të adresuar problemet e identifikuar të konkurrencës.

Qëllimi i analizave të tregut ka qenë evidentimi i problemeve të konkurrencës, shpalljes së operatorëve me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse, marrja e masave rregullatore dhe miratimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare në funksion të arritjes së objektivave të AKEP për të:

- promovuar eficientësinë e rrjeteve celulare;
- promovuar konkurrencën e qëndrueshme në tregun me pakicë të shërbimeve celulare;
- mundësuar përfitime më të mëdha pajtimtarëve nga shërbimet e komunikimeve elektronike (celulare).

Në mënyrë kronologjike dinamika e vendimmarrjes për analizat e tregjeve me shumicë të Akses Origjinimit është si vijon:

- Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar vendimin Nr. 16 datë 22.02.2018 për “*Miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Këshillim publik”*”.
- Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar vendimin Nr. 78 datë 01.10.2018 për “*Miratimin të dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – dokument përfundimtar”*”.
- Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar vendimin Nr. 79 datë 01.10.2018 për “*Përcaktimin e Sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe masat përkatëse Rregullatore*”.
- Me vendimet Nr. 80 dhe 81, Këshilli Drejtues ka miratuar vendimet respektive për përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom dhe Telekom Albania sh.a me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare si dhe masat përkatëse Rregullatore.

<sup>5</sup> (i) Prezenca e barrierave të larta dhe jo-kalimtare të hyrjes;  
(ii) Një strukturë tregu e cila nuk ka tendencë për të shkuar në drejtimin e një konkurrencë efektive brenda afatit kohor përkatës;  
(iii) Pamjaftueshmëria e ligjit të konkurrencës për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dështimin e tregut të marre në shqyrtim.

- Me vendimin Nr. 82 datë 01.10.2018, KD i AKEP vendosi për “*Miratimin për këshillim publik të dokumentit*” Rregullimi i tarifave të Sipërmarrësve me fnt në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit të shërbimeve celulare”.
- Ndërkohë, me Vendimin Nr. 89 datë 15.11.2018, Këshilli Drejtues i AKEP vendosi “*Shfuqizimin e Vendimit nr.78, datë 01.10.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentit: “Analizë e Tregut Celular: Tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – dokument përfundimtar”, si dhe shfuqizimin e vendimeve të Këshillit Drejtues përkatësisht nr.79, nr.80, nr.81 dhe nr.82, datë 01.10.2018”*”.

Në përfundimin e periudhës së këshillimit publik të Vendimit Nr.11, datë 17.04.2019 “*Analizë e Tregut me Shumicë të Aksesit dhe Origjinimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare-Këshillim Publik*” dhe pas marrës së opinionëve të palëve të interesuara rreth çështjeve kryesore<sup>6</sup>, AKEP i ka diskutuar ato gjerësisht me ekspertë të Komisionit Evropian në nivel teknik përmes dy conference call gjatë muajve gusht dhe tetor. Gjithashtu, dokumenti është diskutuar si në takime dypalëshe të niveleve të ndryshme (OFcom, Komisioni Evropian) edhe në takime në kuadër të forumeve të BEREC.

Lidhur me procesin e analizave të tregut celular, Komisioni i Konkurrencës ka paraqitur dy mendime, të parashtruara nëpërmjet:

A. Vendimit nr. 635, datë 04.07.2019, në të cilin i rekomandon AKEP-it si më poshtë vijon:

- Të realizojë analizën e tregut të pakicës të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu, për përcaktimin e ndërmarrjes “Vodafone Albania” sh.a me FNT në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe vendosjen e masave rregullatore përkatëse;
- Të vendosë nën rregullim tarifat e shërbimeve celulare me pakicë për ndërmarrjen me FNT, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9918/2008 të njëkohshme me tregun me shumicë të aksesit origjinimit;
- Rregullimi i tarifave me pakicë për operatorin me FNT duhet të adresojë problemet e evidentuara nga analiza e tregut e AKEP, si: i. on-net vs off-net në mungesë të masave të rregullimit të tarifave të shumicës për terminimin e thirrjeve; ii. Tarifat standarde jashtë ofertave janë shumë të larta;
- Krijimin e lehtësirave për hyrjen në treg të MVNO-ve, duke vendosur detyrime të qarta për ndërmarrjen me FNT për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit;
- Të vendosë nën rregullim tarifat e shërbimeve celulare me pakicë për ndërmarrjen me FNT, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9918/2008 të njëkohshme me tregun me shumicë të aksesit origjinimit.

Në datën 21.11.2019, katër muaj pas vendimit të parë për këtë çështje, Komisioni i Konkurrencës miraton dhe i përcjell AKEP-it, një vendim të dytë për çështjen e analizave nëpërmjet:

B. Vendimit nr.661, “Për dhënien e disa rekomandimeve për Autoritetin të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, përpara marrjes së vendimit përfundimtar lidhur me dokumentin për këshillim publik “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare” rekomandon si vijon:

<sup>6</sup> Në zbatim të vendimit Nr. 89, datë 15.11.2018 të Këshillit Drejtues ku ndër të tjera citohet: “AKEP do të bashkëpunojë ngushtësisht me strukturat e Komisionit Evropian për të përfituar ekspertizën dhe kontributin e ofruar prej tyre në këtë proces”

Përpara marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për këshillim publik “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare”, të vlerësojë:

- Komentet e Vodafone Albania, depozituar në AKEP më datë 18.06.2019 lidhur me Analizën e Tregut të shërbimeve celulare në përgjithësi;
- Të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit Evropian për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2018/C 159/01) sipas kuadrit rregullator për komunikimet.

Në kushtet kur tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare nuk është pjesë e listës së tregjeve të përcaktuara në Rekomandimin e Komisionit Evropian të vitit 2003, si dhe të tregjeve të identifikuar në Rregulloren nr. 9/2009 të AKEP, dokumenti “*Analizë e tregut me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare*”, në të cilin ishte përfshirë për efekt të analizës dhe jo si pjesë e mëvetësishme edhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare, lipsej t’i nënshtrohej sërish verifikimit të saktësisë dhe efektivitetit të testit të tre kritereve.

Ky rekomandim i Komisionit të Konkurrencës e orienton Testin e Tre Kritereve drejt mos plotësimit të kriterit të tretë, pasi AK i rekomandon AKEP vlerësimin e komenteve të Vodafone Albania dhe rekomandimin e Komisionit Evropian ku tregu i akses origjinimit dhe ai i pakicës nuk janë në rregullim nga Rregullatorët Kombëtarë (NRA) dhe ligji i konkurrencës i zbatuar nga Autoritetet e Konkurrencës është i mjaftueshëm për të zgjidhur problemet e konkurrencës në tregjet përkatëse.

Për rrjedhojë, rregullimi *ex-ante* i tregut me shumicë të akses-origjinimit, ndërhyrja paraprake e AKEP për përcaktimin e sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e detyrimeve rregullatore përkatëse, në referim të nenit 3, pika 5, të rregullores nr. 9/2009, nuk paraqiten si masa në përpjesëtim të drejtë me objektivin e mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe eficiente në kuadrin e ligjit 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, për sa kohë ky objektivi është i realizueshëm nëpërmjet instrumenteve të legjislacionit specifik nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Konkurrencës.

Sa më lart, lidhur me dokumentin “Analiza e tregut me Shumicë të Aksesit dhe Origjinimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare”, Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 9, datë 24.04.2020 “Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik për dokumentin “Analizë e tregut me shumicë të akses origjinimit në rrjetet celulare” ka vendosur:

1. Të vlerësojë si të paplotësuar testin e tre kritereve të sanksionuar në pikën 4 të nenit 3 të Rregullores, në përfundim të analizës së tregut kryer sipas përcaktimeve dhe hapave procedurale të parashikuara nga ligji 9918/2008 dhe Rregullorja 9/2009;
2. Të mos përcaktojë sipërmarrës me fuqi të ndjeshme duke mos vendosur detyrime rregullatore në tregun me shumicë të akses-origjinimit në rrjetet celulare, si pasojë e mosplotësimit të testit të tre kritereve, konform pikës 4 të nenit 5 të Rregullores;

## **II. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare**

Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin Nr.10, datë 17.04.2019 ka miratuar për Këshillim Publik dokumentin “*Analizë Tregu e Telefonisë Celulare për Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare, përfshirë Terminimin e Thirrjeve Hyrëse Ndërkombëtare*”.

Dokumentin ka dalë në këshillim publik dhe janë marrë mendime nga palët e interesuara dhe Autoriteti i Konkurrencës.

Në mënyrë kronologjike vendimmarrja e AKEP ka qenë si vijon:

- Me vendimin Nr.11 datë 22.02.2018, Këshilli Drejtues i AKEP ka vendosur për “Miratimin e Dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Dokumenti Përfundimtar”;
- Me vendimet 12, 13, 14, KD i AKEP ka vendosur përcaktimin respektivisht të sipërmarrësit Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm dhe vendosjen e masave rregulluese për FNT;
- Me vendimin Nr.15 datë 22.02.2018, KD i AKEP ka vendosur për ” Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare–Këshillim Publik 2”;
- Pas këshillimit publik, me vendimin Nr.70 datë 01.10.2018, KD i AKEP ka vendosur për “Miratimin e dokumentit: Rregullimi i tarifave të Sipërmarrësve me fnt në tregjet me shumicë të terminimit te thirrjeve në rrjetet celulare – dokumenti përfundimtar”;
- Me vendimet Nr.71, 72 dhe 73, të datës 01.10.2018, Këshilli Drejtues i AKEP ka vendosur rregullimin e tarifave të sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a, Telekom Albania sh.a dhe Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg, për tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm.

Sipas benchmarkut të BEREC<sup>7</sup> tarifa e terminimit u ul nga 1.44 lekë/min në 1.22 lekë/minutë nga 1 dhjetori 2018 dhe në 1.11 lekë nga 1 dhjetori 2019, tarifë kjo që vijon të jetë ende në fuqi.

AKEP pas përfundimit të procesit të konsultimit publik të Vendimit Nr.10, datë 17.04.2019 “*Analizë Tregu e Telefonisë Celulare për Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare, përfshirë Terminimin e Thirrjeve Hyrëse Ndërkombëtare*”, është në proces të shqyrtimit të komenteve të palëve të interesuara/sipërmarrësve si dhe vendimeve/rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Konkurrencës dhe do të marrë vendimet përkatëse.

### **Masat rregullatore për shërbimin Roaming**

AKEP me Vendim Nr.14, datë 7.05.2019 miratoi për Këshillim Publik dokumentin “Rregullimi i Tarifave të Shërbimeve Roaming Shqipëri - Ballkani Perëndimor” i cili përmban propozimin e AKEP për rregullimin e tarifave me shumicë dhe me pakicë të roamingut sipas përcaktimeve të “Marrëveshja mbi Reduktimin e Çmimeve të Shërbimeve Roaming në Rrjetet Publike të Komunikimit Celular në Rajonin e Ballkanit Perëndimor”, të nënshkruar më 4 prill 2019.

Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin Nr.7, Datë 15.03.2019 miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri –Kosovë - Këshillim publik”. Dokumenti u publikua në faqen zyrtare të internetit të AKEP dhe procedura e këshillimit publik përfundoi më datë 15.04.2019.

AKEP me Vendim Nr.15, datë 11.05.2019 miratoi dokumentin përfundimtar “Rregullimi i tarifave të shërbimeve Roaming Ndërkombëtar Shqipëri - Kosovë”, i cili përmban përcaktimet finale të AKEP të rënë dakord me ARKEP, për rregullimin e tarifave me shumicë dhe me pakicë të aplikuar nga operatorët celularë Shqiptarë për shërbimet roaming me Republikën e Kosovës, përfshirë rregullimin e tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime, si dhe afatet përkatëse

<sup>7</sup> [https://berec.europa.eu/eng/document\\_register/subject\\_matter/berec/reports/8900-termination-rates-at-european-level](https://berec.europa.eu/eng/document_register/subject_matter/berec/reports/8900-termination-rates-at-european-level)

për zbatimin e modelit Roam Like At Home (RLAH) gradualisht duke filluar nga 15 qershor 2019.

AKEP me Vendimet Nr.16, 17 dhe 18 datë 11.05.2019 miratoi dokumentat “Rregullimi i shërbimeve dhe tarifave Roaming Ndërkombëtar Shqipëri - Kosovë të ofruara nga sipërmarrësit”, përkatësisht Albtelecom Sh.a, Telekom Sh.a dhe Vodafone Albania Sh.a. Detyrimet e vendosura në këtë vendim për këta sipërmarrës nga AKEP janë simetrike me detyrimet e vendosura për operatorë të tjerë të rrjeteve celulare publike në RSH, si dhe janë objekt i zbatimit reciprok të detyrimeve të vendosura nga ARKEP për operatorët celularë në RK.

Përcaktimet në këtë akt përfshijnë gjithashtu rregulla që synojnë rritjen e transparencës së tarifave dhe përmirësime në informacionin për tarifën për përdoruesit e shërbimeve roaming të Albtelecom, Telekom dhe Vodafone. Rregullat janë detyrueshme për t’u zbatuar nga këta operatorë si sipërmarrës të rrjeteve publike celulare të autorizuar në RSH sipas ligjit 9918. Rregulla reciproke do të aplikohen paralelisht dhe për operatorët celularë në RK sipas përcaktimeve të ARKEP.

AKEP me Vendim Nr.21, datë 24.06.2019 miratoi dokumentin “Rregullimi i tarifave të shërbimeve Roaming Ndërkombëtar Shqipëri - Ballkani Perëndimor, Dokument Përfundimtar”, i cili përmban përcaktimet finale të AKEP për detyrimet ndaj tre operatorëve celularë të Shqipërisë për rregullimin e tarifave me shumicë dhe me pakicë të aplikuar nga këta operatorë për shërbimet roaming me vendet e tjera të BP, përfshirë rregullimin e tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime, afatet përkatëse për zbatimin e modelit Roam Like At Home (RLAH) gradualisht duke filluar nga 1 korrik 2021, si dhe fazës tranzitore për modelin RLAH+ në periudhën 1.07.2019-30.06.2021. Tarifat e përcaktuara dhe afatet e aplikimit të tyre, përfshirë modelet RLAH+ dhe RLAH, janë sipas marrëveshjes RRA WB6 të nënshkruar më 4 prill 2019.

AKEP me Vendimet Nr.22, 23 dhe 24 datë 24.06.2019 miratoi dokumentat “Rregullimi i shërbimeve dhe tarifave Roaming Ndërkombëtar Shqipëri - Ballkani Perëndimor” të ofruar nga sipërmarrësit përkatësisht Telekom Albania sh.a, Vodafone Albania sh.a dhe Albtelecom sh.a. Objekt i këtij rregullimi është përcaktimi i modaliteteve dhe kushteve për zbatimin e “Marrëveshje për reduktimin e çmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor” (RRA WB6) e nënshkruar nga ministritë përgjegjëse për komunikimet elektronike të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, dhe Serbia) në Beograd më 4 Prill 2019. Ky vendim përcakton rregullat për të garantuar që përdoruesit/pajtimtarët e Telekom Albania sh.a, Vodafone Albania sh.a dhe Albtelecom sh.a, të mos paguajnë tarifa më të larta për shërbimet celulare gjatë roamingut në rajonin e Ballkanit Perëndimor (BP) në krahasim me tarifën konkurruese që paguajnë për shërbimet celulare kur janë në RSH, duke arritur ndërkohë një nivel të lartë të mbrojtjes së konsumatorit, dhe nxitje të konkurrencës dhe transparencës në treg.

Gjatë vitit 2020, AKEP do të vijojë me implementimin e marrëveshjeve dhe akteve rregullatorë të nxjerra në zbatim të tyre.

### 4.3. TREGU POSTAR

#### Tregues të volumit të shërbimit postar

Numri total i objekteve postare të pranuar gjatë vitit 2019 nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ishte rreth 29 milionë objekte.

Numri i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare gjatë vitit 2019 është rritur me 15%, ndërsa numri i përgjithshëm i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ka pësuar një rritje me 16.6% krahasuar me vitin 2018.

TABELA NR. 7 TË DHËNA MBI KATEGORITË Kryesore të Objekteve Postare (2017-2019)

Shërbime postare të ofruara	Objekte postare 2017	Objekte postare 2018	Objekte postare 2019	Ndryshim 2019/2018
<b>Posta Shqiptare sh.a</b>				
<b>1 Shërbim Universal Postar</b>				
1.1 Postë brenda vendit	18,599,662	18,298,143	19,617,824	7.2%
1.2 Postë ndërkombëtare	1,322,758	1,413,574	4,852,454	243.3%
<b>1.3 Totali 1.1+1.2</b>	<b>19,922,420</b>	<b>19,711,717</b>	<b>24,470,278</b>	<b>24.1%</b>
<b>2 Shërbim joniversal postar</b>				
2.1 Postë brenda vendit	2,603,017	2,819,601	1,486,594	-47.3%
2.2 Postë ndërkombëtare	9,702	6,616	7,389	11.7%
<b>2.3 Totali 2.1+2.2</b>	<b>2,612,719</b>	<b>2,826,217</b>	<b>1,493,983</b>	<b>-47.1%</b>
<b>3 Shërbim ekspres</b>				
3.1 Ekspres brenda vendit	724,794	699,731	647,849	-7.4%
3.2 Ekspres ndërkombëtar	25,764	18,842	68,948	265.9%
<b>3.3 Totali 3.1+3.2</b>	<b>750,558</b>	<b>718,573</b>	<b>716,797</b>	<b>-0.2%</b>
<b>Ofruesit e shërbimeve postare</b>				
<b>4 Shërbim JoUniversal Postar</b>				
4.1 Postë brenda vendit	277,504	490,900	655,796	33.6%
4.2 Postë ndërkombëtare	34,632	35,486	39,769	12.1%
<b>4.3 Totali 4.1+4.2</b>	<b>312,136</b>	<b>526,386</b>	<b>695,565</b>	<b>32.1%</b>
<b>5 Shërbim ekspres</b>				
5.1 Ekspres brenda vendit	1,050,783	1,408,298	2,010,034	42.7%
5.2 Ekspres ndërkombëtar	206,705	222,725	246,931	10.9%
<b>5.3 Totali 5.1+5.2</b>	<b>1,257,488</b>	<b>1,631,023</b>	<b>2,256,965</b>	<b>38.4%</b>
<b>6 Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3</b>	<b>24,855,321</b>	<b>25,413,916</b>	<b>29,633,588</b>	<b>16.6%</b>

Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi nga AKEP.


#### Të ardhurat dhe investimet

Bazuar në të dhënat e raportuara për vitin 2019 subjektet e ofrimit të shërbimeve postare në, të ardhurat financiare në tregun postar rezultojnë të jenë 2,35 miliard lekë, shifër kjo që përbën një rritje me rreth 10% krahasuar me të ardhurat e vitit 2018.

Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron ofruesi i shërbimit Universal Posta Shqiptare sh.a me një total të ardhurash 1,5 miliard lekë, nga të cilat rreth 1.3 miliardë lekë janë të ardhura të gjeneruara nga shërbimi universal.

Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar të ardhura në total rreth 825 milionë lekë, rreth 12% më shumë se viti 2018.

Në grafikun e mëposhtëm jepet shpërndarja e pjesëve të tregut postar bazuar në të ardhurat e raportuar nga sipërmarrësit për vitin 2019.




Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi nga AKEP.

Posta Shqiptare sh.a zotëron 65% të të ardhurave të tregut të shërbimeve postare duke shënuar rritje me rreth 9% të të ardhurave nga shërbimet postare krahasuar me vitin 2018.

Ndërkohë operatori i shërbimeve postare DHL shoqëria e dytë me pjesën më të madhe në treg, gjatë vitit 2019 ka rritur ndjeshëm të ardhurat duke shkuar në rreth 520 milionë lekë, nga rreth 200 milionë që raportonte në vitin 2018.

Operatori i shërbimeve postare Albania Delivery Express ka pasur rritje me rreth 30% gjatë vitit 2019, ndërsa operatorët e tjerë që kanë raportuar të dhënat kanë pjesë tregu më të vogla se 2%.

Të gjithë sipërmarrësit që kanë raportuar të dhënat financiare paraqiten me rezultat financiar neto pozitiv, me përjashtim të subjektit 'E-Komplet' i cili rezulton me humbje.




Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP

Të ardhurat nga shërbimet postare për Postën Shqiptare për vitin 2019 janë 1,5 miliard dhe kanë shënuar rritje me rreth 9% krahasuar me vitin 2018, ku pjesën më të madhe e përbëjnë të ardhurat nga Shërbimi Postar Universal.

Grafiku mëposhtëm parqet ecurinë e të ardhurave dhe investimeve në sektorin postar në vitet 2012-2019.

Shifra e investimeve të raportuara për vitin 2019 është shifra me ulët ndër vitet e marra në analizë, ndërsa të ardhurat e raportuara janë në nivelin më të lartë që nga viti 2012.

**GRAFIKU NR. 17** ECURIA E TË ARDHURAVE DHE INVESTIMEVE 2012-2019



Burimi: AKEP

### Të punësuarit në sektorin postar

Nga të dhënat statistikore të mbledhura nga Posta Shqiptare sh.a dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, për vitin 2019 në sektorin postar ishin të punësuar 2,993 punonjës. Posta Shqiptare ka 2,421 të punësuar, ose 83% të punësuarve në sektorin postar. Operatorët e tjerë postarë kanë një numër shumë më të vogël të punësuarish dhe operatori me numrin më të madh të të punësuarve në vitin 2019 është Ulysses Enterprises (FEDEX) me 94 punonjës.



# 5.

## SISTEMI I AUTORIZIMEVE, ADMINISTRIMI I FREKUENCAVE DHE DOMAIN-EVE

### 5.1. Regjimi i Autorizimit të Përgjithshëm

#### 5.1.1. Regjistrimi i sipërmarrësve për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike


Bazuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregulloren Nr. 47 datë 26.10.2017 “Për zbatimin e Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare nëpërmjet aplikimeve të kryera nga sipërmarrësit në modulën (portalin) online, pajis me Autorizim çdo subjekt që kërkon të regjistrohet për fillimin e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike. Gjithashtu, nëpërmjet këtij moduli online, sipërmarrësit e regjistruar në AKEP kanë mundësi të përditësojnë të dhënat e rrjeteve, shërbimeve, zonave të mbulimit dhe të tjera.

AKEP administron Regjistrin e Sipërmarrësve të cilin e publikon periodikisht të përditësuar, në faqen e internetit: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Në total figurojnë të regjistruar 263 sipërmarrës për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve, nga këto 58 regjistrime janë kryer gjatë vitit 2019.


Grafikët e mëposhtëm tregojnë sipërmarrësit që kanë kryer njoftime online dhe janë regjistruar në AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2019.

GRAFIKU NR. 18 SIPËRMARRËS PËR OFRIMIN E RRJETEVE DHE/OSE SHËRBIMEVE PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE




Burimi: AKEP

**GRAFIKU NR. 19 SIPËRMARRËS PËR OFRIMIN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE, QË MUNDËSOJNË TRANSMETIMIN E PROGRAMEVE AUDIOVIZUALE**




Burimi: AKEP

**GRAFIKU NR. 20 SIPËRMARRËS QË OFROJNË SHËRBIME PUBLIKE TELEFONIKE**



Burimi: AKEP

**GRAFIKU NR. 21 NUMRI I SIPËRMARRËSVE SIPAS SHËRBIMEVE TË TJERA**



Burimi: AKEP

Vlen të theksohet fakti që gjatë vitit 2019, të gjitha njoftimet e sipërmarrësve për fillim ofrimi rrjetesh të komunikimeve elektronike janë paraqitur për ndërtim rrjetesh vetëm me fibra optike.

Kjo përbën një risi pasi janë rritur shumë investimet e operatorëve në rrjete të fibrave optike, duke përmirësuar kështu shpejtësitë e ofrimit të shërbimit, cilësinë e shërbimit, reduktimin e kabllave që përdorin dhe llojet e pajisjeve të teknologjive të vjetra që instaloheshin në terren dhe tek abonenti, duke i zëvendësuar ato me teknologji të reja bashkëkohore.

### **5.1.2. Regjistrimi i ofruesve të shërbimeve postare**

- Gjatë vitit 2019 kanë ushtruar aktivitet:
  - 1 ofrues i shërbimit universal postar (Posta Shqiptare sh.a);
  - 19 ofrues të shërbimeve postare.
- Gjatë vitit 2019 janë regjistruar në AKEP:
  - 4 ofrues të rinj për ofrimin e shërbimeve postare;
  - 2 kërkesa për çregjistrime si ofrues të shërbimeve postare.

## **5.2. Autorizimet Individuale**

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, administron spektrin e frekuencave të caktuar për përdorim për qëllime civile, përveç frekuencave të caktuara për transmetimet radio dhe televizive.

Sipërmarrësit apo subjektet (persona fizikë apo juridikë) mund të përdorin frekuenca vetëm pasi të jenë pajisur paraprakisht, me Autorizim Individual nga AKEP.

### **5.2.1. Autorizimet Individuale të operatorëve celularë**

Gjatë vitit 2019 kanë vazhduar të ofrojnë shërbime telefonike të lëvizshme dhe shërbime broadband në rrjetet celulare 3 operatorë (Vodafone Albania sh.a, Telekom Albania sh.a dhe Albtelecom sh.a), të pajisur nga AKEP me Autorizime Individuale për përdorim frekuencash në brezat GSM/UMTS/IMT/LTE, të njohura si 2G/3G/4G.

### **5.2.2. Autorizimet Individuale të brezit 800 MHz (DD1)**

Në datën 07.02.2019, bazuar në dokumentin e tenderit të miratuar pas këshillimit publik, AKEP zhvilloi procedurën e tenderit publik me procedurë të hapur me objekt “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz)*”, Ref. *1x10 MHz i çiftuar-800-2018*”.

Në përfundim të procedurës së vlerësimit, u klasifikua si ofertë e vlefshme oferta e shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a, për 1 (një) të drejtë përdorimi të frekuencave të brezit 800 MHz (792-862 MHz) - bllokun A2 të frekuencave të brezit 800 MHz, me ofertë ekonomike 7 440 001 (shtatë milionë e katërqind e dyzet mijë e një) Euro.

Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin Nr. 6, datë 04.03.2019 ka miratuar Autorizimin Individual të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a për përdorimin e frekuencave të bllokut A2, 801-811 MHz (10 MHz) i çiftuar me 842-852 MHz (10 MHz) të frekuencave të brezit 800 MHz (792-862 MHz). Afati i vlefshmërisë së këtij autorizimi individual do të jetë 15 vjet, deri më datë 04.03.2034.

Ne vijim të procedurave për dhënien e të drejtave të tjera të lira në përdorim, AKEP në datën 09.09.2019, zhvilloi procedurën e tenderit publik me procedurë të hapur me objekt “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz), spektër i paalokuar, Ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2019*”, për dy brezat e tjerë të lirë.

Në përfundim të procedurës së vlerësimit u klasifikua si ofertë e vlefshme oferta e shoqërisë “Telekom Albania” sh.a, për 1 (një) të drejtë përdorimi të frekuencave të brezit 800 MHz (792-862 MHz) - bllokun A3 të frekuencave të brezit 800 MHz, me ofertë ekonomike 7 441 000 (shtatë milionë e katërqind e dyzet e një mijë) Euro.

Me Vendimin Nr. 33 datë 27.09.2019, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar Autorizimin Individual të sipërmarrësit Telekom Albania sh.a për përdorimin e frekuencave blloku A3: 811-821 MHz (10 MHz) i çiftuar me 852-862 MHz (10 MHz) të brezit 800 MHz (790-862 MHz). Afati i vlefshmërisë së këtij autorizimi individual do të jetë 15 vjet, deri më datë 27.09.2034.

- Në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz) është një e drejtë përdorimi, e pa alokuar, konkretisht blloku A1: 791-801 MHz (10 MHz) i çiftuar me 832-842 MHz (10 MHz).
- Procedurat për dhënien në përdorim të saj do të vijojnë përgjatë vitit 2020.

### **5.2.3. Rinovimi i Autorizimit Individual sipërmarrësit Albtelecom sh.a. për përdorimin e frekuencave të brezave 900/1800 MHz**

Në përfundim të afatit të vlefshmërisë datë 01.03.2019, të Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave në brezat 900 MHz dhe 1800 MHz, të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, AKEP menjëherë ka filluar procedurën administrative për vlerësimin e përmbushjes së të gjitha kushteve të përdorimit të këtyre frekuencave, në përputhje me përcaktimet e VKM-së nr.496, datë 22/07/2014 “Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrin”.

Në përfundim të procedurës AKEP ka miratuar Vendimin e Këshillit Drejtues nr.13 datë 26.04.2019 “Për miratimin e raportit përmbledhës të vlerësimit mbi përmbushjen e kushteve të përdorimit të frekuencave 900 dhe 1800 MHz të sipërmarrësit Albtelecom sh.a”, të shoqëruar gjithashtu me propozimin mbi çmimin referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual. Raporti përmbledhës, së bashku me propozimin për çmimin referencë minimal është përcjellë pranë Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim ndjekjen e mëtejshme të procedurave të negocimit nga kjo e fundit.

Gjithashtu, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual të këtij sipërmarrësi deri në nënshkrimin e aktit të dakordësisë dhe marrjen e njoftimit zyrtar nga MIE mbi përfundimin e procedurës së negocimit.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë më datë 03.10.2019 ka paraqitur në AKEP, Aktin e Dakordësisë të nënshkruar nga Komisioni *ad hoc* dhe Albtelecom sh.a, ku është rënë dakord lidhur me:

1. Çmimin prej 10.900.000 Euro (dhjetë milion e nëntë qind mijë Euro) për rinovimin e Autorizimit Individual të përdorimit të frekuencave në brezin 900 MHz dhe 1800 MHz, të dhëna në përdorim sipërmarrësit Albtelecom sh.a.
2. Mënyrën e Pagesës së Rinovimit të Autorizimit Individual të cilat do kryhen në dy këste si më poshtë:
  - 50% e shumës brenda datës 31.10.2019;

- 50% e shumës, brenda datës 31.03.2020 + interesin e llogaritur me yield mesatar të ponderuar të bonove të thesarit me afat maturimi 6 mujor, të emetuar në datën më të afërt që i paraprin kryerjes së pagesës së kështit të parë.

Pas marrjes së konfirmimit mbi shlyerjen e kështit të parë të pagesës në llogarinë e Qeverisë Shqiptare, AKEP me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 37, datë 31.10.2019 miratoi rinovimin e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz dhe 1800 MHz të sipërmarrësit Albtelecom sh.a.

Albtelekom ka shlyer tashmë të dy kështet e pagesave për rinovimin e Autorizimit Individual, sipas aktit të dakordësisë.

#### **5.2.4. Situata me brezin e frekuencave 700 MHz (5G)**

Brezi 700 MHz, sipas përkufizimeve të Ligjit nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të Digjital Dividentit”, aktualisht administrohet nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). Ky brez përdoret nga disa operatorë audiovizivë të cilët janë pajisur me licenca nga AMA.

Brezi 700 MHz vlerësohet si shumë i rëndësishëm për sigurimin e mbulimit të gjerë me rrjet valor dhe shërbime, veçanërisht në zonat që paraqesin sfida ekonomike, të tilla si zonat rurale, malore ose të largëta. Ky brez është i përshtatshëm për të siguruar mbulim efikas mbi fusha të gjera dhe mbulim të përmirësuar të brendshëm, duke u përshtatur si për rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të komunikimeve mobile të ofruara nga teknologjitë 4G por edhe për vendosjen e teknologjive të reja të komunikimit mobil të gjeneratës së ardhshme të njohura si 5G ose IMT - 2020.

Frekuencat në brezin 700 MHz, do të zgjerojnë përdorimin e spektrit të frekuencave nën 1 GHz për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve mobile me brez të gjerë, për pasojë do të lehtësojnë vendosjen e rrjeteve 5G si dhe futjen e gjerë të shërbimeve digjitale inovative.

Parlamenti Evropian ka vendosur që ky brez brenda datës 30 qershor 2020 duhet të jetë i lejuar për ndërtimin e rrjeteve valore tokësore që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, nga të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Deri në datën 30 qershor 2022, vendet anëtare të BE duhet të lëshojnë të drejtat për përdorimin e brezit të frekuencave 700 MHz (Autorizimet Individuale).

AMA, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe AKEP kanë zhvilluar disa takime të përbashkëta për mënyrat e lirimit të brezit 700 MHz.

Në vitin 2019, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka iniciuar hartimin e Strategjisë 5G në Shqipëri. MIE ka përgatitur draftin e parë të strategjisë si dhe ka kryer konsultimet e para të draftit me AKEP, AMA dhe grupet e interesit.

Pjesë e rëndësishme e kësaj strategjie është edhe brezi 700 MHz, mënyrat e lirimit të tij nga operatorët radio televizive, kalimi nën administrimin e AKEP me qëllim dhënien në përdorim të këtij brezi operatorëve të rrjeteve mobile, vendosjen e afateve fikse në Planin Kombëtar të Frekuencave për lirimin e tij, sasinë e spektrit për përdorime PPDR (Public Protection and Disaster Relief) etj.

Ndërkohë dhe vetë AKEP ka hartuar një dokument studimor për zhvillimet potenciale të rrjeteve të gjeneratës 5G në Shqipëri. Gjithashtu, ai është në konsultim të përkohshëm me aktorët e sektorit lidhur me investimet e domosdoshme në infrastrukturë dhe përfshirjen e tyre në implementimin e 5G.

### **5.2.5. Situata me brezin e frekuencave 3400-3800 MHz (5G)**

Brezi 3400-3600 MHz dhe brezi 3600-3800 MHz mbështet shërbimet mobile me brez të gjerë. Aktualisht është brez i lirë dhe gjatë vitit 2019 ka pasur shprehje interesi vetëm nga sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a për ta testuar këtë brez frekuencash.

#### **Testimi i brezit 3400-3800 MHz nga Vodafone Albania sh.a**

Bazuar në kërkesën e Vodafone Albania sh.a, Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 34 datë 14.10.2019, ka pajisur këtë sipërmarrës me Autorizim Individual për përdorim frekuencash të brezit 3600-3700 MHz, sasi spektri 100 MHz i paçiftuar, për kërkim, matje dhe provë deri në datën 14.12.2019.

Vodafone Albania sh.a i përdori këto frekuenca për:

- Testim të teknologjisë 5G New Radio.
- Testim të konceptit Massive MIMO.
- Testim të Shpejtësive Maksimale me Carrier Aggregation LTE + 5G New Radio.
- Testim të latency (performancës së rrjetit në transferimin e të dhënave).

Teknologjia e përdorur nga Vodafone për këto testime ishte NOKIA.

Vodafone Albania sh.a konfirmon se testi i brezit 3600-3700 MHz rezultoi plotësisht i suksesshëm dhe tashmë ky Sipërmarrës është gati të zhvillojë rrjetin 5G dhe të ofrojë shërbimin 5G në Shqipëri, sapo frekuencat përkatëse të jenë të disponueshme për operatorët.

### **5.2.6. Situata me brezin e frekuencave 26 GHz (5G)**

Brezi frekuencave 26 GHz (5G), është i lirë dhe gjatë vitit 2019 nuk ka pasur shprehje interesi nga operatorët celularë për këtë brez frekuencash.

Shqipëria nuk ka caktime frekuencash për lidhje fikse në këtë brez, në dallim me disa vende të Rajonit dhe BE të cilat duhet t'i lirojnë dhe kalojnë për përdorime 5G.

Vlen të theksohet që ky brez, meqenëse është një nga brezat e rrjeteve të gjeneratës së 5-të (5G), është pjesë e Strategjisë 5G që po hartohet nga MIE.

### **5.2.7. Autorizimet Individuale për përdorimin e frekuencave në lidhje fikse, sisteme satelitore, sisteme PMR radiokomunikimi/radioalarmi etj.**

Gjatë vitit 2019, për sipërmarrësit e shërbimeve të komunikimeve elektronike janë lëshuar nga AKEP:

- 41 autorizime individuale për përdorimin e frekuencave në 339 lidhje fikse të reja ose të ndryshuara;
- 4 autorizime individuale për përdorimin e frekuencave në sisteme satelitore (VSAT);
- 282 autorizime Individual për përdorimin e frekuencave në sisteme PMR radiokomunikimi/radioalarmi.

Gjatë vitit 2019, janë konfirmuar 195 aplikime për caktime frekuencash për sisteme të reja, apo ndryshime të sistemeve ekzistuese.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019 u vu re shtimi i aplikimeve të operatoreve radio dhe radiotelevizive për pajisje me Autorizim Individual për frekuenca për lidhje fikse dhe sisteme satelitore VSAT.

### 5.2.8. Autorizimet Individuale për përdorim numeracioni

Gjatë viti 2019 janë përpunuar dhe proçesuar:

- 24 aplikime për alokime numra dhe seri numerike;
- 9 revokime të kërkuara nga subjektet/sipërmarrësit;
- 8 revokime për Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave;
- 4 revokime për Autorizim Individual për përdorimin e numeracioneve.

### 5.3. Administrimi i domain-it “.al”


AKEP administron domain-in “.al”<sup>8</sup>. Numri total i domain-eve .al dhe nën domain-eve është 22859, nga të cilat 4970 figurojnë të regjistruar gjatë vitit 2019.

Në terma statistikore vihet re se, kemi një rritje në numër të domain-eve të regjistruar, krahasuar me vitin 2018, me rreth 1.148 domain-e të regjistruar më tepër gjatë vitit 2019.

Edhe për vitin 2019 vazhdon përsëri trendi i regjistrimit të domain-eve nëpërmjet Regjistruesve të akredituar nga AKEP.

Numri i domain-eve sipas regjistrarëve është paraqitur në grafikët e mëposhtëm:


GRAFIKU NR. 22 NUMRI I REGJISTRIMEVE GJATË VITIT 2019



Burimi: AKEP


<sup>8</sup> Bazuar në Ligjin Nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën “.al””, e ndryshuar.

GRAFIKU NR. 23 NUMRI TOTAL I DOMAIN-EVE DERI NË FUND TË VITIT 2019



Burimi: AKEP

GRAFIKU NR. 24 TOTALI I DOMAIN-EVE TË REGJISTRUAR NDËR VITE




Burimi: AKEP

Gjatë vitit 2019, është ndjekur intensivisht përditësimi i të dhënave të poseduesve të domain-eve me .al, si domain-eve të regjistruara nëpërmjet AKEP ashtu edhe domain-eve të regjistruara nëpërmjet regjistruesve të autorizuar nga AKEP, proces i cili do të vijojë edhe përgjatë 2020.

#### 5.4. Autorizimet, licencat dhe certifikatat për shërbimet ajrore/detare etj.

Në zbatim të Ligjit 9918/2008 dhe rregulloreve të AKEP si edhe në aplikimet e paraqitura, janë lëshuar certifikata dhe licenca, si më poshtë:

GRAFIKU NR. 25 AUTORIZIMET, LICENCAT DHE CERTIFIKATAT SIPAS LLOJIT TË SHËRBIMIT



Burimi: AKEP

## 6. INSPEKTIMI DHE MONITORIMI

### 6.1. Inspektimi i sipërmarrësve të komunikimeve elektronike

Gjatë vitit 2019, strukturat inspektuese të AKEP kanë kryer inspektimin e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike të regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike, si më poshtë:

- realizuar 66 inspektime të programuara;
- verifikuar 178 sipërmarrës gjatë inspektimeve në distancë;
- realizuar 17 inspektime rastësore apo në bazë të ankesave;
- realizuar 8 inspektime të kryera nga riverifikimet;
- kontrolluar 123 subjekte në kuadër të luftës kundër informalitetit;
- verifikuar 70 subjekte mbi zbatimin e detyrimit të bllokimit të faqeve me përmbajtje të paligjshme;
- si dhe janë kryer inspektime/verifikime në zonat problematike të Bashkisë Tiranë lidhur me marrjen e masave organizative dhe operative për detyrimin e sipërmarrësve mbi zbatimin e rregullave teknike për rrjetet.

#### 6.1.2. Inspektim i programuar për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike

Në vitin 2019, AKEP ka kryer gjithsej 66 inspektime të programuara, ndër to:


- janë marrë 5 masa administrative “gjobë”;
- janë lënë rekomandime 21 subjekteve kryesisht për shkak të mosrespektimit të detyrimit të dorëzimit të raportit mbi deklarinimin e të dhënave statistikore, treguesit e cilësisë së shërbimit etj.

TABELA NR. 8 MBI ECURINË E INSPEKTIMEVE TË PROGRAMUAR GJATË VITEVE 2017-2019

Viti	Inspektimi i Programuar	Gjoha
2019	66	5
2018	75	16
2017	69	11

Burimi: AKEP

**GRAFIKU NR. 26 MBI ECURINË E INSPEKTIMEVE TË PROGRAMUAR GJATË VITEVE 2017-2019**



Burimi: AKEP

Në përfundim të procesit të inspektimit të planifikuar u konstatua se:

- 11 sipërmarrës ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike në përputhje me kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm;
- 48 sipërmarrës ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike kryesisht në përputhje me kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm. Këtyre sipërmarrësve ju është caktuar dënim administrative plotësues në formën e rekomandimeve;
- 5 sipërmarrës nuk kishin ushtruar aktivitetin sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe për këto shkelje u vendosën masa administrative “gjobë”;
- 2 sipërmarrës me kërkesë të tyre kishin filluar procedurën e çregjistrimit.

Gjatë vitit 2019 janë kryer edhe 4 inspektime jashtë planifikimit lidhur me verifikimin e zbatimit të vendimit të KD për “Rregullimin e tarifave dhe shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri – Ballkani Perëndimor”, të ofruar nga Sipërmarrësit Albtelkom sha, Telekom Albania sh.a, Vodafone Albania sh.a, dhe Info Telekom sh.p.k dhe verifikimi i shërbimeve të interkoneksionit kombëtar dhe ndërkombëtar.

### **6.1.3. Inspektimi në distancë**

Gjatë vitit 2019 u realizuan dy inspektime në distancë dhe më konkretisht inspektimi i parë në muajt maj - qershor dhe inspektimi dytë në muajt gusht – shtator.

Gjatë këtyre inspektimeve janë verifikuar në distancë 178 subjekte me objekt verifikimin e plotësimit të detyrimeve rregullatorë.

Konkretisht:

- Gjatë periudhës së parë janë verifikuar 96 subjekte për mosplotësim të detyrimeve rregullatorë dhe janë vendosur 18 masa administrative “gjobë”.

- Gjatë periudhës së dytë janë verifikuar 82 subjekte. Në përfundim të procedurave inspektuese, janë vendosur 4 masa administrative “gjobë”.

#### 6.1.4. Inspektimet rastësore apo nga ankesat


Gjatë vitit 2019 janë kryer 17 inspektime rastësore apo edhe bazuar në ankesa të ndryshme nëpërmjet të cilave pretendohet se subjekte të paidentifikuara ushtronin veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përfundim të procedurës inspektuese pas verifikimeve rast pas rasti, grupi i inspektimit ka vendosur 1 (një) masë administrative “gjobë” si dhe bllokim të pajisjeve, me të cilat ushtrohej veprimtaria.

#### 6.1.5. Inspektime në kuadër të riverifikimeve me monitorim

Gjatë vitit 2019 janë kryer 8 inspektime/monitorime për riverifikimin e frekuencave për radio lidhje fikse në pikat e ndryshme të transmetimit në territorin e vendit. Gjatë këtyre inspektimeve, pas verifikimeve të njëpasnjëshme dhe nga konstatimet e grupit të punës janë vendosur masa administrative (7 akte bllokimi dhe 1 dënim administrative kryesor “Paralajmërim”).

GRAFIKU NR. 27 NUMRI I INSPEKTIMEVE PËR RIVERIFIKIM



Burimi: AKEP



Foto nr.1

#### 6.1.6. Inspektim në kuadër të luftës ndaj informalitetit

Në kuadër të bashkëpunimit midis AKEP dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në funksion të formalizimit të aktiviteteve tregtare në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe promovimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, gjatë vitit 2019 janë verifikuar 123 subjekte.

Në përfundim të procedurës inspektuese u konstatua se pjesa më e madhe e subjekteve të verifikuara kishin përshkrimin e objektit të veprimtarisë në QKB “ushtrim veprimtarie në fushën e komunikimeve”, por nuk e ushtronin këtë veprimtari, ndërsa një pjesë e subjekteve rezultuan se figuronin të regjistruar në AKEP për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare e të pajisur me Autorizimin përkatës.

### 6.1.7. Inspektime lidhur me bllokimet në akses të faqeve me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme nga sipërmarrësit

AKEP në koordinim dhe me kërkesë të AMA, Agjencisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Shtetit në zbatim të detyrimeve ligjore ka inspektuar dhe mbikëqyrur nëse sipërmarrësit kanë kryer bllokimin në akses të faqeve me përmbajtje të paligjshme. AKEP i drejtohet sipërmarrësve me një shkresë së cilës i bashkëlidhet shkresa/ vendimi i organit kompetent, së bashku me listën e faqeve apo domain, e cila përcillet pa rishikim, modifikim apo ndërhyrje të njëanshme. AKEP rregullon dhe mbikëqyr aspektet teknike të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, por nuk ka tagër të vëzhgojë, shqyrtojë, apo ndërhyjë në përmbajtjen e këtyre shërbimeve.

### 6.1.8. Inspektim mbi marrjen e masave organizative dhe operative për detyrimin e sipërmarrësve lidhur me zbatimin e rregullave teknike për rrjetet

Gjatë vitit 2019 është punuar për zbatimin e detyrimeve të vendosura për sipërmarrësit të cilët ndërtojnë ose përdorin rrjete të komunikimeve elektronike dhe ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike. Gjithashtu u arrit të bëhet një përmirësim i ndjeshëm i këtyre rrjeteve në qytetet kryesore të vendit, ku u shmangën rrjetet e komunikimeve elektronike nga rrjetet e energjisë dhe në shumë rrugë kryesore dhe qendra tashmë kanë përfunduar ose është në proces përmbyllja e shmangieve. Kjo është një arritje e rëndësishme për garancinë e rrjeteve në uljen e rrezikshmërisë të këtyre instalimeve të rrezikshme për jetën e personelit të sipërmarrësve, përmirësimi i mirëmbajtjes si të rrjeteve të komunikimeve elektronike, por dhe të energjisë dhe ndriçimit. Masat e marra deri tani kanë sjellë në zonat e ndërhyra një gjendje krejtësisht tjetër si në sigurimin teknik dhe treguesit e cilësisë së shërbimit por edhe në aspektin estetik dhe urbanistik të këtyre zonave.

Fillimisht Plani i Zbatimit për 2018-2019 u përqendrua në disa rrugë kryesore të Bashkisë Tiranë të evidentuara si zona me problematikë të lartë për sa u përket rrjeteve kabllore.



Foto nr. 2

Puna e filluar gjatë gjithë 2019 është planifikuar të vazhdojë edhe gjatë vitit 2020 në 12 qarqet e vendit me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë së sipërmarrësve të rrjeteve ndaj problematikave mbi sistemimet e kabllave dhe largimin e tyre nga shtyllat elektrike dhe tentimin drejt instalimeve

teknologjive bashkëkohore me preferencë fibrën optike.

## 6.2. Inspektimi i ofruesve të shërbimeve postare

Gjatë vitit 2019 janë inspektuar ofruesit e shërbimeve postare të regjistruar në regjistrin e ofruesve të shërbimeve postare si më poshtë:

- Janë realizuar 15 inspektime të programuara, në përfundim të të cilave për:
  - 6 subjekte janë vendosur dënime plotësuese në formën e rekomandimeve;
  - 1 subjekt është dhënë masa administrative “gjobë”.
- janë verifikuar 7 subjekte në kuadër të luftës kundër informalitetit.

TABELA NR. 9 MBI ECURINË E INSPEKTIMEVE TË PROGRAMUAR GJATË VITEVE 2017-2019 PËR SHËRBIMET POSTARE

Viti	Inspektimi i Programuar	Gjoha	Rekomandime
2019	15	1	6
2018	10	0	1
2017	11	0	0

Burimi: AKEP

Veprimtaria e ofruesit të shërbimeve të postare “Posta Shqiptare” sh.a zë vendin dhe peshën kryesore në shërbimet postare. Nga inspektimet e realizuara ndaj ofruesit të shërbimeve postare “Posta Shqiptare” sh.a si dhe bazuar në dokumentacion e administruar vit pas viti janë konstatuar problematika, për të cilat janë lënë rekomandime dhe janë marrë masat si më poshtë:

- Gjatë vitit 2017, në përfundim të procedurës së inspektimit të subjektit “Posta Shqiptare” sh.a, grupi i inspektimit të AKEP ka vendosur dënime plotësuese në formën e rekomandimeve.
- Gjatë vitit 2018, grupi i inspektimit të AKEP për shkak të mosplotësimit të rekomandimeve të lëna ka vendosur dënimin administrativ kryesor “Paralajmërim” si dhe dënimin administrativ plotësues rekomandime për korrigjimin e problematikave të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm.
- Gjatë vitit 2019, në kushtet e konstatimit të shkeljeve dhe kërkesave ligjore, mos përmbushjes së rekomandimeve të lëna në inspektimet e mëparshme apo rekomandimeve të shprehura në Rezolutën e Kuvendit, si dhe në kushtet kur subjekti Posta Shqiptare sh.a rezultonte i dënuar me masë administrative të mëparshme “Paralajmërim”, me përfundim të procedurës inspektuese ndaj subjektit është vendosur masa administrative “gjobë” duke lënë sërish detyra dhe rekomandimet për t’u plotësuar brenda 90 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar.




Foto nr. 3

### 6.3. Monitorimi i spektrit të frekuencave

Monitorimi i spektrit të frekuencave kryhet nëpërmjet:

- stacioneve të monitorimit RFMS – Krujë dhe RFMS – Pinet për brezin e frekuencave 20 MHz deri në 3000 MHz;
- stacioneve të monitorimit SRFMS – Shkodër, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë dhe Fier për brezin e frekuencave 20 – 8500 MHz;
- stacioneve të lëvizshme.

Gjatë vitit 2019 monitorimi ka qenë i fokusuar në verifikimin e përputhshmërisë ligjore dhe administrative të detyrimit të sipërmarrësve që operojnë nën regjimin e Autorizimit Individual si dhe përdorimi i frekuencave të dhëna me autorizim në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të autorizimit, dhe për përdorimin e brezit të frekuencave të caktuar për përdorim radiolidhje fikse sipas Planit Kombëtar të Frekuencave dhe Planit të Përdorimit të Frekuencave të AKEP.



Foto nr. 4 Stacioni i lëvizshëm i monitorimit të spektrit





Foto nr. 5 dhe nr.6 Pajisjet e monitorimit të radiolidhjeve fikse antena parabolike dhe analizatori i spektrit

Grafiku i mëposhtëm paraqet nga ana sasiore volumin e punës së kryer gjatë vitit 2019 lidhur me numrin e stacioneve fikse të monitoruara në mënyrë krahasimore me dy vitet e paraardhëse.

GRAFIKU NR.28 NUMRI I STACIONEVE FIKSE TË MONITORUARA



Burimi: AKEP

### 6.3.1. Monitorimi i nivelit të rrezatimit të fushës elektromagnetike

AKEP kryen monitorimin e spektrit të frekuencave duke konstatuar nivelin e rrezatimit të fushës elektromagnetike (EMF). Kryerja e monitorimit i frekuencave për nivelin e rrezatimit të fushës elektromagnetike në territorin e Republikës së Shqipërisë realizohet me qëllim rritjen e rolit dhe kontributit të AKEP pranë Komisionit të Mbrojtjen nga Rrezatimet, gjithashtu informimin e publikut në lidhje me nivelet e rrezatimeve në ambientet e përditshme.

Matjet për monitorimin e nivelit të rrezatimit të fushës elektromagnetike janë realizuar me anë të metodës *broadband measurement* në brezin e frekuencave 8 kHz – 8 000 MHz.



Foto nr. 7 Matje rrezatimi në afërsi të stacionit bazë Foto nr. 8 Matje e rrezatimit në afërsi të institucioneve publike

Rezultatet e këtyre matjeve të regjistruara deri tani tregojnë se nivelet e rrezatimeve të emetuara nga antenat celulare nuk e tejkalojnë pragun e sigurisë të përcaktuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Rrezatimi Jojonizues (ICNIRP).

Të dhënat e matjeve të mbledhura nga terreni përpunohen në raportet teknike dhe bëhen publike në faqen elektronike të AKEP, më qëllim informimin e publikut si dhe vlerësimin e të dhënave nga Zyra për Mbrojtjen nga Rrezatimet e cila ushtron funksionet pranë KMR.

Gjatë vitit 2019 janë kryer në total 25 matje, 23 prej tyre të programuara dhe 2 me kërkesë të subjekteve.

### 6.3.2. Monitorimi i interferencave

Gjatë vitit 2019 rastet e interferencave të trajtuara nga AKEP, paraqiten si më poshtë:

TABELA NR. 10 NUMRI I RASTEVE TË TRAJTUARA PËR INTERFERENCA

Nr.	Operatori	Numri i ankesave	Ankesa të trajtuara	Interferenca të identifikuar
1	Albtelecom	4	4	3
2	Telekom Albania	3	3	2
3	Vodafone Albania	6	6	4
4	Drejtoria e Burgjeve	1	1	1
5	Operatorë të tjerë	1	1	1
	<b>TOTALI</b>	15	15	11

Burimi: AKEP




Foto nr. 9 Matje interference ne IEPV Jordan Misja



Foto nr. 10 Matje interference ne Aeroportin Rinas

Grafiku i mëposhtëm paraqet nga ana sasiore volumin e punës së kryer gjatë vitit 2019 në mënyrë krahasimore me dy vitet paraardhëse lidhur me trajtimin e problematikave të shkaktuar nga interferencat e dëmshme ndaj operatorëve që përdorin transmetime në radiofrekuencë.

GRAFIKU NR.29 GRAFIKU I RASTEVE TË INTERFERENCAVE 2017-2019



Burimi: AKEP


### 6.3.3. Monitorim i cilësisë së shërbimit QoS për telefoninë e lëvizshme

AKEP kryen monitorimin e cilësisë së shërbimit për shërbimet GSM,UMTS dhe LTE<sup>9</sup>. Zhvillimi i Broadband-it është planifikuar të zgjerohet me ofrimin e shërbimit nëpërmjet ndërtimit të stacioneve me investime të përbashkëta nga të tre operatorët mobile. Vlen të theksohet se për herë të parë ofrohen shërbimet mobile në zonat turistike Vermosh dhe Valbonë.

Nisur nga fakti se ndërtimi i këtyre stacioneve kryesisht janë në vende turistike, problem për mos realizimin e tyre janë vonesat në dhënien e lejes së ndërtimit nga institucionet përgjegjëse.

<sup>9</sup> Në zbatim të VKM nr. 300, datë 08.04.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.468, datë 30.5.2013, të Këshillit të Ministrave, për “Miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it”, si dhe Marrëveshjes Kuadër të Bashkëpunimit datë 5.11.2015 midis Vodafone Albania sh.a., Telekom Albania sh.a. dhe ALBtelecom sh.a.

### GRAFIKU NR. 30 OFRIMI DHE PËRMIRËSIMI I SHËRBIMIT



Burimi: AKEP

Gjithashtu i është kushtuar vëmendje informimit të publikut për treguesit e cilësisë duke marrë pjesë në intervista televizive dhe mediane të shkruara, duke dhënë detaje mbi monitorimet QoS realizuar nga AKEP, si dhe këshilla për pushuesit e bregdetit të jugut mbi përdorimin e celularit për të shmangur kalimin në roaming.



Foto nr. 11 Pamje gjatë fushatës vjetore të monitorimit të cilësisë (QoS) të shërbimit të telefonisë së lëvizshme në zonat bregdetare.

## 7. MBROJTJA E KONSUMATORIT

Gjatë vitit 2019, puna e AKEP në drejtim të mbrojtjes dhe nxitjes së përfitimeve të konsumatorit u fokusua në prioritetet e mëposhtme:

- Rregullimin e roamingut ndërkombëtar me Republikën e Kosovës dhe vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor;
- Hartimin e Rregullores së re të mbrojtjes së konsumatorëve;
- Trajtimin e ankesave të konsumatorëve.

### 7.1. Rregullimi i roamingut ndërkombëtar me Republikën e Kosovës dhe vendet e Ballkanit Perëndimor

Mbështetja e iniciativave të Qeverisë për reduktimin deri në heqjen e tarifave roaming me Republikën e Kosovës dhe vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor (BP) ka qenë një ndër prioritetet kryesore strategjike të AKEP gjatë dy viteve të fundit.

Përgjatë vitit 2018, AKEP u angazhua në procesin e ndryshimit të ligjit 9918/2008 dhe procesin e negocimit të marrëveshjes me Republikën e Kosovës dhe marrëveshjeve rajonale të roamingut me vendet e BP.

Ndërsa përgjatë vitit 2019, fokusi i AKEP ishte hartimi dhe miratimi i akteve rregullatore për implementimin e marrëveshjeve përkatëse të roamingut me Republikën e Kosovës dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe ndjekja e zbatimit të tyre nga operatorët.

#### 7.1.1. Rregullimi i roamingut me vendet e Ballkanit Perëndimor

Më datë 4 Prill 2019, në Samitin Digjital të Ballkanit Perëndimor të zhvilluar në Beograd, Ministrinë përgjegjëse për komunikimet elektronike të Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë nënshkruan “Marrëveshje për reduktimin e çmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor”.

Marrëveshja përcakton angazhimet e gjashtë vendeve të BP për reduktim deri në heqjen e tarifave roaming për qytetarët e rajonit, sipas modelit RLAH të aplikuar midis vendeve të BE.

Disa nga përcaktimet kryesore të marrëveshjes janë:

- duke filluar nga 1 korrik 2021 të eliminohen tarifat roaming që qytetarët e BP paguajnë kur vizitojnë vendet e rajonit, duke u tarifuar sikur të ishin në vendin e tyre sipas modelit Roam Like At Home (RLAH);
- në periudhën tranzitore 1 korrik 2019 – 30 qershor 2021 operatorët kanë të drejtë të aplikojnë mbi përdoruesin një tarifë ekstra (surcharge) mbi tarifën përkatëse të aplikuar brenda vendit, që njihet si modeli RLAH+;

- tarifatat me shumicë të roamingut dhe të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare të lidhura me to të rregullohen sipas niveleve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshje;
- deri më 01.07.2019 palët nënshkruese të miratojnë çdo ndryshim të ligjeve dhe/ose akteve nënligjore për komunikimet elektronike, të nevojshme për arritjen e objektivave të Marrëveshjes, duke përfshirë edhe harmonizimin e nivelit të politikës relevante të mbrojtjes së konsumatorit me standardet që mbizotërojnë brenda BE-së;
- deri më 31 dhjetor 2020 palët nënshkruese të miratojnë ndryshimet në ligjet dhe/ose aktet nënligjore të nevojshme për të siguruar që zbatimi i rregullave mbi politikën e përdorimit të drejtë (Fair Use Policy-FUP), rregullat për zbatimin e mekanizmit të derogimit të qëndrueshmërisë dhe kërkesat e transparencës, të cilat korrespondojnë me të njëjtat rregulla të zbatueshme në Bashkimin Evropian, dhe janë uniforme në të gjitha vendet e BP.

AKEP bazuar në përcaktimet e Ligjit 9918/2008, me Vendimin Nr.14, datë 7.05.2019, miratoi nxjerrjen në këshillim publik për një periudhë 30-ditore të dokumentit “*Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor-Këshillim Publik*”.

AKEP me Vendimet e Këshillit Drejtues me Nr. 21-24, datë 24.06.2019, miratoi dokumentin “*Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri – Ballkani Perëndimor*”, si dhe detyrimet për tre sipërmarrësit e rrjeteve celulare për zbatimin e marrëveshjes, të cilat përfshijnë:

- Rregullimin e tarifave me shumicë të roamingut që operatorët celularë të RSH aplikojnë për operatorët celularë të vendeve të BP, kur pajtimtarët e këtyre të fundit janë në roaming në Shqipëri;
- Rregullimin e tarifave me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare që operatorët celularë të RSH aplikojnë për operatorët celularë të vendeve të BP, për ato thirrje që janë të lidhura me roamingun ndërkombëtar midis vendeve të BP;
- Rregullimin e tarifave me pakicë që operatorët celularë të RSH aplikojnë për pajtimtarët e tyre, kur këta janë në roaming në vendet e BP.

### ***Rregullimi i tarifave me shumicë të roamingut dhe terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.***

Tarifatat mesatare maksimale me shumicë të Roamingut që operatorët e rrjeteve celulare në Republikën e Shqipërisë, në rolin e operatorit të rrjetit të vizituar, mund të aplikojnë ndaj operatorëve të rrjeteve celulare nga vendet e BP për ofrimin e shërbimit të rregulluar të thirrjeve të origjinuara në rrjetin e vizituar, nuk duhet të jenë më të larta se ato të specifikuara në tabelën në vijim.

TABELA NR. 11 TARIFAT MESATARE MAKSIMALE ME SHUMICË PËR SHËRBIMET E RREGULLUARA TË ROAMINGUT SHQIPËRI – BP

Modeli Tarifimit të Roamingut në Retail	Data e fillimit	Thirrjet e rregulluara roaming (€/min)	SMS të dërguar (€/SMS)	Transferim i të dhënave (€/MB)
		(1)	(2)	(3)
RLAH+	1 korrik 2019	0.050	0.02	0.0250
	1 korrik 2020	0.050	0.02	0.0150
RLAH	1 korrik 2021	0.032	0.01	0.0077
	1 janar 2022	0.032	0.01	0.0060
	1 janar 2023	0.032	0.01	0.0045
	1 janar 2024	0.032	0.01	0.0035
	1 janar 2025	0.032	0.01	0.0030
	1 janar 2026	0.032	0.01	0.0025

Shënim: Tarifat në euro, pa TVSH. Burimi: AKEP.

Tarifat maksimale me shumicë të terminimit që operatorët e rrjeteve celulare në Republikën e Shqipërisë mund të aplikojnë për operatorët celularë të vendeve të BP, për thirrjet e rregulluara roaming të origjinuara dhe terminuara në vendet e BP nuk duhet të jenë më të larta se vlerat e dhëna në Tabelën më poshtë:

TABELA NR. 12 TARIFAT MAKSIMALE ME SHUMICË PËR TERMINIMIN E THIRRJEVE TË RREGULLUARA TË ROAMINGUT SHQIPËRI – BP

	• 1 korrik 2019	• 1 korrik 2020	• 1 korrik 2021
• Tarifa Maksimale	• 0.040	• 0.025	• 0.016

Shënim: Tarifat në euro/minutë, pa TVSH. Burimi: AKEP.

### Rregullimi i tarifave më pakicë të roamingut

Duke filluar nga data 1 korrik 2021, tarifat me pakicë që operatorët e rrjeteve celulare të RSH aplikojnë për pajtimtarët e tyre për shërbimet e roamingut në vendet e BP duhet të jenë të njëjta me tarifat e aplikuar në RSH, sipas rregullit Roam Like At Home (RLAH).

Në periudhën 1 korrik 2019 deri më 30 qershor 2021, operatorët e rrjeteve celulare në RSH mund të aplikojnë për pajtimtarët e tyre që janë në roaming në vendet e BP një tarifë shtesë (surcharge) mbi tarifën përkatëse me pakicë brenda vendit (domestic price) për përdorimin e shërbimeve të rregulluara të Roamingut në vendet e BP. Tarifat shtesë të aplikuar për shërbimet e rregulluara të Roamingut nga operatorët celularë të RSH nuk duhet të tejkalojnë tarifat maksimale me shumicë të specifikuar në tabelat e mësipërme. Gjithashtu, tarifa totale me pakicë e aplikuar për shërbimet e rregulluara të roamingut në vendet e BP, e cila përfshin tarifën brenda vendit në RSH dhe tarifën shtesë për shërbimet e rregulluara të Roamingut, nuk duhet të tejkalojë vlerat si vijon (pa TVSH), 0.19€/min për thirrjet e rregulluara roaming të kryera, 0.06€ për SMS e rregulluara roaming të dërguara dhe 0.18 € për megabyte të përdorur, duke realizuar njëkohësisht të dy kushtet e cituara.

Tabela e mëposhtme paraqet tarifat ekstra (shtesat) maksimale mbi tarifat vendase dhe tavanet për tarifat totale roaming retail sipas RLAH+ të shprehura në Lek me TVSH<sup>10</sup>.

<sup>10</sup> Shënime:

1. Vlerat në Lek me TVSH, Kursi i këmbimit i përdorur 1 Euro=125 Lek

2. Tavanet e mësipërme janë të aplikueshme për tarifat roaming të pajtimtarëve të operatorëve celularë të RSH gjatë roamingut në cilindo rrjet celular të vizituar në BP

TABELA NR. 13 TAVANET PËR TARIFAT STANDARDE ME PAKICË TE ROAMINGUT ME BP RLAH+ 1.07.2019-30.06.2021

Periudha	Thirrjet dalëse (Lek/min)	Thirrjet Hyrëse (Lek/min)	SMS të dërguar (LEK/SMS)	Transmetimi i të dhënave (Lek/MB)
1.07.2019-30.06.2020	Domestic Retail + 7.50	6.00	Domestic Retail + 3.00	Domestic Retail + 3.75
1.07.2020-30.06.2021	Domestic Retail + 7.50	3.75	Domestic Retail + 3.00	Domestic Retail +2.25
Tavani (1.07.2019-30.06.2020)	28.50	6.00/3.75	9.00	27.00

Burimi: AKEP.

Pra, baza për tarifatat roaming në modelet RLAH dhe RLAH+ do jenë tarifatat dhe sistemi tarifor i aplikuar për konsumin e shërbimeve brenda vendit.

Në rastin pajtimtarëve që janë pa paketa aktive brenda vendit (pay as you go/out of bundle) gjatë fazës tranzitore RLAH+ operatorët kanë të drejtë të aplikojnë një tarifë shtesë (ekstra) mbi tarifën përkatëse për njësi brenda vendit, duke respektuar tavanet e vendosura.

### ***Transparenca dhe mekanizma mbrojtës për pajtimtarët në roaming***

Në vendimet për rregullimin e roamingut në BP, AKEP në aktet e tij rregullatore përfshiu gjithashtu detyrime për operatorët në lidhje me transparencën dhe mekanizma mbrojtës për pajtimtarët për të shmangur faturat tepër të larta apo ‘bill shock’.

Këto detyrime përfshijnë ndër të tjera:

- Dërgimin e një mesazhi SMS për pajtimtarin, kur ai hyn në një nga vendet e BP, që përmban informacion të personalizuar tarifor për çmimet e roamingut (përfshirë TVSH) që aplikohen për atë pajtimtar për thirrjet telefonike dalëse dhe hyrëse, dërgimin e mesazheve SMS dhe përdorimin e të dhënave/internetit kur ai ndodhet në vendet e BP.
- Vendosjen e një limiti financiar/sasior për shërbimin e të dhënave në roaming në vendet e BP për të shmangur ‘Bill Shock’ gjatë një periudhe faturimi. Operatori ka detyrim të njoftojë pajtimtarin kur arrihet niveli 80% i limitit financiar apo sasior si dhe të ndërpresë shërbimin data kur arrihet niveli 100% dhe pajtimtari nuk jep pëlqimin e tij të vijuar me ofrimin e shërbimit.

### ***Udhëzimet e AKEP dhe implementimi nga operatorët***

Me qëllim sqarimin e detyrimeve për zbatimin e vendimeve me nr. 21-24, datë 24.06.2019, për rregullimin e roamingut në BP, AKEP ka hartuar për operatorët celularë dokumentin “Udhëzime për zbatimin e detyrimeve të operatorëve celularë për Roamingun me Ballkanin Perëndimor”.

Bazuar në sa më sipër, si dhe në koordinim me MIE, AKEP në dokumentin e udhëzimeve të nxjerra për zbatimin e vendimeve nr. 21-24, datë 24.06.2019, përfshiu dhe një zgjidhje alternative të përkohshme për një fazë tranzitore jo më vonë se deri më 31.12.2019, për operatorët që ndeshen

me vështirësi teknike në lidhje me zbatimin e detyrimeve për RLAH+ për përdoruesit celularë me parapagim dhe me paspagim që kanë paketa (bundles) domestike aktive gjatë kohës që janë në roaming në vendet e BP.

### **7.1.2. Rregullimi i roamingut me Republikën e Kosovës**

Më datë 26.11.2018 në mbledhjen e përbashkët të Qeverive të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, ministritë përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike të dy vendeve nënshkruan “*Marrëveshje për heqjen e çmimeve të shërbimeve roaming për rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë*”.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes, AKEP ka nisur bashkëpunimin me ARKEP (Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Republikës së Kosovës) për hartimin e akteve përkatëse për zbatimin e marrëveshjes. AKEP më datë 15 mars 2019 miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Rregullimi i tarifave të roamingut ndërkombëtar Shqipëri-Kosovë-Këshillim Publik*”. Paralelisht dhe ARKEP filloi një proces këshillimi publik në Republikën e Kosovës.

Pas marrjes së komenteve të këshillimit publik, AKEP dhe ARKEP organizuan takime të përbashkëta midis dy autoriteteve rregullatore dhe më 11 maj 2019 miratuan vendimet përkatëse për rregullimin e roamingut Shqipëri-Kosovë.

AKEP miratoi dokumentacionin final dhe detyrimet e tre operatorëve celularë për rregullimin e roamingut Shqipëri-Kosovë.

AKEP dhe ARKEP bazuar në përcaktimet e dy marrëveshjeve si dhe në komentet e operatorëve gjatë këshillimeve publike, vendosën që nivelet maksimale të tarifave me shumicë dhe me pakicë të roamingut si dhe afatet e zbatimit të tyre, përfshirë aplikimin e modeleve RLAH+ dhe RLAH midis dy vendeve të jenë sipas përcaktimeve të marrëveshjes BP, përveç:

- afatit për fillimin e zbatimit të rregullimit të tarifave me shumicë dhe me pakicë të roamingut sipas modelit RLAH+ midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës;
  - Ky afat u ra dakord të jetë data 15 qershor 2019, ndërkohë me vendet e tjera të fillojë më datë 1 korrik 2019 sipas RRA BP.
- nivelit maksimal i tarifës me shumicë të roamingut për të dhëna;
  - AKEP dhe ARKEP ranë dakord që niveli maksimal i tarifave me shumicë të roamingut për të dhëna midis dy vendeve të jenë më të ulëta se çmimet në krahasim me vendet e tjera të BP.

Karakteristike në Shqipëri është aplikimi i paketave (bundle) jo vetëm për shërbimet brenda vendit por edhe në roaming. Të tre operatorët celularë ofrojnë paketa të favorshme roaming ku përkundrejt një tarife fikse periodike pajtimtarët përfitojnë një sasi të caktuar shërbimesh roaming, apo përkundrejt një tarife ekstra ditore pajtimtarët mund të përdorin në roaming njësitë e thirrjeve, SMS-ve dhe GB të përfshira në paketën brenda vendit. Këto lloj paketash roaming janë të disponueshme për pajtimtarët celularë në destinacionet kryesore të roamingut si vendet e BE, por edhe në vendet e BP.

Gjithashtu një faktor shtesë në përdorimin e ulët të tarifave RLAH+ është fakti se mbi 90% e pajtimtarëve celularë në Shqipëri janë përdorues të paketave me parapagim (ditore, javore apo mujore), dhe që këta përdorues të përfitojnë prej tarifave të rregulluara roaming RLAH+, duhet që


krahas paketës aktive brenda vendit të kenë dhe kredite shtesë në llogarinë e tyre me parapagim.

### Raporti i BEREC për roaming në BP


BEREC në vijim të bashkëpunimit me Autoritetet Rregullatore të BP për monitorimin e zbatimit të marrëveshjes rajonale të roamingut, ka përgatitur raport i cili përditësohet çdo gjashtë muaj. Dokumenti përmban informacion për të gjashtë vendet e BP në lidhje me tregues të ndryshëm të shërbimeve celulare si të ardhurat mesatare për përdorues, përdorimi mesatar i shërbimeve celulare brenda vendit dhe në roaming, të ardhurat mesatare me pakicë dhe me shumicë të operatorëve celularë nga shërbimet roaming.

Konsumi mesatar i shërbimeve roaming kur përdoruesit celularë të Shqipërisë vizitojnë vendet e BP rezulton në nivele të ngjashme me vendet e tjera të rajonit, përveç Malit të Zi që në dallim nga të gjitha vendet e tjera të BP ka nivele shumë të larta të konsumit në roaming rajonal.


GRAFIKU NR. 31 THIRRJE DALËSE ROAMING NË BP (MINUTA/MUAJ)




GRAFIKU NR. 32 THIRRJE HYRËSE ROAMING NË BP (MINUTA/MUAJ)



GRAFIKU NR. 33 SMS ROAMING NË BP (SMS/MUAJ)



GRAFIKU NR. 34 PËRDORIM TË DHËNASH ROAMING NË BP (GB/MUAJ)



Burimi: BEREC Report on Western Balkan Roaming

Për roamingun në vendet e EEA, Shqipëria ka të ardhurat (tarifat) mesatare për njësi më të ulëta se gjithë vendet e tjera të BP. Pra, Shqipëria rezulton me përdorimin më të madh të shërbimeve roaming si dhe me tarifat më të ulëta roaming me vendet e EEA.

### Hapat e mëtejshëm për rregullimin e roamingut

Pavarësisht afatit të ngushtë kohor për fillimin e implementimit të marrëveshjes së roaming me BP dhe marrëveshjes së roamingut Shqipëri-Kosovë, operatorët celularë të Shqipërisë filluan zbatimin e vendimeve të AKEP për rregullimin e roamingut me Republikën e Kosovës dhe vendet e tjera të

BP sipas afateve përkatëse më datë 15 qershor 2019 dhe 1 korrik 2019.

Tarifat e aplikuara nga operatorët janë në përputhje me nivelet maksimale të përcaktuara në vendimet dhe në disa raste dhe poshtë tavaneve përkatëse.

Për sa i përket hapave të mëtejshëm që duhen ndjekur për zbatimin e plotë të RLAH nga data 1 korrik 2021, AKEP ka parashikuar miratimin brenda datës 31.12.2020 të akteve të nevojshme që transpozojnë rregullat/udhëzimet e mëposhtme të BE/BEREC, duke i përshtatur në kontekstin e RRA-së.

## 7.2. Rregullorja e Mbrojtjes së Konsumatorit

AKEP me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 20, datë 22.05.2019, ka miratuar dokumentin për këshillim publik *“Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”*.

Në hartimin e dokumentit AKEP ka marrë në konsideratë:

- nevojën për ndryshime në rregulloret ekzistuese të AKEP për mbrojtjen e konsumatorit dhe konsolidimin e tyre në një akt të vetëm,
- adresimin e problematikave të evidentuara në marrëdhëniet midis konsumatorëve/përdoruesve/pajtimtarëve dhe operatorëve,
- ndryshimet në kuadrin rregullator të BE-së duke përfshirë elementë të Direktivës (BE) 2018/1972 dhe Rregullore 2015/2120 të BE në lidhje me aksesin e hapur në internet dhe neutralitetin e rrjetit (net-neutrality).

Dokumenti i përgatitur *“Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”* synon një mbrojtje më të mirë të konsumatorit dhe përdoruesve të tjerë fundorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike nëpërmjet vendosjes së rregullave më të qarta për të drejtat e përdoruesve në marrëdhëniet me operatorët që përfshijnë:

- detyrime të qarta për përmbajtjen e kontratave të pajtimtarëve, përfshirë detyrimin për ofrimin e përmbledhjes së kontratës;
- saktësi për kohëzgjatjen, rinovimin dhe përfundimin e kontratave;
- rregulla për të garantuar cilësinë e shërbimit të aksesit në Internet;
- rregulla të qarta për aksesin në shërbimet e emergjencës dhe përcjelljen e informacionit të vendndodhjes së pajtimtarit për këto thirrje përfshirë thirrjet drejt numrit unik të emergjencave 112;
- detyrime specifike për shërbimet me parapagim, përfshirë afatin e vlefshmërisë së rimbushjeve;
- rregulla për sistemin e faturimit dhe saktësinë e tij;
- rregulla më të qarta për trajtimin e ankesave nga operatorët dhe mbajtjen e rekordeve të tyre;
- saktësimin e të dhënave të pajtimtarëve dhe krijimin e bazës së të dhënave për Numeratorin Telefonik;
- rregulla për krijimin e bazës së të dhënave për regjistrin Do Not Call Me, për thirrjet e

pakërkua nga kompanitë tregtare.

AKEP pas përfundimit të këshillimit publik dhe shqyrtimit të komenteve të palëve të interesuara, ka zhvilluar takime me Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit, Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit (KMDPI), si dhe me operatorët celularë. AKEP gjatë vitit 2020 do të miratojë versionin final të rregullores.

### 7.3. Trajtimi i ankesave të përdoruesve

#### 7.3.1. Ankesat e përdoruesve për shërbimet e komunikimeve elektronike

Një aspekt i rëndësishëm i mbrojtjes së konsumatorëve të komunikimeve elektronike dhe postare është trajtimi i ankesave të përdoruesve individualë si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve pajtimtarë-operatorë. Ankesat kryesisht janë depozituar në rrugë elektronike nga konsumatorët dhe në disa raste janë depozituar edhe nga agjenci të mbrojtjes së konsumatorit si Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit apo dhe Shoqata për mbrojtjen e konsumatorit.


Gjatë viti 2019 numri total i ankesave të depozituara në AKEP ishte 44, prej të cilave 4 ishin raste të depozituara për zgjidhje mosmarrëveshje pajtimtarë-operator.

Objekti i ankesave për vitin 2019 ishte kryesisht për:

- çështje të lidhura me faturimin (32%),
- cilësinë e shërbimit (29%) dhe
- portimin e numrit (16%).

Sipas llojit të shërbimit, 50% e ankesave ishin për shërbime nga rrjete fikse dhe 50% për shërbimet nga rrjetet celulare.

GRAFIKU NR. 35 ANKESAT E KONSUMATORËVE SIPAS OPERATORËVE DHE OBJEKTIT (2019)



Burimi: AKEP.

Ankesat në lidhje me faturimin ishin kryesisht për problematikën e shkurtimit të afatit të përdorimit të

rimbushjeve të përdoruesve me parapagim dhe konfiskimin e tyre pas këtij afati në rast mospërdorimi, si dhe për konsumin e shpejtë të sasisë së të dhënave të përfshira në paketat e shërbimeve celulare. Lidhur me këtë çështje AKEP përfshiu në Rregulloren për Mbrojtjen e Konsumatorit të nxjerrë në këshillim publik, përcaktime për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së rimbushjeve të përdoruesve celulare si dhe të drejtën e kompensimit të vlerës monetare të papërdorur të rimbushjeve.

Ankesat për cilësinë e shërbimit ishin kryesisht për shërbimin e aksesit në internet nga rrjete fikse, dhe në disa raste të kufizuara dhe për mbulimin me sinjal nga rrjete celulare. Ankesat për shpejtësinë e aksesit në internet nga rrjete fikse kanë gjetur zgjidhje nga operatorët të cilët kanë kryer kompensime të konsumatorit apo përmirësim të cilësisë së shërbimit.

Ankesat në lidhje me portimin e numrit kanë vijuar trendin rënës dhe gjatë vitit 2019 u raportuan 7 ankesa, kryesisht nga përdorues me kontratë për refuzim portimi për detyrime të prapambetura. Pas komunikimeve të AKEP me operatorët në të gjitha rastet është realizuar portimi i numrit sipas kërkesës së pajtimtarit.

Objekti i ankesave të tjera përfshin ankesa në lidhje me rrezatimin e antenave celulare, thirrje të dyshimta dhe pengesat ndaj qytetarëve nga administratorë pallatesh të godinave të banimit për zgjedhjen e ofruesit të shërbimit të aksesit në Internet nga rrjete fikse. Në lidhje me këto pengesa, në AKEP janë depozituar ankesa dhe nga operatorë të rrjeteve fikse.

### **7.3.2. Ankesat nga përdoruesit të shërbimit postar**

Pranë ofruesit të shërbimit universal Posta Shqiptare sh.a janë depozituar 1131 ankesa, apo 14% më shumë se në vitin 2018. Të gjitha ankesat janë trajtuar dhe u janë dhënë zgjidhje nga Posta Shqiptare sh.a. Kjo përbën një përmirësim të ndjeshëm me tre vitet e mëparshme, kur ky raport ishte rreth 70%.

Shuma e dëmit të kompensuar në vitin 2019 nga Posta Shqiptare ishte rreth 1.2 milion Lekë, që përbën një rritje me 42% në krahasime me vitin 2018.



# 8. RAPORTI PËR STATUSIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL

## 8.1. Statusi i Shërbimit Universal për komunikimet elektronike

### *Kodi i ri i Komunikimeve Elektronike të BE-së dhe përvoja në vendet e BEREC*

Parlamenti dhe Këshilli Evropian më datë 18 dhjetor 2018 miratuan Direktivën (EU) 2018/1972 për Kodin e Evropian të Komunikimeve Elektronike (EECC). Kodi hyri në fuqi më datë 20 dhjetor 2018 dhe vendet anëtare duhet të transpozojnë atë në legjislacion kombëtare deri në 21 dhjetor 2020.

Kuadri i ri rregullator i BE (më poshtë EECC) ka sjellë ndër të tjera dhe ndryshime të rëndësishme në lidhje me shërbimin universal. Në lidhje me objektin e shërbimit universal EECC përcakton se:

- Të gjithë konsumatorët duhet të kenë akses me çmime të përballueshme, sipas kushteve specifike të vendit anëtar, në shërbim të aksesit broadband me shpejtësi adekuate dhe në shërbime të komunikimit zanor, sipas cilësisë së specifikuar në vendin përkatës, përfshirë lidhjen në rrjet nga vendndodhje fikse.
- Gjithashtu, vendet anëtare mund të konsiderojnë përballueshmërinë e shërbimeve të cituara më sipër, që nuk ofrohen nga vendndodhje fikse në rastet kur e konsiderojnë këtë të nevojshme për të siguruar përfshirjen e plotë sociale dhe pjesëmarrjen ekonomike të konsumatorëve në shoqëri.

Në lidhje me sigurimin e disponibilitetit të SHU për zona ku nuk ka shërbim/mbulim, Kodi përcakton që vendet anëtare kanë të drejtë të përcaktojnë një ose disa operatorë si ofrues të SHU, kur ajo nuk mund të sigurohet nëpërmjet praktikës normale tregtare ose nëpërmjet instrumentave të tjerë të politikave publike si fonde të ndihmës shtetërore ose fonde të BE.

Në lidhje me shpejtësinë adekuate të aksesit broadband në Internet, EECC përcakton se ajo mund të caktohet nga çdo vend anëtar sipas kushteve kombëtare dhe shpejtësisë minimale që përdoret nga shumica e konsumatorëve, duke marrë në konsideratë dhe raportet e BEREC për praktikën më të mira. BEREC deri në 21 qershor 2020 do të publikojë një raport për praktikën më të mirë për të ndihmuar në përcaktimin e shpejtësisë adekuate të aksesit broadband në internet për SHU.


Në përputhje me përcaktimet e Kodit, BEREC më 6 dhjetor 2019 ka publikuar për këshillim publik dokumentin “*BEREC Report on Member States’ best practices to support the defining of adequate internet access service*”. Dokumenti përmban informacion në lidhje me praktikën e ndjekura nga vendet e BE-së për përfshirjen e aksesit broadband në SHU.

## Aksesi në rrjetet publike dhe përballueshmëria e tarifave

Sipas raporteve periodike vjetore të ITU “Measuring the Information Society”, Shqipëria renditet në pozicione të pëlqyeshme për sa i përket përballueshmërisë së tarifave të shërbimit të aksesit broadband fiks dhe shërbimeve celulare, sidomos për aksesin broadband nga rrjete celulare.


Ndërkohë, operatorët celularë në Shqipëri kanë mundur të mbulim shumë të mirë gjeografik dhe të popullsisë me rrjet celular për shërbimin bazë telefonik (2G) si dhe në vitet e fundit edhe për akses broadband në internet me rrjete 3G dhe 4G. Gjatë dy viteve të fundit operatorët celularë kanë vijuar rritjen e mbulimit të popullsisë dhe territorit, përfshirë ndërtimin e stacioneve të reja dhe/ose përmirësimin e sinjalit të rrjetit në zonat e përcaktuara nga AKEP. Gjithashtu, një hap i rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të mbulimit dhe cilësisë së shërbimeve celulare gjatë vitit 2019 ishte alokimi nga AKEP për dy operatorë celularë i frekuencave në brezin 800 MHz.

**GRAFIKU NR. 36** TË ARDHURAT DHE PËRDORIMI MESATAR MUJOR I SHËRBIMEVE CELULARE BRENDIA VENDIT



ARRPU (Euro/muaj pa TVSH)

Thirrje dalëse (Minuta/muaj)



SMS/muaj

Përdorim Interneti/data (GB/muaj)

Burimi: AKEP, sipas të dhënave të raporteve të BEREC për roaming ndërkombëtar (BoR (20)31 dhe BoR (20) 31a).

Të ardhurat mesatare mujore me pakicë të operatorëve celularë për pajtimtar (ARRPU) apo shpenzimet mesatare mujore të pajtimtarëve për shërbime celulare në Shqipëri në vitin 2019 ishin 5.4 euro.

Ky nivel është pothuajse i njëjtë me Maqedoninë e Veriut dhe më i ulët se Mali i Zi me rreth 7 euro/muaj që ka nivelin më të lartë në rajon.

Ndërkohë Republika e Kosovës, Serbia dhe B&H kanë nivele shumë të ulëta të ARRPU me 1.2-2.7 euro/muaj.

Shpenzimi mesatar mujor në Shqipëri është pothuajse 2 herë më i ulët se mesatarja në vendet e BE/EEA.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se përdoruesit celularë në Shqipëri paguajnë mesatarisht 5.4 euro në muaj (pa TVSH), për të kryer 215 minuta thirrje, dërguar 30 SMS dhe përdorur 2.55 GB të dhëna.

Ky nivel i shpenzimeve mesatare mujore për përdorues celular në 2019, përbën 1.5 përqind të të ardhurave kombëtare për frymë (GNI p.c), dhe tarifrat për shërbimet celulare mund të konsiderohen të përballeshme.

## 8.2. Statusi i Shërbimit Universal Postar

Bazuar në përcaktimet ligjore, AKEP ka pajisur ofruesin e shërbimit postar, Posta Shqiptare sh.a. me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjet nga hyrja në fuqi e vendimit. Sipas përcaktimeve afati i përfundimit të autorizimit individual të Posta Shqiptare sh.a për shërbimin universal postar përfundon më 7 korrik 2020.

Me vendimin Nr. 6 datë 16.04.2020, KD i AKEP vendosi për “*Miratimin për këshillim publik të dokumentit: Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal*”. Procedura e këshillimit publik është përcaktuar të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data 17.4.2020-18.5.2020.

Mbështetur në përfundimet e procedurës së këshillimit publik, ne rast se nga analiza dalin më shumë se dy ofrues, AKEP do të kryejë procedurat e tenderit për përzgjedhjen e ofruesit të SHU sipas përcaktimeve ligjore, në të kundërt do të vijohet me rinovimin edhe për 5 vjet të Autorizimit Individual të Posta Shqiptare si ofrues i SHU postar.

### 8.2.1. Tregues të volumit të shërbimit universal postar

Numri total i objekteve postare të shërbimit universal u rrit me 24% gjatë vitit 2019, duke arritur në rreth 24 milion objekte. Objektet e SHU postar në vitin 2019 përbëjnë 92% të totalit të objekteve postare të Posta Shqiptare dhe 83% të totalit të gjithë objekteve postare në Shqipëri.

Tabela e mëposhtme paraqet një informacion më të detajuar të objekteve postare të SHU të Posta Shqiptare gjatë periudhës 2016 -2019.

TABELA NR. 14 TREGUES TË NUMRIT TË OBJEKTEVE TË SHU POSTAR

	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/18
Total Shërbim universal postar	19,638,487	19,922,420	19,711,717	24,470,278	24%
Postë brenda vendit	18,416,556	18,599,662	18,298,143	19,617,824	7%
Objekte të thjeshta	15,497,230	15,614,286	15,139,767	16,693,931	10%
Objekte të regjistruara	2,919,326	2,985,376	3,158,376	2,923,893	-7%
Postë ndërkombëtare	1,221,931	1,322,758	1,413,574	4,852,454	243%
Objekte Ndërkombëtare Dalëse	301,159	362,415	334,696	687,957	106%
Objekte Ndërkombëtare Hyrëse	920,772	960,343	1,078,878	4,164,497	286%


Nga viti 2018 në 2019 kemi një rritje me 24% të objekteve postare të SHU, e cila ka ardhur për shkak të:

- rritjes me 7% të objekteve postare brenda vendit,
- rritjes me 243% të objekteve postare ndërkombëtare.

Numri i objekteve postare ndërkombëtare dalëse u dyfishua në vitin 2019, ndërsa numri i objekteve dalëse ndërkombëtare u rrit me katër herë duke arritur në 4 milion objekte.

Në të gjitha këto ndryshime të mëdha ndikoi rritja e jashtëzakonshme e zërit Thasë M deri në 2 kg, nga nën 100 objekte në 2018 në rreth 2.5 milion në 2019.

GRAFIKU NR. 37 TREGUES TË SHU NDËR VITE



Posta Shqiptare sh.a, me qëllim sigurimin e shërbimit universal postar ka të organizuar rrjetin postar në zyra të hapura për publikun në të cilat ofrohet shërbim universal postar dhe shërbime jo universale/ekspres, si dhe në zyra që kryejnë funksionin dhe si qendra përpunimi.

Gjatë vitit 2019, Posta Shqiptare ka vënë në dispozicion të publikut për ofrimin e shërbimit universal:

- 531 zyra që përbën një reduktim me 32 zyra në krahasim me vitin 2018;
- 700 sportele nga të cilët 551 sportele janë të automatizuar/kompjuterizuar.

Për pranimin e objekteve postare ka venë në dispozicion të përdoruesve 579 kuti postare, me një rritje me 42 kuti në krahasim me 2018.

Për dorëzimin e objekteve postare ka vendosur në dispozicion 609 kuti postare, nga të cilat të paktën një kuti postare është e vendosur në çdo zyrë postare.

Në funksion të organizimit dhe shpërndarjes së rrjetit postar, Posta Shqiptare që prej vitit 2017 ka ofruar informacion në faqen e internetit për vendndodhjen dhe të dhënat për çdo zyrë postare që janë paraqitur online në aplikacionin “Map – Google Earth”. Kjo mundëson përdoruesit e shërbimit universal postar në Shqipëri që nëpërmjet internetit dhe sipas vendndodhjes së tyre gjeografike të marrin informacion për zyrën postare më të afërt.

Në lidhje me zbatimin e kërkesave të përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të Energjisë dhe Infrastrukturës Nr.6174, datë 16.12.2019, rezulton se Posta Shqiptare ka realizuar treguesit e mbulimit me shërbim universal si më poshtë:

- Shërbimi universal postar ofrohet në 531 zyra postare të hapura për publikun.
- Një zyrë postare ofron shërbim universal postar për një numër mesatar të popullsisë prej rreth 5,100 banorë.
- Mesatarisht në një sipërfaqe prej 52.7 km<sup>2</sup> është prezente një zyrë postare që ofron shërbim universal postar.
- Në zonat urbane, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit është mesatarisht 5 km.
- Në zonat rurale, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit është mesatarisht 8 km për 95% të popullsisë.

### **8.2.2. Cilësia/standardet e shërbimit universal postar**

Në zbatim të kërkesave të Ligjit 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, të Autorizimit Individual për ofrimin e shërbimit universal me të cilin është pajisur “Posta Shqiptare”, për treguesit e cilësisë për vitin 2019 rezulton se:

- përmasat minimale dhe maksimale për objektet postare (letra dhe pako postare) janë në përputhje me aktet e miratuara nga UPU-ja, si për postën ndërkombëtare dhe për postën brenda vendit;
- është plotësuar detyrimi për publikim të informacionit për cilësinë e shërbimit universal postar;
- janë kryer testet për kohën e shpërndarjes së objekteve postare, sistemin e informimit për ndjekjen e objekteve postare, rregullsinë dhe besueshmërinë e shërbimeve kombëtare dhe ato ndërkufitare/ndërkombëtare.
- Sipas të dhënave rezulton se Posta Shqiptare ka realizuar plotësisht treguesit për kohën e shpërndarjes së objekteve postare brenda vendit në të tre destinacionet dhe për të gjitha kohëzgjatjet.



## 9. STATUSI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

### 9.1. Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të RSH

Në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i RSH me Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2018”, e datës 30.5.2019, AKEP është udhëhequr nga angazhimi maksimal për përmbushjen e tyre.

1. Gjithsej nga 16 rekomandime të dhëna për vitin 2019 në Rezolutën e Kuvendit<sup>11</sup>:

- a) janë realizuar plotësisht 12 prej tyre;
- b) janë realizuar pjesërisht 2 rekomandime;
- c) nuk janë realizuar 2 rekomandime.

Janë realizuar dhe përmbushur me sukses rekomandime të tilla, si:

- Ka kryer analizën për daljen nga tregu të sipërmarrësit Plus Communication sh.a.
- Ka vijuar punën në bashkëpunim me MIE për ndjekjen e procedurave të tenderimit, lidhur me dhënien në përdorim edhe të dy brezave të tjerë të lirë të frekuencave 800 MHz. AKEP ka kryer procedurën e tenderimit për 3 (tre) të drejta përdorimi (Autorizime Individuale) të brezit 800 MHz. Gjatë vitit 2019 janë dhënë 2 (dy) të drejta përdorimi, sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a në datën 04.03.2019 dhe Telekom Albania sh.a në datën 27.09.2019. Mbetet ende e lirë për t'u dhënë 1 (një) e drejtë përdorimi gjatë vitit 2020.
- AKEP ka marrë pjesë dhe ka ofruar ekspertizën e tij në takimet e zhvilluara gjatë vitit 2019 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AMA, për mënyrat e lirimt të brezit 700 MHz.
- Ka punuar për nxitjen e implementimit të teknologjive të reja, nëpërmjet politikave rregullatore, të cilat sjellin rritjen e konkurrencës përmes rritjes së cilësisë së shërbimeve. Vendosi në përdorim e frekuencave të brezit 800 MHz, gjatë vitit 2019 nga dy sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a dhe Telekom Albania sh.a është shoqëruar edhe me investime në teknologji të reja nga këta operatorë. Frekuencat e brezit 800 MHz ofrojnë kapacitete më të larta në rrjetet celulare dhe kjo ka bërë të mundur edhe përmirësimin e shërbimeve të këtyre operatorëve, në veçanti rritjen e shpejtësive të shërbimit internet kundrejt pajtimtarëve.
- Ka bashkëpunuar me aktorët brenda vendit dhe ata ndërkombëtarë për implementimin me sukses të marrëveshjeve për lehtësimin e tarifave roaming me Republikën e Kosovës dhe vendet e Ballkanit. Këshillit Drejtues ka miratuar dokumentat përkatëse për rregullimin e tarifave të roaming ndërkombëtar Shqipëri – Kosovë, si dhe ato të ofruara nga sipërmarrësit, ashtu edhe rregullimin e tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri – Ballkani perëndimor. Gjithashtu, AKEP ka përgatitur edhe udhëzime për zbatimin e detyrimeve të

<sup>11</sup> Aneksi 1 bashkëlidhur përmban detaje lidhur me zbatimin e Rezolutës.

operatorëve celularë për roamingun me Ballkanin Perëndimor.

- Gjatë vitit 2019, AKEP ka dhënë ndihmën e tij në kryerjen e matjeve të nivelit të rrezatimeve të telefonisë celulare, në kuadrin e monitorimit të brezit të frekuencave që përdoren me Autorizim Individual, detyrim ligjor ky i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR). Gjithashtu ka kryer edhe verifikime për zbatimin e standardeve të miratuara nga Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Rrezatimet Jojonizuese (ICNIRP), duke kryer matje të nivelit të rrezatimeve jojonizuese, të emetuara nga antenat celulare. Janë realizuar 25 matje në rajone të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, ku 2 prej tyre janë realizuar me kërkesë nga palët e interesuara, të cilët kanë ngritur shqetësimin për prezencën e antenave celulare në afërsi të ambienteve të punës ose banimit.
- Ka kërkuar nga Posta Shqiptare dorëzimin e pakove (dërgesave) në adresën e individit, si një kërkesë ligjore, zbatimi i së cilës duhet të përmbushet brenda një kohe sa më të shkurtër, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit. AKEP bazuar në detyrimet ligjore, ka realizuar inspektimin tek subjekti Posta Shqiptare sh.a, nga data 21.11.2018 deri në 21.01.2019, për të cilin ka lënë rekomandimin për:

Marrjen e masave organizative dhe teknike për shpërndarjen e të gjithë objekteve postare (pako/kolipostë) në adresën e marrësit, në përputhje me nenin 40 të Ligjit 46/2015, brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019.

- AKEP ka realizuar inspektimin tek subjekti Posta Shqiptare sh.a, ku ndër të tjera ka konstatuar moszbatueshmëri të përcaktimeve ligjore të nenit 30 dhe 34 të ligjit nr. 46/2016, dhe ka lënë rekomandimin për:

Marrjen e masave për heqjen e menjëhershme të tarifës shtesë, pasi është në kundërshtim me frymën ligjit dhe parimet e Rregullores së Shërbimit Postar Universal të UPU, ku për objektet që dorëzohen nga Posta Shqiptare sh.a, detyrimet terminale të përfituara nga Posta Shqiptare reflektojnë kostot për përpunimin dhe shpërndarjen e objekteve.

- AKEP edhe gjatë vitit 2019, ka vijuar punën për zbatimin nga sipërmarrësit dhe operatorët të ligjit Nr. 9918/2008 dhe kushteve teknike që përcaktojnë aktet nënligjore lidhur me infrastrukturën e rrjeteve kablllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndër urbane.
- AKEP nëpërmjet Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 20, datë 22.05.2019, ka miratuar dokumentin për këshillim publik “Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike” e cila ndër të tjera parashikon një konsolidim nga 3 në 1 të rregulloreve aktuale.
- AKEP, pas përfundimit të këshillimit publik më datë 13.09.2019 të dokumentit “Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike” dhe takimeve të zhvilluara me Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit, Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit (KMDPI), operatorët celularë, si dhe marrjes së komenteve nga të gjitha palët e interesuara është në proces të miratimit të versionit final të kësaj rregulloreje, e cila përveç se është një konsolidim i 3 rregulloreve aktuale në 1 të vetme, sjell mjaft përfitime për konsumatorin.
- AKEP në kuadër të bashkëpunimit institucional ka dhënë kontributin e tij në përpunimin e akteve nënligjore, si dhe në dhënien e vlerësimeve, ndihmesës dhe ekspertizës së tij, sa herë i është kërkuar nga MIE në përgatitjen dhe implementimin e akteve nënligjore të ligjit nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.

- Në përputhje me rregullat e BE-së për sigurinë kibernetike, janë marrë masa për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike. Për identifikimin e kërcënimeve të mundshme kibernetike, në bashkëpunim me Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike (AKCESK) është bërë i mundur njoftimi i operatorëve në kohën e duhur për të marrë masa të menjëhershme. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, në përputhje me Rregulloren Nr.37, datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” kanë detyrimin e dërgimit të një raporti pranë AKEP, i cili përfshin informacion mbi masat e duhura teknike dhe organizative në fushat e sigurisë. Gjatë vitit 2019, nga 203 sipërmarrës të komunikimeve elektronike, vetëm 158 sipërmarrës kanë depozituar në AKEP raportin mbi masat teknike dhe organizative të sigurisë. Monitorimi i kësaj çështjeje do të jetë përparësi për vitin 2020.

## 9.2. Rekomandime të dhëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit

### 9.2.1. Gjatë muajit nëntor pranë AKEP u krye auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me tematikë “Mbi performancën e përdorimit të internetit në Administratën Publike”. Në Raportin Përfundimtar të auditimit të KLSH-së u dhanë disa rekomandime në bazë të gjetjeve të konstatuara.

Për zbatimin e këtyre rekomandimeve, AKEP hartoi një program të detajuar që përfshinte personat përgjegjës, afatin e realizimit dhe veprimet konkrete që duheshin ndërmarrë për zbatimin e tyre. Të gjitha rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë përmbushur me sukses dhe brenda afateve.

Më poshtë jepen gjetjet nga auditimi, rekomandimet për secilën gjetje si dhe masat e marra për realizimin e tyre.

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se portat kryesore të aksesit të router-it nuk janë të ndryshuara për hyrje në menaxhimin e firewall, telnet, ssh, web por janë të konfiguruar në portat standarde, çka përbën risk nëse ka sulme me toolse user/password gjenerator.

**Rekomandim:** AKEP të marrë masa për ndryshimin e portave të aksesit nga standarde në porta të parametrizuara, për parandalimin e sulmeve ose hyrjeve të pa autorizuara në router-in kryesor të institucionit.

- U ndryshuan portat by-default në hyrje të firewalls dhe routers, në porta të parametrizuara për AKEP, për parandalimin e sulmeve në hyrje.

*Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nuk realizohet monitorimi i kufizimeve në përdorimin e internetit. Antivirusi *Bit Defender Gravity Zone* që përdoret në të shumtën e rasteve për kontrollin e trafikut të internetit është parametrizuar në vlera *by default* të cilat nuk kontrollojnë navigimin në rrjet; interneti ofrohet nga AKSHI, por ky shërbim nuk monitorohet.

**Rekomandim:** Strukturat drejtuese në AKEP të marrin masat për parametrizimin e vlerave për kontrollin e trafikut dhe monitorimin e kufizimeve në internet. Gjithashtu të merren masa për monitorimin e shërbimit të internetit.

- U parametrizua Antivirusi Bit Defender Gravity Zone për monitorimin e aksesit në internet, duke shtuar rregulla të tjera për parandalimin/përdorimin/aksesin/etj, të user-ave të cilët përdorin shërbimin internet në AKEP. Këto rregulla lejojnë që të përdoren kufizime në user-s të veçantë për përdorimin e internetit.
- Për sa i përket monitorimit të shërbimit të aksesit në internet nga AKSHI, është hartuar draft marrëveshja ku janë përcaktuar termat e shërbimit dhe mënyra e njoftimit/komunikimit kur ka ndërprerje të shërbimit të aksesit në internet. Draft marrëveshja është dërguar tek AKSHI për konfirmim dhe pritet nënshkrimi i saj nga titullarët e institucioneve.

*Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se AKEP nuk ka marrë masa për bllokimin e përdoruesit admin dhe krijimin e një user-i tjetër me të drejta administrative me emërtim ndryshe. Kjo gjë do të parandalonte sulme nga scrip/viruse që mund të merren brenda serverave ose pc-ve. Shumica e viruseve që bëjnë ddos, përdorin si username “admin”.

**Rekomandim:** AKEP të marrë masa për bllokimin e user-it admin dhe krijimin e një user-i me emërtim ndryshe me të drejta administratori për të gjitha router-at/switch-et e menaxhueshëm. Të krijohen grupe dhe user admin-i/monitorimi.

- U bllokua user-i admin dhe u krijua një user tjetër i parametrizuar për AKEP.

*Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në AKEP konfigurimi aktual, në firewall nuk ka një script i cili të bëjë të mundur bllokimin e një IP-je në një listë të zezë nëse kjo IP tenton të logohet drejt portave të aksesit.

**Rekomandim:** AKEP të marrë masat për analizimin e nevojave mbi konfigurimin e një script në firewall i cili bllokon për 24 orë IP-në nëse nga kjo IP provohet me shumë se 3 herë logimi i gabuar.

- Duke pasur parasysh mundësitë dhe kapacitetet (licensing & features) e Firewall-it aktual, i cili nuk e mundëson një shërbim të tillë që automatikisht një IP të futet në BlackList, u hartua një listë për të cilën u krijua një rregull në firewall për bllokimin manual të IP-ve të cilat mund të përbëjnë kërcënim potencial për rrjetin dhe shërbimet elektronike të AKEP.

*Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se AKEP nuk ka identifikuar elemente të teknologjisë së informacionit në regjistrin e riskut, në kundërshtim me ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar si dhe Udhëzimin me nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

**Rekomandim:** Strukturat drejtuese në AKEP të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe dokumentimin në regjistrin e risqeve të elementëve të identifikuar si risqe të teknologjisë së informacionit me qëllim vlerësimin, kontrollin e risqeve që mund të venë në rrezik arritjen e objektivave të institucionit.

- U krye rishikimi dhe përditësimi i regjistrit të riskut për vitin 2020, duke përcaktuar elementët e identifikuar si risqe të teknologjisë së informacionit që mund të venë në rrezik arritjen e objektivave të AKEP, si dhe kontrollet dhe veprimet përkatëse për adresimin e boshllëqeve për secilin prej tyre.

*Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.*

## **9.2.2. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer gjatë vitit 2019 auditimin e performancës “Mbikëqyrja e Tregut të Telefonisë Celulare” dhe raporti përfundimtar është depozituar pranë AKEP në datën 21.02.2020**

Referuar përcaktimeve ligjore të shprehura në nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AKEP ka hartuar raportin mbi realizimin e çdo rekomandimi të dhënë nga auditimi i kryer nga KLSH, duke pasur në vëmendje zbatueshmërinë e tyre në një sektor të veçantë si ai i komunikimeve elektronike, si dhe ndarjen e qartë të kompetencave të organeve kompetente dhe autoriteteve rregullatore në këtë sektor.

Në këtë kontekst, jepen si më poshtë masat për realizimin e pjesës më të madhe të rekomandimeve të KLSH, niveli i zbatueshmërisë së një pjese të tyre, si dhe shpjegimet lidhur me realizimin e rekomandimeve të cilat vlerësohen të përmbushura.

Grupi i Auditimit të KLSH, zhvilloi punën audituese bazuar në ngritjen e pyetjes kryesore:

*“A ka qenë efektive veprimtaria e AKEP në mbikëqyrjen e tregut të telefonisë celulare gjatë periudhës 2017-2018” dhe nënpyetjeve të renditura si më poshtë:*

1. A i ka përmbushur AKEP të gjitha objektivat strategjike me qëllim ruajtjen e konkurrencës?
2. A ka bashkëpunuar AKEP me institucionet e tjera përgjegjëse me qëllim rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut të telefonisë së lëvizshme?
3. A ka marrë AKEP masat e nevojshme ndaj subjekteve që kanë cënuar interesat e konsumatorëve?
4. A janë shërbimet e ofruara nga kompanitë celulare në përputhje me pritshmëritë e konsumatorëve?

Në përgjigje të këtyre pyetjeve, pas shqyrtimit të dokumentacionit, fokusimit të problemit, përcaktimit të objektivave në fazën studimore, analizimit dhe testimit të evidencave gjatë fazës analitike, me vendimin nr.188, datë 31.12.2019, të Kryetarit të KLSH janë miratuar gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse në përfundim të procedurës së auditimit. Ky vendim është përcjell në AKEP në datën 21.02.2020.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është angazhuar për zbatimin tërësor të këtyre rekomandimeve, duke qenë të bindur se rëndësia e pranimit dhe zbatimit të tyre qëndron në faktin se ato fuqizojnë mekanizmin e brendshëm administrativ, orientojnë institucionin drejt përmirësimit të rezultateve të cilat kanë një rëndësi të madhe në përmbushjen e objektivave institucionale.

Në vijim të ndjekjes së procedurave për realizimin e rekomandimeve të KLSH, pas përfundimit të procesit të auditimit të performancës, AKEP ka hartuar raportin mbi realizimin e çdo rekomandimi të dhënë nga auditimi i kryer nga KLSH, duke pasur në vëmendje zbatueshmërinë e tyre në një sektor të veçantë si ai i komunikimeve elektronike, si dhe ndarjen e qartë të kompetencave të organeve kompetente dhe autoriteteve rregullatore në këtë sektor.

Lidhur me rekomandimet e dhëna në kuadër të nënpyetjes së parë: “A i ka përmbushur AKEP të gjitha objektivat strategjike me qëllim ruajtjen e konkurrencës”, AKEP gjykon të përcjellë si më poshtë masën e realizimit të tyre, hapat konkrete për zbatimin në vijim, si dhe nivelin e zbatueshmërisë në referim me çka kërkohet specifikisht lidhur me analizën e tregut me pakicë të telefonisë celulare.

- AKEP duhet të kryejë me kujdes, në shkallë të lartë përgjegjshmërie dhe në intervale të rregullta, jo më pak se një herë në dy vjet, analizën e tregjeve përkatëse, sipas përcaktimeve ligjore.

Bazuar në përcaktimet e ligjit 9918/2008 dhe Rregullores nr.9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e

*Tregut*”, AKEP do të kryej analizat e tregjeve në rregullim dhe proceset e këshillimit publik për to sipas të gjithë përcaktimeve ligjore e rregullatore.

***Sa më sipër, rekomandimi vlerësohet në proces realizimi*** dhe AKEP do të njoftojë KLSH brenda afatit ligjor 6 mujor nga marrja dijani për raportin.

- AKEP duhet të realizojë analizën e tregut të pakicës në tregun e telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore në këtë treg.

*Në vijimësi*

Këshilli Drejtues i AKEP nëpërmjet Vendimit Nr. 11, datë 17.04.2019 Për “Miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Analizë e tregut me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare”, ka vendosur të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit për një periudhë 60 ditore.

Në përfundim të periudhës së këshillimit publik dhe marrjes së mendimeve nga palët e interesuara AKEP shqyrtoi komentet e operatorëve dhe Autoritetit të Konkurrencës, gjithashtu zhvilloi edhe konsultime me organizma ndërkombëtarë.

AKEP analizoi me vëmendje të posaçme vendimet e Autoritetit të Konkurrencës në dritën e objektivave të ligjit 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si edhe të rekomandimeve dhe praktikave më të mira të Trupit të Rregullatorëve të Bashkimit Evropian (BEREC). E përbashkëta e këtyre instrumenteve normativë rezultoi nënrenditja e procesit të analizës së një tregu subjekt rregullimi, domosdoshmërisë për të identifikuar në të, të tre kriteret kumulative.

Referuar orientimeve dhe konkluzioneve të rekomandimit përfundimtar të Autoritetit të Konkurrencës, plotësimi i tre kriterëve për tregun e shumicës së akses-origjinimit nuk konsiderohet i karakterizuar nga pikëpamja e kuadrit normativ për mbrojtjen e konkurrencës. Për rrjedhojë, AKEP konstaton se ky kuadër është mjaftueshëm i pajisur për të ofruar të gjithë instrumentat dhe garancitë e duhura për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dhe në vijim problematikat e konkurrencës në tregun përkatës.

AKEP gjykon se rregullimi *ex-ante* i tregut me shumicë të akses-origjinimit, ndërhyrja paraprake për përcaktimin e sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e detyrimeve rregullatore përkatëse, në referim të nenit 3, pika 5, të rregullores nr. 9/2009, nuk paraqiten si masa në përpjesëtim të drejtë me objektivin e mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efiçente në kuadrin e ligjit 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, për sa kohë ky objektiv është i realizueshëm nëpërmjet instrumenteve të legjislacionit specifik nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Konkurrencës.

Lidhur me dokumentin “*Analiza e tregut me Shumicë të Aksesit dhe Origjinimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare*”, Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 9, datë 24.04.2020 ka vendosur :

1. Të vlerësojë si të paplotësuar testin e tre kriterëve të sanksionuar në pikën 4 të nenit 3 të Rregullores, në përfundim të analizës së tregut kryer sipas përcaktimeve dhe hapave procedurale të parashikuara nga ligji 9918/2008 dhe Rregullorja 9/2009;
2. Të mos përcaktojë sipërmarrës me fuqi të ndjeshme duke mos vendosur detyrime rregullatore në tregun me shumicë të akses-origjinimit në rrjetet celulare, si pasojë e mosplotësimit të testit të tre kriterëve, konform pikës 4 të nenit 5 të Rregullores.

### **Rekomandimi vlerësohet i realizuar.**

- Mbështetur në analizat e tregut, AKEP duhet të vendosë masa të mjaftueshme për ndërmarrjet me FNT, me qëllim që të sigurojë konkurrencë efektive në tregun e telefonisë celulare.

*Në vijimësi*

Bazuar në praktikat më të mira të vendeve anëtarë të BE dhe BEREC dhe në funksion të objektivit të ligjit 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, për përcaktimin e tregjeve që justifikojnë rregullimin, analizës dhe përcaktimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, Këshilli Drejtues i AKEP pas këshillimit publik të dokumentit vendos nëse është e nevojshme ose jo marrja e masave rregullatore në funksion të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

**Sa më sipër, Rekomandimi vlerësohet në proces realizimi** dhe AKEP do të njoftojë KLSH brenda afatit ligjor 6 mujor nga marrja e raportit.

- Këshilli Drejtues i AKEP duhet që të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që kur ai e çmon të arsyeshme, komentet objektive të subjekteve të legjitimuara, të përfituara gjatë fazës së këshillimit publik, të reflektohen në Dokumentin përfundimtar të analizës së tregut, përpara miratimit të këtij akti.

*Në vijimësi*

AKEP harton dhe nxjerr për këshillim publik dokumentet sipas përcaktimeve të rregullores për analizën e tregut dhe rekomandimeve të Komisionit Evropian, dhe në përfundim të këtij procesi analizon me kujdes gjetjet e dokumenteve të nxjerra për këshillim publik, komentet e palëve të interesuara pjesëmarrëse në këtë proces dhe në vijim vendos për shpalljen ose jo të sipërmarrësve me FNT dhe vendosjen e masave rregullatore proporcionale përkatëse.

### **Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.**

- *Në rastet kur Këshilli Drejtues i AKEP çmon shfuqizimin e një akti të mëparshëm, duhet që këtë vendim ta mbështesë në argumente ligjorë dhe objektive, duke parashtruar që faktet e marra në konsideratë nuk pasqyrojnë gjendjen aktuale.*

*Në vijimësi*

Këshilli Drejtues i AKEP, ka vendosur nëpërmjet Vendimit nr. 89 datë 15.11.2018 për “Shfuqizimin e Vendimit nr.78, datë 01.10.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentit: “Analizë e Tregut Celular: Tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – dokument përfundimtar”, dhe shfuqizimin e vendimeve të Këshillit Drejtues përkatësisht nr.79, nr.80, nr.81 dhe nr.82, datë 01.10.2018 në përputhshmëri dhe në zbatim të parimeve të Drejtësisë, Paanësisë, Objektivitetit, Proporcionalitetit dhe të Përgjegjësisë, të shprehura qartësisht në Kodin e Procedurave Administrative (ligji 44/2015).

### **Për sa më lart ky rekomandim rezulton i realizuar nga Këshilli Drejtues.**

- *Pavarësisht faktit se AKEP bën rregullimin ex-ante të tregut të telefonisë celulare, kur ai konstaton një sjellje strategjike anti-konkurrese të operatorëve me FNT duhet t'ia parashtrtojë Autoritetit të Konkurrencës, me qëllim fillimin e procedurave përkatëse ligjore.*

*Menjëherë*

AKEP vlerëson rekomandimin e KLSH, duke sjellë në vëmendje se bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës mbetet prioritar në funksion të adresimit të çështjeve me interes të përbashkët që lidhen me zbatimin e legjislationit në fuqi që rregullon fushën e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike. Në këtë kontekst, gjykojmë të rëndësishme të informojmë se në frymën e bashkëpunimit institucional të sipërcituar, AKEP ka përcjellë pranë AK shkresën nr. 270, datë 14 shkurt 2020 “Mbi ndryshimin e tarifave të paketave standarde me parapagesë në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, me qëllim nisjen e procedurave përkatëse ligjore nga AK për hetimin e rastit në fjalë.

- AKEP duhet të kryejë një analizë të situatës së marrëdhënieve midis operatorëve për aksesin dhe interkoneksionin për thirrjet hyrëse kombëtare dhe ndërkombëtare dhe impaktin e tyre në konkurrencë në tregjet përkatëse me pakicë, si dhe adresim të tyre në proceset e analizave të tregut për vitin 2018 ose në procese të veçanta.

*Në vijimësi*

Kjo analizë është realizuar në dokumentin e analizës së tregut me shumicë të termi nimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë dhe thirrjet hyrëse ndërkombëtare nga ku ka rezultuar se të tre operatorët celularë realizojnë vetëm pagesat neto për diferencat mes të ardhurave dhe shpenzimeve për tregun përkatës me shumicë të terminimit kombëtar.

#### **Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.**

*A ka bashkëpunuar AKEP me institucionet e tjera përgjegjëse me qëllim rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut të telefonisë së lëvizshme? AKEP gjykon të përcjellë si më poshtë masën e realizimit të tyre, si dhe hapat konkrete për zbatimin në vijim.*

- MIE dhe AKEP të marrin të gjitha masat e nevojshme për implementimin me efektivitet të përcaktimeve të parashikuara në Planin Kombëtar të Frekuencave:

*Në vijimësi*

Ne lidhje me këtë rekomandim, AKEP siguron se do të vijojë të bashkëpunojë ngushtësisht me MIE:

- i. Duke marrë pjesë dhe dhënë kontribut dhe ekspertizë teknike gjatë hartimit të Strategjisë 5G në Shqipëri;
- ii. Duke dhënë kontributin teknik përkatës në kuadër të rishikimit të Planit Kombëtar të Frekuencave, në të cilin do të pasqyrohen ndryshimet e fundit të WRC-2019 të ITU, për brezat 5G.

- AKEP duhet të kryejë një analizë paraprake lidhur me pasojat dhe efektet që do të sjellë implementimi i teknologjisë 5G në vendin tonë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Lidhur me këtë rekomandim, sqarojmë që Kryetari i AKEP me Urdhrin nr. 23 datë 22.01.2020 “Për hartimin e një studimi për zhvillimet potenciale të rrjeteve të gjeneratës 5G në Shqipëri”, ka ngritur një Grup Pune për përgatitjen e një materialin studimor dhe një plan veprimi të AKEP në lidhje me 5G në Shqipëri. Grupi i Punës e ka përfunduar dokumentin dhe ky material duhet të mbahet parasysh gjatë koordinimeve dhe bashkëpunimit me MIE, AMA, etj., për frekuencat 5G në Shqipëri.

- AKEP dhe MIE duhet të kryejnë të gjitha procedurat e nevojshme për implementimin dhe ofrimin e shërbimit universal, në zbatim të përcaktimeve ligjore.

Në lidhje me gjetjet e auditimit për shërbimin universal, sqarojmë se në kuptimin tradicional në direktivat dhe rekomandimet e BE-së dhe të Ligjit nr.9918/2008, shërbimi universal lidhet me mundësimin e aksesit dhe shërbimeve në rrjetet publike të komunikimeve elektronike nga vendndodhje fikse, pra nga rrjete fikse. Në këto kushte gjetjet e auditimit janë jashtë objektit të auditimit të performancës “Mbikëqyrja e tregut të telefonisë celulare”. Gjithsesi, AKEP po punon për përgatitjen e dokumentit për “Rishikimin e statusit të SHU të komunikimeve elektronike 2020”, duke marrë në konsideratë zhvillimet e fundit në tregun e komunikimeve elektronike si dhe përvojën në vendet e BE për SHU për aksesin Broadband.

- MIE dhe AKEP duhet të forcojnë bashkëpunimin ndër institucional ndërmjet tyre, nëpërmjet intensifikimit të takimeve.

Lidhur me këtë rekomandim, vlerësojmë se legjislacioni në fuqi që rregullon sektorin e komunikimeve elektronike në RSH, ka përcaktuar mjaft qartë kompetencat e secilit institucion apo organ publik të ngarkuar me zbatimin e ligjit nr.9918/2008. Në këtë kontekst, AKEP ka bashkëpunuar ngushtësisht me MIE por dhe me institucionet e tjera të përfshirë në implementimin e ligjit, me qëllim vendosjen e një qasje më proaktive në përmbushjen e objektivave rregullatore. Shembuj të tillë bashkëpunimi, gjenden të reflektuar në iniciativat dhe përpjekjet e përbashkëta në kuadër të procesit të roamingut rajonal, si dhe me roamingun me Republikën e Kosovës në vitin 2019. Mbetet për t’u përmendur që çdo reflektim apo ndryshim ligjor konsultohet me çdo aktor të sektorit, si dhe për proceset të cilat ligji ka parashikuar ndërveprim midis MIE dhe AKEP, të tilla janë konkluduar me sukses, mjaftojmë të kujtojmë proceset e alokimit të brezave të frekuencave 800 Mhz gjatë vitit 2019.

#### ***Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i realizuar.***

- Me qëllim bashkëpunimin me efektivitet, AKEP dhe AK duhet të marrin masat e nevojshme për ngritjen e grupeve të përbashkëta për kryerjen e analizave të tregut dhe procedurave të inspektimit.

*Në vijimësi*

Bashkëpunimi mes AKEP dhe AK është i rregulluar në mënyrë shteruese nëpërmjet akteve ligjore, ndërkohë që krijimi i Grupeve të Punës pavarësisht vullnetit mund të ndeshet në disa kufizime pasi inspektimet e Autoritetit të Konkurrencës pranë sipërmarrësve janë të befasishme në ambientet e sipërmarrjeve, përfshirë ambientet private dhe nuk parashikojnë pjesëmarrjen e personave të tjerë përveç inspektorëve të Autoritetit të Konkurrencës.

- AKEP dhe AK të përmbushin me rigorozitet çdo përcaktim, të cilin e kanë parashikuar dhe kanë rënë dakord në MoU.

Për këtë rekomandim, gjejmë me vend të shprehim se AKEP do të vijojë zbatimin e pikave të dakordësuara në këtë MoU.

- AKEP dhe AK, mbështetur në MoU, duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e një analize për sa i përket implementimit të këtij akti, duke përcaktuar prioritetet e bashkëpunimit. Ky shqyrtim do të kryhet në baza dy vjetore, në zbatim të nenit 7 të këtij Memorandumi sikurse kanë parashikuar vetë palët.

*Në vijimësi*

Periodikisht dhe në vijim të parashikimeve të Ligjit nr.9918/2008, si dhe të memorandumit të bashkëpunimit midis dy institucioneve, AKEP i ka kërkuar AK të shprehë opinion/rekomandime në lidhje me dokumente të nxjerra në këshillim publik dhe në këtë kuadër do jetë i përfshirë me komente/opinione/rekomandime përkatëse edhe mbi konstatimet dhe gjetjet që do vijojnë në këtë dokument gjatë periudhës së këshillimit publik.

AKEP angazhohet që brenda një periudhe afat shkurtër, në bashkëpunim me AK, të kryejë një analizë tërësore lidhur me nivelin e implementimit të këtij memorandum, si dhe të identifikimit të nevojave për përditësimin apo amendimin e tij.

### **Sa më sipër rekomandimi vlerësohet i realizuar.**

Lidhur me rekomandimet e dhëna në kuadër të nënpyetjes së tretë: “A ka marrë AKEP masat e nevojshme ndaj subjekteve që kanë cënuar interesat e konsumatorëve”, AKEP gjykon të përcjellë si më poshtë masën e realizimit të tyre, si dhe hapat konkrete për zbatimin në vijim.

- DMKI pranë AKEP, të hartojë plane strategjike dhe vjetore inspektimi efektive, duke marrë në konsideratë risqet dhe problematikën reale të sipërmarrësve si dhe të kryejë inspektime në bazë të risqeve që mbart çdo sipërmarrës.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

Në mbështetje të Rregullores Nr. 46, datë 27.10.2016 “Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, AKEP ka hartuar planet strategjike për shërbimet elektronike dhe shërbimet postare për vitet 2017-2020, si dhe për vitet 2020 - 2023. Plani Strategjik, përcakton drejtimitet dhe objektivat kryesore të inspektimit në terma afatgjatë disa vjeçare (zakonisht deri në 3 vjet).

Gjithashtu, në zbatim të këtij plani, AKEP ka hartuar në vazhdimësi planet periodike, planet vjetore si dhe ato mujore. Plani vjetor përcakton më në detaje veprimtarinë e inspektimit që do të ndërmerret gjatë vitit ushtrimor nga AKEP në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në zbatim të planit vjetor AKEP miraton në vijimësi edhe planet mujor të inspektimit, të cilat mundësojnë mbulimin e problematikës së shfaqur në veprimtarinë e sipërmarrësve si dhe tematikës dhe objektivave të planifikuar vjetor.

### **Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.**

- DMKI pranë AKEP të rrisë numrin e monitorimeve në distancë dhe në terren pranë sipërmarrësve të kompanive celulare, duke u fokusuar në ato çështje që prekin drejtpërdrejtë interesat e konsumatorëve. Pas kryerjes së inspektimeve, të ndiqet me rigorozitet zbatimi i rekomandimeve të lëna.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

Në zbatim të planit strategjik të miratuar nga Këshilli Drejtues i AKEP, si dhe në referim të dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë inspektuese në Republikën e Shqipërisë, DMKI pranë AKEP ka planifikuar një rritje të ndjeshme të aktivitetit inspektues për vitet në vazhdim.

Gjatë vitit 2017, janë kryer 85 inspektime në terren dhe 164 inspektime në distancë. Në vitin 2018 AKEP ka kryer gjithsej 75 inspektime në terren dhe 232 inspektime në distancë lidhur me plotësimin e detyrimeve rregullatore.

Pra, referuar inspektimeve të realizuara ndër vite (232 në vitin 2017, 307 në vitin 2018, rreth 390 të realizuara në 2019 dhe 170 subjekte të programuara për vitin 2020 për inspektimet në distancë) tregon trendin në rritje të numrit dhe angazhimit të strukturave inspektuese të AKEP. Gjithsesi, sjellim në vëmendje se burimet njerëzore dhe kapacitet e drejtorisë janë të kufizuara dhe për më tepër prioritetet dhe strategjia e inspektimit përcaktohen në planet strategjike të miratuara nga KD dhe planet vjetor të miratuara nga titullari AKEP (plane këto të përgatitura në bashkëpunim me strukturat dhe drejtoritë e tjera sipas prioriteteve dhe strategjisë së AKEP). Gjithashtu sqarojmë se, zbatueshmëria e të gjitha rekomandimeve të lëna nga Grupet e Inspektimit janë ndjekur me rigorozitet.

Gjithashtu, AKEP ka rekomanduar fuqizimin dhe pavarësinë dhe operimin e organizmave të cilat mbrojnë të drejtat e konsumatorit të tilla si Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit, për të ushtruar kompetencat në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, përfshirë edhe çështjet e mësipërme.

#### ***Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.***

- DMKI pranë AKEP të kryejë inspektime pranë sipërmarrësve të telefonisë celulare, për të vlerësuar se sa zbatohen detyrimet e përcaktuar në Kreun XI, XIV dhe XV të Ligjit për Komunikimet Elektronike në lidhje me: kontratat e pajtimtarëve, regjistrimin e pajtimtarëve, mbrojtjen e të dhënave personale, cilësinë e shërbimeve, faturimin, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis pajtimtarëve dhe operatorëve, dhe mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

Ky rekomandim është përfshirë apo implementuar në planin strategjik të inspektimeve të AKEP, si dhe në planet vjetore e ato mujore.

Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike kanë detyrimin të publikojnë informacion transparent, të krahasueshëm, të përshtatshëm dhe të përditësuar për tarifatat dhe çmimet e aplikuar, çdo detyrim në përfundimin e kontratës, si dhe kushtet e përgjithshme për aksesin e përdorimin e shërbimeve të ofruara nga ata për përdoruesit fundorë. Ky informacion publikohet në mënyrë të qartë, gjithëpërfshirëse dhe lehtësisht të aksesueshme.

AKEP-i ka përcaktuar, me Rregullore Nr. 47, datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”, kërkesat shtesë lidhur me formën në të cilën këto informacione do të publikohen.

Në bazë të kësaj rregullore strukturat inspektuese të AKEP-it, gjatë procedurës inspektuese, verifikojnë nëse subjektet objekt inspektimi kanë përmbushur detyrimet mbi publikimin e informacionit të mëposhtëm:

- a) *ofrimi i pajtimtarëve të informacionit për tarifatat e aplikueshme;*
- b) *informimi i pajtimtarëve për çdo ndryshim të aksesit në shërbime të emergjencës ose të informacionit për vendndodhjen e numrit thirrës në shërbimin ku janë pajtuar;*
- c) *publikimit në faqen e internetit të sipërmarrësit të kushteve të përgjithshme të kontratave tip;*
- ç) *publikimi i treguesve të cilësisë, publikimi i treguesit të matjes të shpejtësisë etj.;*
- d) *të informojnë pajtimtarët për çdo ndryshim të kushteve që kufizojnë aksesin në, dhe/ose përdorimin e shërbimeve.*

Për sa më lart, gjatë vitit 2020 janë planifikuar tre inspektime në distancë ku janë të përfshirë edhe operatorët celularë tek të cilët vlen të përmendet se janë monitoruar në vazhdueshmëri si në terren edhe në distancë zbatimi i detyrimeve lidhur me transparencën dhe publikimin e informacionit, siç

parashikohet në nenin 98 të ligjit 9918/2008.

Sikurse e theksuam edhe në pikën e mësipërme del e nevojshme mirëfunksionimi i autoriteteve të cilat mbrojnë të drejtat e konsumatorit.

### ***Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i realizuar.***

- DMKI pranë AKEP të përgatisë raportet periodike dhe raportin vjetor të inspektimit sikurse përcaktohet në pikën 4.3 të Rregullores nr.46, datë 46/2016 “Metodikë e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të komunikimeve elektronike”, në të cilat të pasqyrojë punën e bërë dhe pritshmëritë, si dhe rezultatet e arritura nga zbatimi i masave dhe detyrave për korrigjimin e shkeljeve. Këto raporte të miratohen nga KD dhe të publikohen.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

DMKI ka përmbushur me rigorozitet përcaktimet e dhëna në Rregulloren nr.46/2016, dhe do vazhdojë të përmbush çdo detyrim ligjor dhe ato të parashikuara nga aktet rregullatore. DMKI ka hartuar dhe paraqitur në vijimësi raportet e inspektimit për çdo procedurë të zhvilluar. Raportet periodike janë përgatitur sipas përcaktimeve të akteve normative dhe kanë qenë javore, mujore, gjashtë mujore dhe vjetore. Raportet mujore kanë pasqyruar punën e bërë dhe pritshmërinë, ndërsa raportet gjashtë mujore dhe raporti vjetor kanë pasqyruar në mënyrë analitike edhe rezultatet e arritura nga zbatimi i masave dhe detyrave për korrigjimin e shkeljeve.

### ***Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.***

- AKEP të marrë të gjitha masat për të bërë ndryshimet e nevojshme ligjore ku të përcaktohet se çdo vendim inspektimi, pavarësisht llojit të masës së përcaktuar nga inspektorët, të miratohet nga Këshilli Drejtues. Në këtë mënyrë, të gjitha vendimet e inspektimeve bëhen publike duke rritur transparencën dhe llogaridhënien e institucionit.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

Lidhur me këtë rekomandim, sqarojmë se struktura e inspektimit në ushtrimin e detyrave bazohet në ligjin për komunikimet elektronike dhe ligjin për inspektimin në RSH dhe funksionon si një njësi e pavarur nga organet drejtuese të AKEP.

- AKEP të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse në mënyrë që t’iu ofrojë përdoruesve me aftësi të kufizuar përfitime maksimale nga aksesit i shërbimeve të komunikimeve elektronike, në kuptim të zgjedhjes së çmimit dhe cilësisë, sipas përcaktimeve të Ligjit për komunikimet elektronike.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

AKEP ka informuar për këtë rekomandim KLSH-në se, *Qeveria Shqiptare është angazhuar për kompensim financiar prej 1000 lek në muaj për shërbime të telefonisë fikse për përdorues me aftësi të kufizuara. Ky kompensim është përfshirë në VKM nr.404, datë 20.6.2012 “Për përcaktimin e masës së kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse” si dhe në Udhëzimin Nr. 9, datë 25.2.2015 të Ministrisë së Mirëqenies Sociale. Gjithashtu, në draft rregulloren e mbrojtjes së konsumatorit, janë parashikuar disa detyrime për operatorët për marrëdhëniet me personat me aftësi të kufizuar.*

Ndërkohë, AKEP ka planifikuar kryerjen e një procesi këshillimi publik lidhur me dokumentin i cili përcakton masa të veçanta për ofrimin shërbimeve të specializuara për personat me aftësi të kufizuara. Ky proces këshillimi do të përfshijë sidomos bashkëpunimin me institucionet përkatëse shtetërore dhe shoqatat për personat me aftësi të kufizuara.

***Për këtë rekomandim, vlerësojmë se është pjesërisht i realizuar, dhe gjatë vitit 2020 do kryhet proces i veçantë këshillimi publik për shërbimet specifike për të plotësuar maksimalisht nevojat e kësaj kategorie përdoruesish.***

- AKEP të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur përdoruesit me të ardhura shumë të ulëta nëpërmjet ofrimit të çmimeve të përballueshme, duke vënë në zbatim objektivin e vitit 2018.

*Mars 2020*

Raporti i KLSH i konsideron tarifrat celulare shumë të larta dhe të papërballueshme, bazuar në rezultatet e sondazhit të kryer nga GP i KLSH, pa sqaruar metodikën e ndjekur. Ndërkohë që në raportet/analizat e AKEP duke iu referuar dhe raporteve të institucioneve ndërkombëtare, si ITU, tarifrat e shërbimeve celulare në Shqipëri konsiderohen të ulëta dhe të përballueshme bazuar në metodika të qarta të krahasimit të tarifave, sikurse citohet në raportin e tyre periodik:

- *Një vend tjetër që dallohet në krahasimin rajonal është Shqipëria, e cila shënoi uljen më të madhe të çmimeve për aksesin broadband fiks në vitin 2017. Tregu shqiptar i telekomunikacionit ka parë në vitet e fundit një rritje të ofertave bundle, veçanërisht në tregun celular, por edhe në segmentin e linjave fikse. E shoqëruar me një prirje rënëse të çmimeve, kjo ka çuar në një rritje të ndjeshme të vlerës ekonomike (value for money) të konsumatorëve Shqiptarë. Për shembull, operatori Altelecom ofroi në vitin 2017 një “paketë standarde” të shërbimeve të integruara fikse të telefonisë dhe aksesit broadband për një reduktim të çmimit prej 40 përqind nga plani bazë i nivelit të hyrjes të ofruar në vitin 2016. (Burimi: Raporti ITU 2018 fq.141-142)*

*Përveç sa më sipër, nga të dhënat e raportit të ITU për rankimin e vendeve sipas të ardhurave dhe investimeve kapitale vihet re se Shqipëria renditet në vendet e fundit në botë (anëtare të ITU):*

- *në vendin e 18 për të ardhurat më të ulëta nga shërbimet me pakicë (retail) në telekomunikacione;*
- *në vend të 22 për të ardhurat më të ulëta me pakicë (retail) nga shërbimet celulare;*
- *në vend të 30 për ARPU më të ulët nga shërbimet celulare;*
- *në vend të 10 për shpenzime (investime) kapitale dhe raportin shpenzime kapitale/të ardhura nga telekomunikacionet.*

***Sa më sipër, rekomandimi i KLSH për objektivin e vitit 2018 mund të konsiderohet i realizuar. Ndërkohë në kuadër të rishikimit të statusit të SHU për vitin 2020, AKEP do informojë KLSH për rezultatet e këtij rishikimi gjatë gjysmës së dytë të vitit 2020.***

- AKEP të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe masat e nevojshme ndaj sipërmarrësve të telefonisë celulare që brenda vitit 2020 të jenë mbuluar me shërbim të gjitha zonat me dendësi të ulët, si dhe të kryejnë monitorime të vazhdueshme për të identifikuar zonat që kanë nevojë për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

Lidhur me këtë rekomandim, sjellim në vëmendje se mbulimi me shërbim në zonat me dendësi të ulët varet nga prioriteti, planifikimi dhe mundësitë e operatorëve brenda përcaktimeve të autorizimeve përkatëse me të cilat janë pajisur nga AKEP sipas kuadrit ligjor në fuqi. Në kuadrin rregullator përcaktimet për operatorët mobile konsistojnë në:

- A. 95% mbulim kombëtar gjeografik me fuqi sinjali për shërbimin GSM dhe UMTS (mesatarja e përgjithshme gjeografike);
  - B. 85% mbulim në ndërtesa me fortësi sinjali për shërbimin GSM dhe UMTS.
- AKEP në planet vjetore të punës të përcaktojë objektiva SMART si dhe të hartojë plane pune të detajuara për përmbushjen e secilit objektiv institucional të planifikuar.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

### ***Për këtë rekomandim AKEP, shpreh angazhimin maksimal për përmbushjen e plotë të tij.***

Lidhur me rekomandimet e dhëna në kuadër të nënpyetjes së katërt: “A janë shërbimet e ofruara nga kompanitë celulare në përputhje me pritshmëritë e konsumatorëve”, AKEP gjykon të përcjellë si më poshtë masën e realizimit të tyre, hapat konkrete për zbatimin në vijim.

- AKEP të marrë të gjitha masat e nevojshme për të zhvilluar modelin pure LRIC për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve celulare, sikurse rekomandon BE dhe BEREC. Përdorimi i këtij modeli do të mundësojë reduktim të kostove të thirrjeve off net të operatorëve, do të rrisë konkurrencën në treg si dhe do të mundësojë tarifa më të lira për përdoruesit fundorë.

*Menjëherë*

Pas procedurës së tenderimit gjatë muajit dhjetor 2019, AKEP ka kontraktuar bashkimin e operatorëve “Air Communication” dhe “Tera Consultants” për hartimin e modelit të kostove për shërbimet e terminimit të thirrjeve telefonike celulare, proces në përfundim të të cilit pritet nxjerrja e tarifave të terminimit bazuar në modelin PURE-LRIC.

### ***AKEP do të njoftojë KLSH brenda afatit ligjor 6 mujor mbi përmbushjen e këtij rekomandimi.***

- Tarifat e terminimit për rrjetet celulare MTR në Shqipëri të përcaktuara nga AKEP të mos jenë më të larta se tarifat mesatare të vendosura nga Autoritetet rregullatore që kanë aplikuar metodologjinë Pure LRIC, derisa AKEP të zhvillojë metodologjinë Pure LRIC.

*Menjëherë dhe deri në zhvillimin e modelit Pure LRIC*

Ky rekomandim lidhet me dokumentin “*Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare*”, dokument për të cilin AKEP ka përfunduar këshillimin publik dhe është në proces vendimmarrjeje.

### ***Në proces realizimi dhe AKEP do të njoftojë KLSH brenda afatit ligjor 6 mujor nga marrja dijëni për raportin.***

## **9.3. Rekomandime të dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës**

Autoriteti i Konkurrencës ka paraqitur në AKEP rekomandime për sa i përket analizave të tregut si më poshtë:

Komisioni i Konkurrencës me vendimin Nr. 635, datë 04.07.2019, i rekomandon AKEP:

- Të realizojë analizën e tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë

masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu, për përcaktimin e ndërmarrjes “Vodafone Albania” sh.a me FNT në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe vendosjen e masave rregullatore përkatëse.

- Të vendosë nën rregullim tarifat e shërbimeve celulare me pakicë për ndërmarrjen me FNT, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9918/2008 të njëkohshme me tregun me shumicë të akses-origjinimit.
- Rregullimi i tarifave me pakicë për operatorin me FNT duhet të adresojë problemet e evidentuara nga analiza e tregut e AKEP, si:
  - i. on-net vs off-net në mungesë të masave të rregullimit të tarifave të shumicës për terminimin e thirrjeve;
  - ii. tarifat standarde jashtë ofertave janë shumë të larta.
- Krijimin e lehtësirave për hyrjen në treg të MVNO-ve, duke vendosur detyrime të qarta për ndërmarrjen me FNT për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit.

Por disa muaj më vonë, Komisioni i Konkurrencës me vendimin Nr.661, datë 21.11.2019, ka riformuluar rekomandimin e tij për AKEP, në termat përfundimtarë si në vijim:

- Përpara marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për këshillim publik “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare”, të vlerësojë: Komentet e Vodafone Albania, depozituar në AKEP më datë 18.06.2019, lidhur me analizën e tregut të shërbimeve celulare në përgjithësi;
- Të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit Evropian për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2018/C 159/01) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike.

AKEP analizoi me vëmendje të posaçme vendimet e Autoritetit të Konkurrencës në dritën e objektivave të ligjit 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si edhe të rekomandimeve dhe praktikave më të mira të Trupit të Rregullatorëve të Bashkimit Evropian (BEREC). Referuar orientimeve dhe konkluzioneve të rekomandimit përfundimtar të Autoritetit të Konkurrencës, plotësimi i tre kriterëve për tregun e shumicës së akses-origjinimit nuk konsiderohet i karakterizuar nga pikëpamja e kuadrit normativ për mbrojtjen e konkurrencës. Për rrjedhojë, AKEP konstatoi se ky kuadër është mjaftueshëm i pajisur për të ofruar të gjithë instrumentat dhe garancitë e duhura për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dhe në vijim problematikat e konkurrencës në tregun përkatës.

Vendimet e fundit të Autoritetit të Konkurrencës nr. 679, datë 14.02.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare” dhe nr. 680, Datë 14.02.2020, “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, dëshmojnë se në kushtet aktuale, ligji material për mbrojtjen e konkurrencës është i mjaftueshëm për të adresuar për zgjidhje problemet e konkurrencës në një treg të parregulluar *ex-ante* dhe pjesërisht objekt i analizës në shqyrtim, atë me pakicë të shërbimeve celulare.

Ndërhyrja paraprake e AKEP për përcaktimin e sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e detyrimeve rregullatore përkatëse, në referim të nenit 3, pika 5, të rregullores nr. 9/2009, nuk paraqiten si masa në përpjesëtim të drejtë me objektivin e mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efiçiente në kuadrin e ligjit 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, për sa kohë ky objektiv është i realizueshëm nëpërmjet instrumenteve të legjislacionit specifik nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Konkurrencës.

Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 9, datë 24.04.2020 “Mbi përfundimet e arritura pas

këshillimit publik për dokumentin “Analizë e tregut me shumicë të akses origjinimit në rrjetet celulare” ka vendosur:

1. Të vlerësojë si të paplotësuar testin e tre kritereve të sanksionuar në pikën 4 të nenit 3 të Rregullores, në përfundim të analizës së tregut kryer sipas përcaktimeve dhe hapave procedurale të parashikuara nga ligji 9918/2008 dhe Rregullorja 9/2009;
2. Të mos përcaktojë sipërmarrës me fuqi të ndjeshme duke mos vendosur detyrime rregullatore në tregun me shumicë të akses-origjinimit në rrjetet celulare, si pasojë e mosplotësimit të testit të tre kritereve, konform pikës 4 të nenit 5 të Rregullores.

# 10. BASHKËPUNIMI ME ENTE TË TJERA RREGULLATORE DHE INSTITUCIONE PUBLIKE

Gjatë vitit 2019, AKEP ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me ente të tjera rregullatore dhe institucione publike si më poshtë:

- Memorandum mirëkuptimi midis AKEP dhe Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) lidhur më datë 16.01.2019

Nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit është arritur të garantohet përmbushja e objektiva rregullatore që parashikon kuadri ligjor e nënligjor si zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta për informimin e operatorëve ekonomikë që zhvillojnë veprimtari në hapësirën elektronike, mbi të drejtat dhe detyrimet sipas kuadrit ligjor, zhvillimin e fushatave mediatike mbi informimin e operatorëve ekonomikë dhe mbajtësve të të drejtave të autorit mbi të drejtat dhe detyrimet sipas kuadrit ligjor; kryerjen e analizave dhe vlerësimeve të përbashkëta, verifikimin e përbashkët të ankesave të depozituara mbi veprimtarinë dhe shërbimet e operatorëve ekonomikë etj.

- Memorandum mirëkuptimi midis AKEP dhe Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve (DPT) i lidhur më datë 04.10.2019

Nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjeve të Mirëkuptimit të dy institucionet do të ndërveprojnë në një nivel të ri të shkëmbimit të informacionit dhe kontrollit, me qëllim forcimin e luftës kundër informalitetit, në subjektet që kryejnë veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike për zbatimin sa më korrekt të të drejtave dhe detyrimeve ligjore, si dhe koordinimin e veprimeve për pasqyrimin real të të dhënave të subjekteve/tatimpaguesve dhe rëndësinë e mbikëqyrjes së veprimtarisë tregtare të subjekteve, të cilët ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike ose shërbime të komunikimeve elektronike.

- Memorandum mirëkuptimi midis AKEP dhe Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike (AKCESK) i lidhur më datë 04.10.2019

AKEP gjatë vitit 2019 ka pasur një bashkëpunim dhe komunikim të vazhdueshëm me Autoritetin Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike (AKCESK) në lidhje me kërcënimet potenciale kibernetike dhe njoftimin në kohë reale të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike për marrjen e masave të menjëhershme.

Në këtë kuadër, AKEP ka finalizuar Marrëveshjen e Bashkëpunimit në mënyrë që këto dy institucione, të bashkëpunojnë në një kohë më të shpejtë dhe në nivel teknik për të marrë të gjitha masat e nevojshme teknike dhe organizative për çdo kërcënim apo sulm kibernetik ndaj infrastrukturave të rëndësishme dhe kritike të informacionit të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2019 kemi pasur 10 raportime në lidhje me incidente apo sulme kibernetike dërguar nga AKCESK, të cilat u janë dërguar rast pas rasti sipërmarrësve të komunikimeve elektronike për marrjen e masave të duhura.

AKEP do të vijoj bashkëpunimin me AKCESK edhe në kuadër të forcimit të sistemit unik on-line, për publikimin e faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme, sistem i cili administrohet dhe mirëmbahet nga AKCESK bazuar edhe në detyrën e tij ligjore për mirëfunksionimin e tij, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e autoriteteve publike, si dhe ofruesve të shërbimit të internetit (ISP-ve).

- Koordinim me Policinë e Shtetit, Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe Autoritetin e Mediave Audiovizive për bllokimin në akses të faqeve web/domain-eve, me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme.

Gjatë vitit 2019 është koordinuar me Policinë e Shtetit, Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe Autoritetin e Mediave Audiovizive për t'u përcjellë sipërmarrësve bllokimin në akses të faqeve web/domain-eve, me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme.

Në këto raste, AKEP u ka sjellë në kujtesë sipërmarrësve të komunikimeve elektronike se duhet të zbatojnë detyrimin e përcaktuar në nenin 15, pika e) e ligjit 9918/2008, *“respektimin e kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme, sipas rregullimeve përkatëse ligjore në fuqi”*.

Çdo operator/sipërmarrës që ofron shërbime/rrjete të komunikimeve elektronike sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm, duhet të respektojë rigorozisht detyrimin ligjor për të marrë masat e duhura juridike dhe teknike për kufizimin e transmetimeve të përcaktuara me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme<sup>12</sup> si dhe të gjejë zgjidhjet e duhura teknike për të bërë të mundur zbatimin e këtij detyrimi.

Rregullimet përkatëse ligjore në fuqi i referohen në fakt legjislacionit material specifik apo të përgjithshëm, sikundër janë ligji nr. 97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, ligji nr. 155/2015 *“Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, kodet penal dhe të procedurës penale, etj. Këto kufizime, që kanë të bëjnë me përmbajtjen e publikimeve elektronike nuk përkufizohen nga ligji për komunikimet elektronike dhe nuk janë, për pasojë, prerogativë e AKEP, por e institucioneve të krijuara apo të garantuara në legjislacionin specifik dhe të përgjithshëm të sipërpërmendur.

Në bazë të nenit 2 të Ligjit Nr. 9918/2008 për komunikimet elektronike, AKEP nuk trajton *“përmbajtjen e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike”*. AKEP rregullon dhe mbikëqyr aspektet teknike të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, por nuk ka tagër të vëzhgojë, shqyrtojë, apo ndërhyjë në përmbajtjen e këtyre shërbimeve.

Gjatë vitit 2019, me kërkesë të organeve kompetente, u janë dërguar për mbyllje aksesi ISP-ve rreth:

- 8000 domain-e të cilat ofronin lojëra fati online në shkelje të ligjit respektiv për lojërat e fatit;
- 83 domain-e me anën e të cilave ofroheshin programe televizive në shkelje të ligjit respektiv për mediat audiovizive.

- Bashkëpunimi me MIE për hartimin e dokumentit të strategjisë për 5G në Shqipëri

Gjatë vitit 2019, AKEP ka marrë pjesë aktive dhe ka dhënë eksperiencën teknike në takimet e zhvilluara në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për hartimin e dokumentit të strategjisë për 5G në Shqipëri. AKEP ka dhënë kontributin duke saktësuar brezat e dhënë në përdorim nga AKEP, brezat e nevojshëm për tu dhënë në përdorim në varësi të zhvillimeve teknologjike ku përfshihen edhe brezat 700 MHz, 3400-3800 MHz dhe 26 GHz, përdorimeve në vendet e rajonit dhe BE, përcaktimeve të CEPT për breza të ndryshëm frekuencash, standardet teknike në lidhje me frekuencat për tu zbatuar nga operatorët, etj.

<sup>12</sup> Bazuar në përcaktimet e nenit 15 të Ligjit nr. 9918, si dhe gurmës e), pika 1, e nenit 9, si dhe pika 9 e Aneksit E, të Rregullores nr. 47 datë 26.10.2017 *“Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”*.


# 11. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare organizohet dhe funksionon referuar strukturës organizative miratuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 56/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës, dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”.

Struktura organizative dhe organika e AKEP:

- Përbëhet nga 85 punonjës, 8 drejtori dhe 14 sektorë.
- Gjatë vitit 2019 janë kryer procedurat e nevojshme administrative për të shpallur pozicionet e lira të punës për 25 punonjës, duke ndjekur procedurat e rekrutimit me lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil.
- Aktualisht rezulton 1 pozicion i lirë pune.

## ORGANIGRAMA E AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE





# 12. REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË

Buxheti i AKEP për vitin 2019 është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.122 datë 13.03.2019 “Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e komunikimeve Elektronike e Postare, për vitin 2019” dhe fondi i shpenzimeve konsistonte në vlerën 378 360 000 (treqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë.

## 12.1. Të ardhurat dhe shpenzimet

TABELA NR. 15 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET (NË MILION LEKË)

Nr.	Emërtimi	Viti 2019		Diferenca Fakt-Program	% e realizimit vjetor
		Programi	Fakti		
I	Të ardhurat gjithsej:	378,36	377,56	-0,81	99,8%
II	Shpenzime gjithsej:	378,36	315,25	63,11	83,3%
1	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	114,05	100,75	13,30	88,3%
2	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	14,75	13,48	1,27	91,4%
3	Shpenzime për materiale	8,73	7,09	1,64	81,2%
4	Shpenzime për shërbime	148,91	113,95	34,97	76,5%
5	Shpenzime për Investime	91,92	79,99	11,93	87,0%
III	Tarifa e shërbimit të radikomunikacionit				
1	Arkëtuar në llogarinë e AKEP për buxhetin e Shtetit		469,92		
2	Të ardhurat si agjent tatimor	23,00	24,73		

Burimi: AKEP

## 12.2. Realizimi i pagesave për AKEP

Pagesat për vitin 2019 janë realizuar nga pagesat e kryera nga sipërmarrësit<sup>13</sup> që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare:

- Pagesa për caktimin dhe përdorim të frekuencave;
- Pagesa për numeracion;
- Pagesa për mbikëqyrje të tregut;
- Pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit;
- Pagesa për Domain;
- Komisioni i përfituar si agjent tatimor.


<sup>13</sup> Pagesat bazohen në VKM Nr.599, datë 23.07.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP”, i ndryshuar , akteve normative në zbatim të Ligjit 9918/2008, akteve normative të dala në zbatim të këtij Ligji, si dhe nga udhëzimi i përbashkët nr. 30, datë 12.1.2015, i ndryshuar i MFE dhe AKEP.

Për vitin 2019 pagesat për AKEP janë realizuar në vlerën rreth 377.56 milion lekë, nga 378.36 të programuara sipas relacionit shoqërues të buxhetit, ose 99.8%.

### 12.3. Realizimi i shpenzimeve

Totali i shpenzimeve të AKEP për vitin 2019 në terma nominale është 315,25 milion lekë nga rreth 378,36 milion lekë të parashikuara dhe miratuara, ose e shprehur në përqindje rreth 83.3 % e programit. Po t'i referohemi normës në % të një viti më parë mund të shprehemi se shpenzimet janë realizuar pothuajse në të njëjtën normë. Kjo diferencë midis faktit dhe programit vjen si rrjedhojë e uljes së çmimeve të prokurimit sipas objekteve si dhe nga mosrealizimi i disa objekteve të shpenzimeve administrative.

GRAFIKU NR. 38 STRUKTURA E SHPENZIMEVE PËR VITET 2015-2019



Burimi: AKEP

### 12.4. Mbi tepricën e të ardhurave

Teprica e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2019 rezulton në shumën rreth 61.87 milion lekë, si rezultat i diferencave nga pagesat e sipërmarrësve dhe mos realizimit të disa zërave të miratuar në fondin e shpenzimeve të AKEP. Teprica e akumuluar do të derdhet në Buxhetin e Shtetit sipas përcaktimeve ligjore pas mbylljes së pasqyrave financiare për vitin 2019.

### 12.5. Mbi taksën e radiokomunikacionit

AKEP është agjent tatimor për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në Buxhetin e Shtetit të tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit<sup>14</sup>.

<sup>14</sup> Në referencë të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar si dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 06.10.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit” i ndryshuar.

Për vitin 2019 janë arkëtuar nga tarifa e shërbimit të radiokomunikacionit rreth 494.65 milion lekë ose 7% më shumë se një vit më parë.

Nga vlera e arkëtuar, 5% është mbajtur në burim nga AKEP si agjent tatimor, bazuar në udhëzimin nr. 27, datë 16.12.2014, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Të ardhurat e përfituara si agjent tatimor nga komisione në masën 5 % të shumës së derdhur në Buxhetin e Shtetit, janë rreth 24.73 milion lekë.

Vlera e derdhur në Buxhetin e Shtetit, mbi taksën e radiokomunikacionit është 469.92 milion lekë.

AKEP ka ndjekur me dinamikë mbledhjen e tarifës së radiokomunikacionit, si dhe ka raportuar dhe derdhur në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë brenda afatit çdo muaj.

## 12.6. Programi i treguesve financiarë të AKEP për vitin 2020

Në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. Nr.159 datë 19.02.2020 “Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për vitin 2020”, miratoi fondin e shpenzimeve në vlerën 384 760 000 (treqind e tetëdhjetë e katër milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë lekë, cili paraqitet më poshtë i detajuar sipas zërave kryesore.

TABELA NR. 16 FONDI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2020

Nr.	Pagesat:	Në mijë lekë	Shpenzime	Në mijë lekë
1	nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike	164,000	Shpenzime për paga	117,711
2	nga pagesa për caktimin e përdorimit e frekuencave	132,000	Shpenzime për sigurimet shoqërore e shëndetësore	14,989
3	nga pagesa për numeracionin	26,000	Shpenzime për materiale	8,546
4	nga pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit të numrit	20,160	Shpenzime për shërbime	154,354
5	nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar	8,500	Shpenzime për investime	89,160
6	nga pagesa për domain	9,400		
7	nga pagesa të tjera	700		
8	nga agjenti tatimor	24,000		
	<b>Total</b>	<b>384,760</b>	<b>Total</b>	<b>384,760</b>

Burimi: AKEP



# 13. PROCESET GJYQËSORE

Gjatë vitit 2019, AKEP është investuar si palë ndërgjyqëse, në 18 çështje administrative e civile nga të cilat në:

a) Cilësinë e palës së paditur, në 14 procese gjyqësore:

- i. 6 kërkesë padi janë rrëzuar nga gjykata;
- ii. 2 çështje janë pushuar;
- iii. 1 çështje është pranuar pjesërisht kërkesë padia;
- iv. 5 kërkesë padi janë pranuar.

b) Cilësinë e palës paditëse, në 1 proces gjyqësor.

c) Cilësinë e personit të tretë, në 3 procese gjyqësore.

AKEP, është përfshirë si palë ndërgjyqëse në 12 procese gjyqësore të karakterit administrativ në cilësinë e palës së paditur (ankime ndaj vendimeve të Këshillit Drejtues), prej të cilave në:

- i. 6 çështje, gjykata ka vendosur në favor të AKEP;
- ii. 3 çështje është vendosur pushim i gjykimit;
- iii. 3 çështje është vendosur pranim i padisë.

AKEP, është përfshirë si palë ndërgjyqëse në 3 procese gjyqësore pune, 2 nga të cilat në cilësinë e palës së paditur dhe 1 në cilësinë e palës paditëse në kuadër të ristrukturimit të ndodhur në vitin 2018, përkatësisht:

- i. 1 çështje gjykata ka rrëzuar kërkesë padinë e AKEP;
- ii. 1 çështje është vendosur pranim i kërkesë padisë së ish-punonjësit;
- iii. 1 çështje është vendosur pranim i pjesshëm i kërkesë padisë së ish-punonjësit.

Çështje të tjera në të cilat AKEP, është përfshirë si palë ndërgjyqëse në cilësinë e personit të tretë, kanë qenë kryesisht për çështje gjyqësore dhe mosmarrëveshje midis sipërmarrësve.



# 14. MARRJA E MASAVE PËR SIGURINË E RRJETEVE DHE/OSE SHËRBIMEVE

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë dhe veçanërisht kapitullit të sigurisë së komunikimeve elektronike, gjatë vitit 2019 i kushtoi një rëndësi të veçantë sigurisë së rrjeteve dhe informacionit nga sipërmarrësit që janë pajisur me autorizim të përgjithshëm për shërbime të komunikimeve elektronike.

AKEP ka administruar raportet e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe ka kryer vlerësimin e raporteve sipas 6 fushave kryesore të mëposhtme:

- Sigurinë fizike të ambienteve dhe aseteve të sipërmarrësve;
- Sigurinë e rrjeteve, sistemeve dhe aplikacioneve mbështetëse;
- Plani i trajtimit ose reagimit ndaj incidenteve të sigurisë dhe Plani i Vazhdimësisë të Biznesit;
- Politikën e Sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale në ruajtje, procesim dhe transmetim;
- Politikat e aksesit të kontrollit, rolet dhe përgjegjësitë e punonjësve që merren me çështjet e sigurisë;
- Regjistër të shkeljeve ose incidenteve të sigurisë ku të specifikohet shkelja, kategorizimi i saj, shkaku, pasoja, masat e ndërmarra etj.

AKEP ka vlerësuar raportimet e sipërmarrësve duke përcaktuar rast pas rasti se cilat pika janë plotësuar në raport dhe cilat pika nuk janë adresuar, gjithnjë duke pasur në konsideratë origjinalitetin e këtyre raportimeve, pra faktin që raporti të përshkruaj realisht sistemet, pajisjet, masat dhe zgjidhjet që ata kanë të instaluar dhe në përdorim në rrjetet e tyre dhe të mos përmbaj të dhëna të rreme apo të kopjuara.

- Në fund të vitit 2019, nga evidentimi i 203 sipërmarrësve;
- 128 sipërmarrës kanë përmbushur detyrimet ligjore dhe ato rregullatore përkatëse duke respektuar detyrimin e raportimit për masat teknike dhe organizative të sigurisë,
- 75 sipërmarrës nuk përmbushin detyrimet ligjore dhe ato rregullatore përkatëse pasi nuk kanë dërguar raportimin përkatës.

Për sa i përket vlerësimit të raporteve për 128 sipërmarrës që e kanë respektuar detyrimin e raportimit, rezulton se:

- për 46 sipërmarrës të komunikimeve elektronike, raportet mbi masat teknike dhe organizative të sigurisë ishin të plotë dhe në përputhje me përcaktimet dhe kërkesat e Rregullores Nr.37 datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”;
- për 82 sipërmarrës të komunikimeve elektronike, raportet u kthyen për rishikim pasi nuk ishin të plotë dhe konform përcaktimeve dhe kërkesave të Rregullores Nr.37 datë 29.10.2015. Më pas këta sipërmarrës ndërmorën masat e duhura teknike dhe organizative duke i pasqyruar në raportin e sigurisë.

Vlerësimi i raporteve të sigurisë, konsiston në:

- Deklarimin e personit përgjegjës për çështjet e sigurisë;
- Publikimin në website të udhëzuesit për përdoruesit rreth incidenteve më të zakonshme të sigurisë sipas shkronjës “j” të pikës 1 të Nenit 6 të Rregullores Nr.37 datë 29.10.2015 “Mbi Masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”;
- Vendosjen e regjistrimit të shkeljeve ose incidenteve të sigurisë ku të specifikohet shkelja, kategorizimi i saj, shkaku, pasoja, masat e ndërmarra etj. sipas përcaktimeve të pikës 7 të nenit 6 të Rregullores Nr.37 datë 29.10.2015 “Mbi Masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”;
- Vendosjen e Planit të Trajtimit ose reagimit ndaj incidenteve të sigurisë dhe Plani i Vazhimit të Biznesit në rastet e situatave të jashtëzakonshme apo katastrofave sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 6 të Rregullores Nr.37 datë 29.10.2015 “Mbi Masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

#### **14.1. Sistemi i përqendruar i informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike (ATLAS)**

AKEP ka ngritur sistemin ATLAS, ku të gjithë sipërmarrësit e komunikimeve elektronike regjistrojnë rrjetin e tyre<sup>15</sup>.

Gjatë vitit 2019 është vazhduar me punën mbi përditësimin e të dhënave në sistemin e përqendruar të informacionit të rrjeteve të komunikimeve elektronike (ATLAS).

Janë informuar të gjithë operatorët mbi detyrimin për përditësimin e të dhënave në sistem, dhe shumica e operatorëve kanë regjistruar të dhënat në sistemin online. Për t'u ardhur në ndihmë operatorëve për përditësimin e të dhënave në sistem, AKEP ka zhvilluar trajnime me operatorët që shfaqin interes mbi mënyrën e përditësimit të të dhënave në sistemin online.

Ky është një proces i vazhdueshëm, konform rregullores Nr. 26 datë 16.08.2012 për “Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrimit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë vitit 2019 janë informuar të gjitha Bashkitë mbi detyrimin që ato kanë mbi përditësimin e të dhënave në sistemin e përqendruar të informacionit të rrjeteve të komunikimeve elektronike. Gjithashtu është punuar me një pjesë të Bashkive, duke zhvilluar sesione trajnime mbi aksesin dhe përdorimin e sistemit ATLAS. Ky proces është në vazhdim për të gjitha Bashkitë në Republikën e Shqipërisë.

Në bashkëpunim me Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) është përditësuar informacioni gjeohapësinor në Gjeoportalin Kombëtar për rrjetet e komunikimeve elektronike.


Në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë është punuar për projektin “WB19-ALB-DII-01, Studim fizibiliteti për zhvillimin rajonal të broadband-it”. Ky projekt ka për qëllim shfaqjen e mundësisë së aksesit në internet, mundësinë e sigurimit të lidhjes së internetit me brez

<sup>15</sup> Në zbatim të Ligjit Nr.9918, datë 19.5.2008 për “Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 120/2016 “Për Zhvillimin e Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë dhe Sigurimin e së Drejtës së Kalimit” si edhe Rregullores Nr. 26 datë 16.08.2012 për “Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrimit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë”.


të gjerë si edhe rritjen e mundësive dhe stimulimin e investimeve në zonat ku aktualisht broadband mungon ose është në mungesë konkurrence, në të gjitha Bashkitë e Republikës së Shqipërisë.

Po kështu, gjatë vitit 2019 ka vijuar bashkërendimi i veprimeve me të gjithë aktorët e interesuar për shkëmbim informacioni për rrjetin e komunikimeve elektronikë. Është bashkëpunuar me ministrinë përgjegjëse në kuadër të hartimit dhe zbatimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.

HARTA ME RRJETIN E RADIOVE LTE DHE RRJETIN E FIBRËS OPTIKE



**HARTA E RRJETEVE BACKBONE TË FIBRAVE OPTIKE NË SHQIPËRI DHE PIKAT E LIDHJES FIZIKE ME RRJETE NDËRKOMBËTARE TË VENDEVE FQINJE**





# 15. FUSHAT KRYESORE DHE PRIORITETET STRATEGJIKE TË AKEP PËR VITIN 2020

## 1. Kushte të favorshme për investime të qëndrueshme

- Zhvillimi i infrastrukturës broadband. Dhënie ekspertize dhe bashkëpunim proaktiv për implementimin e ligjit 120/2016.
- Përditësimi i ATLAS me informacion të përmirësuar nga operatorët për infrastrukturën e rrjeteve si dhe rritje e funksionaliteteve të tij.
- Ndjekje e procedurave për vënien në dispozicion të operatorëve celularë të spektrit të frekuencave, të përshtatshme për shërbimet broadband me shpejtësi të lartë, përfshirë këtu edhe spektrin e paalokuar 800 MHz.
- Mbështetje e iniciativave për zhvillim broadband në zonat komercialisht jo-tërheqëse. Bashkëpunim i vazhdueshëm me operatorët për investime dhe bashkë-investime në zonat Vermosh Qendër, Valbona Qendër, Gërmenj, Kapi i Rodonit, Shkopet.

## 2. Nxitje e konkurrencës

- Marrja e vendimeve përkatëse për dokumentin “Analizë e Tregut me Shumicë të Aksesit dhe Origjinimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare”
- Vendimmarrje për dokumentin “Analizë Tregu e Telefonisë Celulare për Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare, përfshirë Terminimin e Thirrjeve Hyrëse Ndërkombëtare”
- Vijimi i procesit për hartimit të dokumentit për rregullimin e tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse si dhe identifikimi i sjelljeve antikonkurrese dhe percaktimi i detyrimeve ligjore bazuar në praktikata me me mira të vendeve të BE.
- Kryerja e analizës së tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi i ofruesve të mundshëm të shërbimit universal postar.

## 3. Nxitje dhe promovim i të drejtave të konsumatorit

- Miratimi dhe implementimi i kuadrit të ri rregullator për mbrojtjen e konsumatorit/përdoruesit.
- Kryerja e një procesi këshillimi publik për përdoruesit me aftësi të kufizuara dhe përdoruesit me të ardhura të ulëta.
- Vijimi i implementimit të marrëveshjeve RLAH+ me Republikën e Kosovës dhe vendet e Ballkanit Perëndimor.
- Monitorimi i cilësisë së shërbimit dhe nxitje e operatorëve për përmirësimin e cilësisë duke u fokusuar kryesisht edhe në zonat me dendësi të ulët të popullsisë.
- Nxitje e të drejtave të konsumatorëve dhe promovimi i konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, nëpërmjet inspektimeve, në funksion të formalizimit të aktiviteteve të subjekteve tregtare që ushtrojnë veprimtari të komunikimeve elektronike dhe postare.
- Rishikim i statusit të SHU postar dhe cilësisë së shërbimeve postare për konsumatorin, kryerja e procedurave për përzgjedhjen e ofruesit të Shërbimit Universal Postar.

## 4. Efikasiteti i brendshëm i AKEP dhe partneriteti me institucionet

- Reformë e kuadrit ligjor të komunikimeve elektronike në funksion të implementimit të kodit të ri të komunikimeve elektronike dhe forcim dhe garantim i pavarësisë institucionale.
- Bashkëpunim aktiv me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në kuadër të iniciativës së saj për hartimin e Strategjisë 5G në Shqipëri, dhe shfytëzimin e frekuencave të brezit 700 MHz.
- Investime për të mundësuar monitorimin efikas të spektrit të frekuencave për krijimin e një mjedisi pa interferenca. Bashkëpunim me KMK për monitorimin e niveleve të rrezatimeve jonoizuese.
- Bashkëpunim me MIE në kuadër të procedurave ligjore për miratimin/adoptimin e Direktivës së Re (EU) 2018/1972 “Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike”.
- Rritje e bashkëpunimit me institucionet kombëtare (MIE, AK, AMA, KMK, INSTAT, DPT, QKB etj.) dhe ndërkombëtare (BEREC, KE, ITU, ERPG etj.) në funksion të promovimit dhe nxitjes së konkurrencës midis operatorëve që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike dhe postare, përmirësimit të produkteve dhe cilësisë së shërbimit për konsumatorët, si dhe luftës kundër informalitetit.

# ANEKS 1

## Raport lidhur me nivelin e zbatimit të rezolutës dhe rekomandimeve të Kuvendit të RSH për AKEP për vitin 2019

- 1) T'i kushtojë vëmendje të veçantë vendimmarrjes, lidhur me “Analizën e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare”; në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke bashkëpunuar ngushtë edhe me strukturat përkatëse të BE-së si dhe duke iu referuar eksperiencave dhe ekspertizës së tyre.

### Realizuar Pjesërisht

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare gjatë vitit 2019 i ka kushtuar vëmendje të veçantë hartimit të dokumenteve të analizës së tregjeve celulare.

AKEP ka ndjekur me rigorozitet procedurën specifike të këshillimit të përcaktuar në nenet 34 dhe 35 të ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar vendimet për daljen në këshillim publik të dokumenteve të analizës së tregut si më poshtë:

- Vendimi Nr.10, datë 17.04.2019, miratimi për Këshillim Publik i dokumentit “*Analizë Tregu e Telefonisë Celulare për Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare, përfshirë Terminimin e Thirrjeve Hyrëse Ndërkombëtare*”.
- Vendimi Nr.11, datë 17.04.2019, miratimi për Këshillim Publik i dokumentit “*Analizë e Tregut me Shumicë të Aksesit dhe Origjinimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare*”.

Të dy dokumentet për vetë rëndësinë që paraqesin kanë dalë në këshillim publik për një periudhë dy mujore (18.04.2019 – 20.06.2019), për të cilat janë paraqitur komente/mendime nga Autoriteti i Konkurrencës dhe sipërmarrësit.

Dinamika e analizave të tregut në mënyrë kronologjike është zhvilluar si vijon:

### I. Tregu me shumicë i akses-origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare

Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin Nr.11, datë 17.04.2019 miratoi për Këshillim Publik dokumentin “*Analizë e Tregut me Shumicë të Aksesit dhe Origjinimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare*”.

Në procesin e analizës së tregut me shumicë të Akses Origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare, është përfshirë për efekt analize edhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare, por kjo vetëm për efekt të evidentimit të problemeve të konkurrencës (plotësimi të Testit të Tre Krieteve<sup>16</sup> dhe nëse

<sup>16</sup> (i) Prezenca e barrierave të larta dhe jo-kalimtare të hyrjes;  
(ii) Një strukturë tregu e cila nuk ka tendencë për të shkuar në drejtimin e një konkurrencë efektive brenda afatit kohor përkatës;  
(iii) Pamjaftueshmëria e ligjit të konkurrencës për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dështimin e tregut të marre në shqyrtim.

plotësohet ky test, përcaktimit të sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) dhe vendosjes së masave rregullatore përkatëse).

Sipas udhëzuesit të Komisionit Evropian për analizën e tregjeve, rregullimi *ex-ante* duhet të vendoset vetëm në rastet kur masat që mund të aplikohen nëpërmjet ligjit të konkurrencës janë të pamjaftueshme për të adresuar problemet e identifikuar të konkurrencës.

Qëllimi i analizave të tregut ka qenë evidentimi i problemeve të konkurrencës, shpalljes së operatorëve me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse, marrja e masave rregullatore dhe miratimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare në funksion të arritjes së objektivave të AKEP për të:

- promovuar efikasitetin e rrjeteve celulare;
- promovuar konkurrencën e qëndrueshme në tregun me pakicë të shërbimeve celulare;
- mundësuar përfitime më të mëdha pajtimtarëve nga shërbimet e komunikimeve elektronike (celulare).

Në mënyrë kronologjike dinamika e vendimmarrjes për analizat e tregjeve me shumicë të Akses Origjinimit është si vijon:

- Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar vendimin Nr. 16 datë 22.02.2018 për “*Miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Këshillim publik”*”.
- Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar vendimin Nr. 78 datë 01.10.2018 për “*Miratimin të dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – dokument përfundimtar”*”.
- Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar vendimin Nr. 79 datë 01.10.2018 për “*Përcaktimin e Sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe masat përkatëse Rregullatore*”.
- Me vendimet Nr. 80 dhe 81, Këshilli Drejtues ka miratuar vendimet respektive për përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom dhe Telekom Albania sh.a me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare si dhe masat përkatëse Rregullatore.
- Me vendimin Nr. 82 datë 01.10.2018, KD i AKEP vendosi për “*Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Rregullimi i tarifave të Sipërmarrësve me fnt në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit të shërbimeve celulare”*”.
- Ndërkohë, me Vendimin Nr. 89 datë 15.11.2018, Këshilli Drejtues i AKEP vendosi “*Shfuqizimin e Vendimit nr.78, datë 01.10.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentit: “Analizë e Tregut Celular: Tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – dokument përfundimtar”, si dhe shfuqizimin e vendimeve të Këshillit Drejtues përkatësisht nr.79, nr.80, nr.81 dhe nr.82, datë 01.10.2018”*”.

Në përfundimin e periudhës së këshillimit publik të Vendimit Nr.11, datë 17.04.2019 “*Analizë e Tregut me Shumicë të Aksesit dhe Origjinimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare-Këshillim Publik*” dhe pas marrës së opinioneve të palëve të interesuara rreth çështjeve kryesore<sup>17</sup>, AKEP i ka diskutuar ato gjerësisht me ekspertë të Komisionit Evropian në nivel teknik përmes dy conference call gjatë muajve gusht dhe tetor. Gjithashtu, dokumenti është diskutuar si në takime dypalëshe të niveleve të ndryshme (OFcom, Komisioni Evropian) edhe në takime në kuadër të forumeve të BEREC.

Lidhur me procesin e analizave të tregut celular, Komisioni i Konkurrencës ka paraqitur dy mendime, të parashtruara nëpërmjet:

A. Vendimit nr. 635, datë 04.07.2019, në të cilin i rekomandon AKEP-it si më poshtë vijon:

- Të realizojë analizën e tregut të pakicës të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu, për përcaktimin e ndërmarrjes “Vodafone Albania” sh.a me FNT në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe vendosjen e masave rregullatore përkatëse;
- Të vendosë nën rregullim tarifat e shërbimeve celulare me pakicë për ndërmarrjen me FNT, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9918/2008 të njëkohshme me tregun me shumicë të akses-origjinimit;
- Rregullimi i tarifave me pakicë për operatorin me FNT duhet të adresojë problemet e evidentuara nga analiza e tregut e AKEP, si: i. on-net vs off-net në mungesë të masave të rregullimit të tarifave të shumicës për terminimin e thirrjeve; ii. Tarifat standarde jashtë ofertave janë shumë të larta;
- Krijimin e lehtësirave për hyrjen në treg të MVNO-ve, duke vendosur detyrime të qarta për ndërmarrjen me FNT për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit;
- Të vendosë nën rregullim tarifat e shërbimeve celulare me pakicë për ndërmarrjen me FNT, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9918/2008 të njëkohshme me tregun me shumicë të akses-origjinimit.

Në datën 21.11.2019, katër muaj pas vendimit të parë për këtë çështje, Komisioni i Konkurrencës miraton dhe i përcjell AKEP-it, një vendim të dytë për çështjen e analizave nëpërmjet:

B. Vendimit nr.661, “Për dhënien e disa rekomandimeve për Autoritetin të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, përpara marrjes së vendimit përfundimtar lidhur me dokumentin për këshillim publik “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare*” rekomandon si vijon:

- Përpara marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për këshillim publik “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare*”, të vlerësojë:
- Komentet e Vodafone Albania, depozituar në AKEP më datë 18.06.2019 lidhur me Analizën e Tregut të shërbimeve celulare në përgjithësi;
- Të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit Evropian për analizën e tregut dhe

<sup>17</sup> Në zbatim të vendimit Nr. 89, datë 15.11.2018 të Këshillit Drejtues ku ndër të tjera citohet: “AKEP do të bashkëpunojë ngushtësisht me strukturat e Komisionit Evropian për të përfutur ekspertizën dhe kontributin e ofruar prej tyre në këtë proces”

vlerësimin e FNT (2018/C 159/01) sipas kuadrit rregullator për komunikimet.

*Ky rekomandim i Komisionit të Konkurrencës e orienton Testin e Tre Kriterëve drejt mos plotësimin të kriterit të tretë, pasi AK i rekomandon AKEP vlerësimin e komenteve të Vodafone Albania dhe rekomandimin e Komisionit Evropian ku tregu i akses origjinimit dhe ai i pakicës nuk janë në rregullim nga Rregullatorët Kombëtarë (NRA) dhe ligji konkurrencës i zbatuar nga Autoritetet e Konkurrencës është i mjaftueshëm për të zgjidhur problemet e konkurrencës në tregjet përkatëse.*

Sa më lart, lidhur me dokumentin “*Analiza e tregut me Shumicë të Aksesit dhe Origjinimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare*”, Këshilli Drejtues i AKEP është në shqyrtim mendimeve dhe komenteve dhënë nga sipërmarrësit si dhe Autoriteti i Konkurrencës, për të marrë vendimmarrjen përkatëse mbi dokumentin përfundimtar të analizës së tregut në përputhje edhe me praktikatat më të mira të BE dhe BEREC.

## **II. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare**

Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin Nr.10, datë 17.04.2019 ka miratuar për Këshillim Publik dokumentin “*Analizë Tregu e Telefonisë Celulare për Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare, përfshirë Terminimin e Thirrjeve Hyrëse Ndërkombëtare*”.

Dokumenti ka dalë në këshillim publik dhe janë marrë mendime nga palët e interesuara dhe Autoriteti i Konkurrencës.

Në mënyrë kronologjike vendimmarrja e AKEP ka qenë si vijon:

- Me vendimin Nr.11 datë 22.02.2018, Këshilli Drejtues i AKEP ka vendosur për “Miratimin e Dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Dokumenti Përfundimtar*”;
- Me vendimet 12, 13, 14, KD i AKEP ka vendosur përcaktimin respektivisht të sipërmarrësit Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm dhe vendosjen e masave rregulluese për FNT;
- Me vendimin Nr.15 datë 22.02.2018, KD i AKEP ka vendosur për “Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare–Këshillim Publik 2”;
- Pas këshillimit publik, me vendimin Nr.70 datë 01.10.2018, KD i AKEP ka vendosur për “Miratimin e dokumentit: Rregullimi i tarifave të Sipërmarrësve me fnt në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – dokumenti përfundimtar”;
- Me vendimet Nr.71, 72 dhe 73, të datës 01.10.2018, Këshilli Drejtues i AKEP ka vendosur rregullimin e tarifave të sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a, Telekom Albania sh.a dhe Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg, për tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm.

Sipas këtyre vendimeve tarifa e terminimit u ul nga 1.44 lekë/min në 1.22 lekë/minutë nga 1 dhjetori 2018 dhe në 1.11 lekë nga 1 dhjetori 2019, tarifë kjo që vijon të jetë ende në fuqi.

AKEP pas përfundimit të procesit të konsultimit publik të Vendimit Nr.10, datë 17.04.2019 “Analizë Tregu e Telefonisë Celulare për Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare, përfshirë Terminimin e Thirrjeve Hyrëse Ndërkombëtare”, është në proces të shqyrtimit të komenteve të palëve të interesuara/sipërmarrësve si dhe vendimeve/rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Konkurrencës dhe më pas do të marrë vendimet përkatëse.

- 2) Të bëjë një analizë të plotë të shkaqeve që çuan në daljen nga një treg i rregulluar i një operatori nëse këto shkaqe lidhen me problematikën e vendimmarrjeve të rregullatorit apo dështimit në menaxhim të operatorit të fundit në treg dhe të reflektojë konkluzionet e kësaj analize.

## Realizuar

AKEP gjykon se analiza e shkaqeve të daljes së një operatori nga një treg i rregulluar është padyshim shumë dimensionale duke marrë në konsideratë modelet e menaxhimit të biznesit, kushtet e përgjithshme ekonomike-sociale, eksperiencën e pamjaftueshme në industri, sjelljen strategjike, strukturën aksionere dhe korporative, menaxhimin e operacioneve, kostot e rrjetit etj., dhe nuk mund të jetë shteruese në asnjërin prej këndvështrimeve si nga ana e AKEP-it si organ rregullator, ashtu edhe nga ana e Autoritetit të Konkurrencës apo vetë menaxhimit brendshëm dhe vendimmarrjes të shoqërisë.

Me anë të Vendimit Nr.11, datë 17.04.2019 miratimi për Këshillim Publik i dokumentit “Analizë e Tregut me Shumicë të Aksesit dhe Origjinimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare”<sup>18</sup>, AKEP ka analizuar daljen nga tregu të sipërmarrësit Plus Communication sh.a dhe një nga pyetjet e shtruar nga AKEP në dokumentin e këshillimit publik ishte: - *Si ka ndikuar nga pikëpamja e konkurrencës në tregjet përkatëse dalja nga tregu e sipërmarrësit Plus Communication sh.a?*

Sipas dokumentit të analizës së tregut, dalja nga tregu i operatorit Plus Communication sh.a e ndryshoi strukturën e tregut duke filluar nga data 1 janar 2018, duke e zvogëluar atë nga 4(katër) në 3 (tre) operatorë, e duke vijuar në këtë mënyrë trendin rritës të indeksit të përqendrimit të tregut. Dy sipërmarrësit me peshën më të madhe në treg kanë rritur ndjeshëm kapacitetet konkurruese nëpërmjet marrjes së 50% me 50% të të drejtave të përdorimit të frekuencave që zotëronte sipërmarrësi Plus Communication sh.a.

Sa i përket shkaqeve të tjera, AKEP ka analizuar se sipërmarrësit ekzistues në treg kanë shfrytëzuar:

- avantazhet e lëvizjeve të para në teknologjitë e reja, kryesisht ndaj teknologjisë 3G e më pas 4G, teknologji të cilën shoqëria Plus Communication sh.a, e ka implementuar më vonë se operatorët e tjerë;
- faktin e të bërit pjesë në grupe të mëdha evropiane të telefonisë mobile;
- mundësinë për investime nga kompania mëmë;
- emrin e mirë të markës;
- ngritjen e rrjeteve dhe sistemeve;
- marrjen e bazës më të madhe të pajtimtarëve për shkak të hyrjes më përpara në treg etj.

<sup>18</sup> [https://akep.al/wp-content/uploads/bsk-pdf-manager/2019/04/Analiza\\_e\\_Telefonise\\_Celulare\\_Akses\\_Origjinimit\\_Keshillim\\_Publik.pdf](https://akep.al/wp-content/uploads/bsk-pdf-manager/2019/04/Analiza_e_Telefonise_Celulare_Akses_Origjinimit_Keshillim_Publik.pdf)

Del e nevojshme të sqarohet se problemet kryesore sipërmarrësi i ka shfaqur në tregun e shërbimeve celulare me pakicë, treg i cili nuk gjen rregullim nga AKEP, pasi nuk është i përcaktuar në listën e tregjeve për rregullim dhe as në rregulloren e miratuar nga AKEP “Për analizën e tregjeve”.

Në rast se AKEP gjatë analizimit dhe përcaktimit të një tregu arrin në përfundimin se, ky treg nuk plotëson një nga 3 kriteret e përcaktuara nga KE<sup>19</sup>, AKEP nuk e analizon këtë treg për fuqi të ndjeshme në treg dhe për rrjedhojë nuk vendos detyrime rregullatore.

Parë nga këndvështrimi i Rregullatorit<sup>20</sup>, parimet e përgjithshme të rregullimit në komunikimet elektronike sugjerojnë se përpara se të konsiderohet një ndërhyrje ex-ante (nga Rregullatori) duhet vlerësuar nëse masat e mundshme nga zbatimi legjislativ të konkurrencës janë të mjaftueshme për të adresuar për zgjidhje problemet e konkurrencës.

- 3) Të vijojë punën në bashkëpunim me ministrinë përkatëse për ndjekjen e procedurave të tenderimit, lidhur me dhënien në përdorim edhe të dy brezave të tjerë të lirë të frekuencave 800 MHz, për t’i hapur rrugë futjes së teknologjive dhe shërbimeve të reja broadband mobile në nivel kombëtar.

## **Realizuar**

Procesi i dhënies në përdorim të frekuencave të brezit 800 MHz ka nisur në vitin 2018. Këshilli Drejtues i AKEP miratoi dokumentin për këshillim publik për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin 800 MHz, frekuenca të cilat lejohen të përdoren nga Plani Kombëtar i Frekuencave për teknologjitë LTE (Long Term Evolution) ose siç njihen ndryshe 4G.

Bazuar në Rezultatet e Konsultimit Publik dhe bazuar në aktet nënligjore, në datën 5 korrik 2018 Këshilli Drejtues i AKEP, miratoi dokumentin e tenderit për brezin 800 MHz.

AKEP ka kryer procedurën e tenderimit për 3 (tre) të drejta përdorimi (Autorizime Individuale) të brezit 800 MHz.

Gjate vitit 2019 janë dhënë 2 (dy) të drejta përdorimi, sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a në datën 04.03.2019 dhe Telekom Albania sh.a në datën 27.09.2019. Mbetet ende e lirë për t’u dhënë 1 (një) e drejtë përdorimi gjatë vitit 2020.

Si më poshtë, disa nga arsyet që spektri i paalokuar në brezin 800 MHz, duhet të jepet me përparësi brenda vitit 2020:

1. Gjatë procedurës së parë të tenderimit të datës 07.02.2019, sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a ishte i vetmi ofertues. Vodafone Albania sh.a paraqiti vetëm një ofertë për bllokun A2, për të cilën u shpall fitues. Ky operator kishte mundësinë të ofertonte për 1, 2 ose 3 blloqet e brezit 800 MHz, por oferto vetëm për 1 (një) bllok, bllokun A2.
2. Gjatë procedurës së dytë të tenderimit të datës 09.09.2019, sipërmarrësi Telekom Albania sh.a ishte i vetmi ofertues. Telekom Albania sh.a paraqiti vetëm një ofertë për bllokun A3, për të cilën u shpall fitues. Ky operator kishte mundësinë të ofertonte për 1 ose 2 blloqet e pa alokuara të brezit 800 MHz A1 dhe A3, por oferto vetëm për 1 (një) bllok, bllokun A3.
3. Altelecom sh.a është sipërmarrësi i vetëm që nuk ka paraqitur ofertë në asnjërën prej 2 (dy) procedurave tenderuese të zhvilluara nga AKEP për brezin 800 MHz. Pra Altelecom sh.a nuk disponon frekuenca të brezit 800 MHz.

<sup>19</sup> Testi i tre kriterëve: Sqaruar edhe në footnote 1

<sup>20</sup> OFcom-Mobile Call Termination Market Review 2018-2021 Final Statement

Sa më sipër, bazuar në zhvillimet dhe situatën e brezit 800 MHz, AKEP gjatë vitit 2020 do të vijojë koordinimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për dhënien në përdorim për të drejtën e fundit të brezit 800 MHz, në mënyrë që edhe brez i paalokuar të mund të shfrytëzohet sa më parë.

- 4) Të bashkëpunojë ngushtë me MIE dhe me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) për lirim të brezit 700 MHz, sipas rekomandimeve të BE-së, si dhe të kryejë paraprakisht një proces këshillimi lidhur me përdorimin e ardhshëm të brezit 700 MHz për operatorët e rrjeteve celulare.

#### **Realizuar**

Nisur nga detyrimet e përcaktuara nga BE lidhur me lirim dhe përdorimin e brezit 700 MHz për komunikimet elektronike, gjatë vitit 2019 janë zhvilluar disa takime ndërmjet MIE, AKEP dhe AMA, ndërkohë ka pasur edhe komunikime shkresore, për dhënien e mendimeve për lirim të këtij brezi aktualisht nën administrimin e AMA.

AKEP ka marrë pjesë dhe ka ofruar ekspertizën e tij në takimet e zhvilluara përgjatë muajve shtator, nëntor dhe dhjetor nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AMA, për mënyrat e lirit të brezit 700 MHz.

Referuar këtyre takimeve AMA ka njoftuar se operatorët radiotelevizive kanë kryer investime teknologjike në frekuencat e këtij brezi, prandaj duhet një analizë e hollësishme nga ky Autoritet si për gjendjen e përdorimit të brezit 700 MHz, si dhe për zgjidhjet teknike që do t'u jepen këtyre operatorëve për lirim të këtyre frekuencave.

AKEP do të vijojë bashkëpunimin edhe përgjatë vitit 2020 me AMA dhe MIE për finalizimin e procesit të lirit të brezit 700 MHz. Pas lirit të brezit 700 MHz nga AMA dhe pas ndryshimit të Planit Kombëtar të Frekuencave për kalimin e tyre nën administrimin e AKEP, AKEP do të zhvillojë me prioritet procedurat për dhënien në përdorim të frekuencave të këtij brezi operatorëve celular, duke startuar kështu edhe shërbimet 5G në Shqipëri.

Theksojmë se, AKEP ka asistuar vazhdimisht MIE dhe ka qenë pjesë e grupeve të eksperteve për hartimin e strategjisë 5G. Gjithashtu AKEP në muajin janar 2020 ka krijuar një grup pune të posaçëm për hartimin e një studimi lidhur me implementimin dhe sfidat e teknologjisë 5G, në Shqipëri si dhe hapat që duhet të ndjekë AKEP në këtë proces.

- 5) Të punojë për nxitjen e implementimit të teknologjive të reja, nëpërmjet politikave rregullatore, të cilat sjellin rritjen e konkurrencës përmes rritjes së cilësisë, si dhe ndikojnë në ofrimin e shërbimeve më të mira dhe me eficientë në tregun e komunikimeve elektronike.

- **Realizuar**

Vendosja në përdorim të frekuencave të brezit 800 MHz, gjatë vitit 2019 nga dy sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a dhe Telekom Albania sh.a është shoqëruar edhe me investime në teknologji të reja nga këta operatorë. Për shkak se implementimi teknik i frekuencave në terren kërkon kohë të konsiderueshme, investimet e operatorëve në teknologjitë e reja do të vijojnë edhe përgjatë vitit 2020.

Vendosja në përdorim e frekuencave të brezit 800 MHz, ka rritur mbulimin me shërbime nga operatorët celularë për shkak edhe të natyrës teknike të frekuencave të këtij brezi, të cilat mbulojnë distanca më të mëdha se brezat e tjerë të frekuencave.

Frekuencat e brezit 800 MHz ofrojnë kapacitete më të larta në rrjetet celulare dhe kjo ka bërë të mundur edhe përmirësimin e shërbimeve të këtyre operatorëve, në veçanti rritjen e shpejtësive të shërbimit internet kundrejt pajtimtarëve.

Gjithashtu vlen të theksohet fakti se, Këshilli Drejtues i AKEP, Vendimin nr. 34 datë 14.10.2019, ka pajisur sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a, me Autorizim Individual për përdorim frekuencash të brezit 3600-3700 MHz, për kërkim, matje dhe provë, me afat 14.10.2019-14.12.2019. Në përfundim të këtij afati, Vodafone Albania sh.a ka njoftuar zyrtarisht AKEP për përfundimin me sukses të testimeve teknike të këtij brezi, tregues ky për fillimin e interesit për frekuencat e brezave 5G dhe tendencën për investime të vazhdueshme në teknologjitë e reja.

- 6) Të bashkëpunojë me aktorët brenda vendit dhe ata ndërkombëtarë për implementimin me sukses të marrëveshjeve për lehtësimin e tarifave të roaming me Republikën e Kosovës dhe më tej për vijimin e hapave dhe procedurave për lehtësimin e tarifave roaming me vendet e Ballkanit, sipas marrëveshjes së nënshkruar.

## **Realizuar**

Më datë 26.11.2018 në mbledhjen e përbashkët të Qeverive të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, ministritë përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike të dy vendeve nënshkruan “Marrëveshje për heqjen e çmimeve të shërbimeve roaming për rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë”.

AKEP ka bashkëpunuar ngushtësisht me MIE dhe operatorët celularë si dhe me qëllim fillimin e zbatimit të marrëveshjes, AKEP ka bashkëpunuar dhe koordinuar veprimet me autoritetin rregullator të Republikës së Kosovës (ARKEP) për përgatitjen e dokumentit të nxjerrë në këshillim publik më 15.03.2019 dhe miratimit të dokumentit më datë 11.05.2019. Kujdes i veçantë është treguar nga dy rregullatorët për koordinimin për masat përkatëse për MNO-të për vendimet e roamingut Shqipëri-Kosovë dhe ato me rajonin WB, ku të dy shtetet kanë angazhime edhe nga marrëveshja rajonale.

Bashkëpunimi rajonal për roamingun ndërkombëtar është bërë pjesë e Iniciativës së Ballkanit Perëndimor duke marrë dhe mbështetjen e Komisionit Evropian.

Procesi i negociatave dhe takimeve u finalizua më datë 4 Prill 2019 në Beograd me nënshkrimin nga gjashtë ministritë përgjegjëse për komunikimet elektronike në vendet e Ballkanit Perëndimor (për Shqipërinë nga MIE) të “Marrëveshje për reduktimin e çmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor”.

Në të gjitha këto takime AKEP ka dhënë kontribut dhe ka bashkëpunuar me MIE si dhe operatorët celularë në Shqipëri. Pas nënshkrimit të marrëveshjes rajonale AKEP ka bashkëpunuar me autoritetet rregullatore të BP nëpërmjet 2 takimeve të zhvilluara në Shkup dhe Podgoricë në maj 2019, si dhe ka bashkëpunuar me KE, RCC dhe BEREC për informacione për zbatimin e marrëveshjes.

Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP si dhe dokumentat përkatëse për rregullimin e tarifave të roaming ndërkombëtar Shqipëri – Kosovë, si dhe ato të ofruara nga sipërmarrësit, ashtu edhe rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri – Ballkani perëndimor gjenden të publikuara në faqen web: [www.akep.al](http://www.akep.al). Gjithashtu, AKEP ka përgatitur edhe udhëzime për zbatimin e detyrimeve të operatorëve celularë për roamingun me Ballkanin Perëndimor.

- 7) Të vijojë monitorimet, në bashkëpunim me Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR), lidhur me matjen e nivelit të rrezatimeve të telefonisë celulare, duke adresuar shqetësimin e publikut lidhur me ekspozimin ndaj valëve elektromagnetike të telefonave celulare, stacioneve bazë dhe transmetuesve të tyre, në mënyrë që niveli i këtyre rrezatimeve të mos tejkalojë pragun e sigurisë të përcaktuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Rrezatimet Jojonizuese (ICNIRP).

## **Realizuar**

Gjatë vitit 2019 AKEP në kuadrin e monitorimit të brezit të frekuencave që përdoren me Autorizim Individual, ka kryer edhe verifikimin e zbatimit të standardeve të miratuara nga Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Rrezatimet Jojonizuese (ICNIRP), duke kryer matje të nivelit të rrezatimeve jojonizuese, të emetuara nga antenat celulare.

Monitorimi bazohet kryesisht në matjen e emetimeve nga qelizat e telefonisë celulare, veçanërisht pranë ndërtesave të institucioneve publike me ndjeshmëri të lartë, tilla si, shkollat dhe spitalet apo dhe godinat dhe qendrat e banuara, për efektin që mund të kenë për shëndetin e publikut.

Gjatë vitit 2019 janë realizuar 25 matje në rajone të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, ku 2 prej tyre janë realizuar me kërkesë nga palët e interesuara, të cilët kanë ngritur shqetësimin për prezencën e antenave celulare në afërsi të ambienteve të punës ose banimit.

Bazuar në matjet dhe verifikimet e bëra në terren rezultoi se:

- Të dhënat e mbledhura nga matjet në terren mund të krahasohen me standardet e përcaktuara nga Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Rrezatimet Jojonizuese (ICNIRP) në dokumentin “*ICNIRP Guidelines for Limiting Exposure to Time-Varying Electric, Magnetic and Electromagnetic Fields (Up to 300 GHz)*” dhe Rregulloren “Për Mbrojtjen e Publikut nga Rrezatimet Jojonizuese”, Vendim Nr.743, datë 16.10.2012, miratuar nga Këshilli i Ministrave.
- Nivelet e matura janë vazhdimisht shumë më poshtë atyre të përcaktuara nga ICNIRP Guidelines për “*Limiting Exposure to Time Varying Electric, Magnetic and Electromagnetic fields*”.

Rezultatet e këtyre matjeve të regjistruara deri tani tregojnë se nivelet e rrezatimeve të emetuara nga antenat celulare nuk e tejkalojnë pragun e sigurisë të përcaktuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Rrezatimi Jojonizues (ICNIRP). Të gjitha matjet e kryera i janë vendosur në dispozicion Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi.

- 8) Të bëjë, gjatë vitit 2019, një vlerësim të strukturës së tregjeve të shërbimeve postare, si dhe të ketë në fokus garantimin e Shërbimit Universal Postar dhe cilësisë së shërbimeve postare në të gjithë territorin e vendit, duke i kushtuar vëmendje zgjidhjes së problemeve të identifikuara

me saktësinë e adresave dhe shpërndarjes së pakove në bashkëpunim edhe me institucionet përkatëse.

## **Realizuar pjesërisht**

Bazuar në Ligjin 46/2015 “Për Shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë”, AKEP përcakton ofruesin e shërbimit universal postar, në bazë të një procedure konkurrimi, sipas rregullave të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

AKEP ka pajisur operatorin “Posta Shqiptare” sh.a, me Autorizim Individual me afat pesëvjeçar, si ofrues i vetëm i shërbimit universal postar. Caktimi i ofruesit të shërbimit universal postar është proces i rishikimit periodik çdo 5 vjet. Në përfundim të këtij afati AKEP kryen procesin e rishikimit të parë për caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar.

**Sipas parashikimeve ligjore rishikimi parë për caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar do të kryhet gjatë vitit 2020 dhe për këtë në muajin janar 2020, AKEP ka ngritur një grup pune i cili do të kryejë analizën e zhvillimit të tregut postar.**

Ndërkohë gjatë vitit 2019, AKEP ka kryer analizat statistikore tremujore dhe vjetore të tregut të shërbimeve postare, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar. Këto analiza janë kryer bazuar në raportimet e sjella nga ofruesi i shërbimit universal postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe ofruesit e shërbimeve postare. Nga analiza e strukturës së tregut për tremujorin e tretë të vitit 2019, (të dhënat për tremujorin e katërt ende nuk janë depozituar) operatori Posta Shqiptare sh.a, zë rreth 91% të tregut postar përkundrejt ofruesve të tjerë të shërbimeve postare.

Gjithashtu, në përputhje me ligjin Nr. 46/2015 si dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji, veçanërisht lidhur me zbatimin e kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin Individual për ofrimin e shërbimit universal postar si dhe të kushteve të përcaktuara në Autorizimin Përgjithshëm, AKEP kryen në mënyrë të vazhdueshme inspektimin e veprimtarisë së ofruesit të shërbimeve universal postar Posta Shqiptare sh.a. Për më tepër detaje, ju lutem referojuni pikës 9 dhe 10 më poshtë.

Gjatë vitit 2019, AKEP ka bashkëpunuar me strukturat përkatëse në MIE për analizimin e situatës aktuale të prezencës së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit Universal Postar, dhe në kuadër të këtij bashkëpunimi ka dalë Urdhri i Ministrit nr. 469, datë 27.12.2019 “Për përcaktimin e dendësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar”.

Për sa i përket problemeve të identifikuara lidhur me dorëzimin në adresë të objekteve postare dhe me saktësimin e sistemit të adresave, AKEP, si pjesë e grupit të punës për hartimin e një dokumenti të ri të politikës postare, ka propozuar adresimin e këtij problemi pranë grupit të punës të MIE-së. AKEP do të intensifikojë përpjekjet për bashkëpunim me organet kompetente për sistemin e adresave dhe kutive postare në ndërtesa, pasi zgjidhja e problematikës së trashëguar ndër vite kërkon angazhim nga struktura të pushtetit qendror dhe lokal.

Vlen të përmendet se gjatë vitit 2020 Komisioni Evropian do të kryejë rishikim të direktivave të shërbimit postar dhe priten ndryshime të mëdha për sa i përket Shërbimit Universal Postar.

AKEP përgjatë vitit 2020 do të kryejë një analizë të strukturës të tregjeve postare, duke pasur parasysh edhe ndryshimet e këtyre direktivave.

- 9) Të kërkojë me rigorozitet nga Posta Shqiptare dorëzimin e pakove (dërgesave) në adresën e individit, si një kërkesë ligjore, zbatimin e së cilës duhet të përmbushet brenda një kohe sa më të shkurtër, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit.

## **Realizuar**

AKEP bazuar në detyrimet ligjore, ka realizuar inspektimin tek subjekti Posta Shqiptare sh.a, nga data 21.11.2018 deri në 21.01.2019. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe verifikimit të plotësisht të kushteve të Autorizimit Individual si dhe të Autorizimit të Përgjithshëm, grupi i inspektimit ka konstatuar problematika në zbatimin e nenit 12 dhe 40 të ligjit nr. 46/2015, për të cilin ka lënë rekomandimet përkatëse për Postën Shqiptare si më poshtë:

- Marrjen e masave organizative dhe teknike për shpërndarjen e të gjithë objekteve postare (pako/kolipostë) në adresën e marrësit, në përputhje me nenin 40 të Ligjit 46/2015, brenda 6 muajve të parë të vitit 2019.

Konkretisht, me shkresën nr. 2061/7 prot, datë 03.04.2019, AKEP ka kërkuar nga Posta Shqiptare sh.a planin e masave mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i inspektimit në procesverbalin përfundimtar të inspektimit të datës 12.02.2019.

Me shkresën nr. 217/3 prot, datë 15.04.2019 Posta Shqiptare sh.a informon se:

Lidhur me detyrën mbi masat organizative dhe teknike për shpërndarjen e të gjithë objekteve postare në adresë të marrësit, posta sqaron se prej vitesh ka bërë përpjekje për përmirësimin e shpërndarjes dhe dorëzimit të objekteve postare në adresë të marrësit, por formalizimi i këtyre projekteve kërkon investime serioze në logjistikë, gjë e cila sipas postës Shqiptare ka qenë e pamundur financiarisht. Për realizimin e kësaj detyre Posta Shqiptare sh.a ka aplikuar në projektet e financuara nga UPU për të mundësuar shtimin e numrit të automjeteve (flotës shpërndarëse) si dhe në programin ekonomik të vitit 2019 ka parashikuar një zë specifik dhe një fond të konsiderueshëm me qëllim shtimin e mjeteve motorike me të cilat kryhet shpërndarja e pakove të vogla dhe kolipostave në adresë të marrësit, jo vetëm në Bashkinë Tiranë por edhe për në qytetet e tjera të Shqipërisë.

Gjithashtu, nëpërmjet shkresës nr. 2061/9 prot, datë 02.05.2019, AKEP ka vijuar komunikimin me Posta Shqiptare sh.a mbi zbatimin e detyrave të lëna nga grupi i inspektimit duke sjellë në vëmendje se rekomandimet e lëna duhet të gjejnë zbatim sa më parë duke mosçenuar sigurinë e shërbimit postar për asnjë përdorues.

Në përgjigje të kësaj shkrese Posta Shqiptare sh.a me shkresën nr. 274/5 prot., datë 19.09.2019, ka informuar AKEP se:

Lidhur me masat organizative dhe teknike për shpërndarjen e të gjithë objekteve postare në adresë të marrësit, posta Shqiptare sh.a sqaron ashtu si edhe më parë se formalizimi i këtyre projekteve kërkon investime serioze në logjistikë dhe për këtë Posta Shqiptare sh.a ka aplikuar në projektet e financuara nga UPU. Aktualisht Posta Shqiptare është shpallur fituese e këtij projekti dhe ka filluar punën për kryerjen e procedurave që kërkojnë për implementimin e tij. Gjithashtu, Posta Shqiptare informon se në programin ekonomik të vitit 2019 kishte parashikuar një zë specifik dhe një fond të konsiderueshëm me qëllim shtimin e mjeteve motorike me të cilat kryhet shpërndarja e pakove të vogla dhe kolipostave në adresë, proces edhe ky në fazën e implementimit të tij.

Subjekti ofruer i shërbimit universal postar Posta Shqiptare sh.a, vijon edhe pas lënies së rekomandimeve të mos dorëzojë një pjesë të mirë të pakove në adresë të marrësit, por dorëzimin e tyre pranë zyrave postare, duke ndjekur procedurën e njoftimit me shkrim dhe nëpërmjet telefonit.

Për ndreqjen e këtyre parregullsive, gjatë vitit 2019, janë dhënë masa administrative dhe rekomandime përkatëse me detyra për t'u plotësuar.

Sa më lart, rezulton se Posta Shqiptare sh.a përgjatë vitit 2019, nuk ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe detyrat e lëna nga AKEP, në lidhje me shmangien e parregullsive dhe përmirësimin e situatës për marrjen e masave të menjëhershme për dorëzimin e objekteve postare (pako/kolipostë) me peshë mbi 2 kg në adresë të marrësit.

Në lidhje me këtë pikë të rezolutës, AKEP vijon të monitorojë rekomandimet e lëna edhe për vitin 2020.

AKEP në muajin dhjetor 2019 ka filluar një proces inspektimi të Posta Shqiptare sh.a ku pjesë e objektit të inspektimit janë dhe masat e marra nga Posta Shqiptare për dërgimin e pakove postare në adresë të marrësit. Për shkak të situatës së jashtëzakonshme nga tërmeti, inspektimi është shtyrë me kërkesë të Posta Shqiptare sh.a dhe pritet të përfundojë brenda muajit Janar 2020.

10) Të marrë masa, brenda vitit 2019, që qytetarët (konsumatorët) të mos paguajnë tarifa dhe kosto shtesë për marrjen e pakove (dërgesave) nga Posta Shqiptare, praktikë sipas të cilës qytetarët duhet të shkojnë ta tërheqin pakon (dërgesën) në zyrat e postës kundrejt një pagese, në vend që ta marrin në adresë pakon (dërgesën).

## **Realizuar**

Siç u sqarua dhe në pikën 9 të rekomandimeve, AKEP ka realizuar inspektimin tek subjekti Posta Shqiptare sh.a, ku ndër të tjera ka konstatuar moszbatueshmëri të përcaktimeve ligjore të nenit 30 dhe 34 të ligjit nr. 46/2016, si pasojë grupi i inspektimit ka konstatuar dhe ka lënë rekomandimet përkatëse si më poshtë:

- Marrjen e masave për heqjen e menjëhershme të tarifës shtesë, pasi është në kundërshtim me frymën ligjit dhe parimet e Rregullores së Shërbimit Postar Universal të UPU, ku për objektet që dorëzohen nga Posta Shqiptare, detyrimet terminale të përfituara nga Posta Shqiptare reflektojnë kostot për përpunimin dhe shpërndarjen e objekteve.

AKEP ka kërkuar nga Posta Shqiptare sh.a planin e masave mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i inspektimit në procesverbalin përfundimtar të inspektimit datë 12.02.2019.

Me shkresën nr. 217/3 prot, datë 15.04.2019 Posta Shqiptare sh.a informon se:

Lidhur me detyrën e marrjes së masave mbi rishikimin e Vendimit Nr. 05, datë 30.01.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Postës Shqiptare me qëllim rregullimin e problematikës së konstatuar mbi tarifimin e marrësit për tërheqjen e pakove postare, Posta Shqiptare sh.a sqaron se kjo tarifë është vjelë në kushtet kur kostot e brendshme të shërbimeve kanë qenë dhe janë shumë të larta dhe kërkesat për rritjen e disa tarifave pjesë e shërbimeve universale postare nuk kanë konkluduar me rritjen e tyre nga strukturat vendimmarrëse. Gjithsesi Posta Shqiptare sh.a informon se do të shqyrtojë mundësinë dhe do të kryejë përpjekje për heqjen e tarifës së dorëzimit të objekteve postare e kolipostare por duke konsideruar faktin se të ardhurat e gjeneruara nga ky zë i shërbimeve janë pjesë përbërëse e programit ekonomik 2019.

Gjithashtu me shkresën nr. 2061/9 prot., datë 02.05.2019, AKEP ka vijuar komunikimin me Posta

Shqiptare sh.a mbi zbatimin e detyrave të lëna nga grupi i inspektimit duke sjellë në vëmendje se rekomandimet e lëna duhet të gjejnë zbatim sa më parë. Në përgjigje të kësaj shkresë Posta Shqiptare sh.a me shkresën nr. 274/5 prot., datë 19.09.2019, ka informuar AKEP se:

Lidhur me marrjen e masave mbi rishikimin e Vendimit Nr. 05, datë 30.01.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Postës Shqiptare me qëllim rregullimin e problematikës së konstatuar mbi tarifimin e marrësit për tërheqjen e pakove postare, Posta Shqiptare sh.a sqaron se ky tarifim është vjelë në vijimësi që prej vitit 2002 në kushtet kur kostot e brendshme të shërbimeve kanë qenë dhe janë shumë të larta dhe kërkesat për rritjen e disa tarifave pjesë e shërbimeve universale postare nuk kanë konkluduar me rritjen e tyre nga strukturat vendimmarrëse. Në kushtet kur adresari i ri ende nuk ka përfunduar dhe kur qytetarët përdorin për të njëjtën vendndodhje adresa të ndryshme, posta detyrohet të kryej disa tentativa përpara se të kryejë dorëzimin final, duke rritur ndjeshëm kostot e shërbimit.

Gjithsesi, Posta Shqiptare sh.a informon se e ndodhur në kushtet kur programi ekonomik – financiar i vitit 2019, është drejt fundit, posta e ka të pamundur heqjen e tarifës së dorëzimit të objekteve postare e kolipostare deri në fund të vitit 2019. Edhe sikur kjo tarifë të hiqet (në kushtet kur të ardhurat prej saj përbëjnë gati 50 % të fitimit vjetor bruto të Postës Shqiptare), kjo e fundit do të merrte në konsideratë mundësinë e rritjes së disa tarifave të tjera me qëllim kompensimin e diferencës së të ardhurave.

AKEP në zbatim të detyrimeve ligjore, po vijon përgjatë muajit janar 2020, të ushtrojë veprimtarinë inspektuese me qëllim mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së subjektit Posta Shqiptare sh.a. Në muajin dhjetor 2019 ka filluar një proces inspektimi të Posta Shqiptare sh.a, por për shkak të situatës së jashtëzakonshme nga tërmeti, inspektimi është shtyrë me kërkesë të Posta Shqiptare sh.a dhe pritet të përfundojë brenda muajit Janar 2020.

11) Të intensifikojë aktivitetin e tij përmes grupit të punës, i ngritur në vitin 2018, në lidhje me kushtet teknike të zbatuara nga operatorët, si dhe të zbatojë masa administrative, sipas ligjit, në rastet e shkeljeve, duke konsideruar problemin e kablllove ajrore apo atyre të vendosura në shtyllëzimet elektrike, si dhe përdorimi i përbashkët i infrastrukturës, si një problem i cili vijon të mbetet shqetësues.

## **Realizuar**

AKEP edhe gjatë vitit 2019, ka vijuar punën për zbatimin nga sipërmarrësit dhe operatorët të ligjit Nr. 9918/2008 dhe kushteve teknike që përcaktojnë aktet nënligjore lidhur me infrastrukturën e rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndër urbane.

Nga strukturat përkatëse është punuar për detyrimin e sipërmarrësve, të cilët ndërtojnë ose përdorin rrjete të komunikimeve elektronike, që të zbatojnë me rigorozitet kërkesat dhe kushtet teknike të rregulloreve të parashikuara në legjislacion, si dhe është kryer një fushatë verifikimesh në terren për të konstatuar problematikat përkatëse në këtë fushë.

Duke qenë një problematikë komplekse infrastruktura në fjalë kërkon monitorim të vazhdueshëm, dhe koordinim gjithëpërfshirës midis aktorëve në këtë proces AKEP, organeve të pushtetit vendor, OSHEE dhe sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike.

Kjo çështje do të ndiqet me prioritet dhe për vitin 2020, në mënyrë që të intensifikohet puna në zonat dhe qytetet ku shfaqen problematika të ndërthurjes së rrjeteve të ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike. Për rrjedhojë, AKEP ka planifikuar në inspektimin vjetor për vitin 2020 verifikimin e zbatueshmërisë ligjore konkrete të implementimit të kushteve teknike për ndërtimin

e infrastrukturës së rrjeteve kabllore dhe rrjeteve me fibra optike ndër-urbane të komunikimeve elektronike në bashkitë kryesore të vendit.

AKEP gjithashtu ka shqyrtuar dhe i ka dhënë zgjidhje ankesave të ndryshme të mbërritura nga subjekte apo individë, lidhur me problematikat e kabllave dhe linjave në fasadat e godinave të banimit dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike në zona të caktuara të qytetit të Tiranës dhe gjetkë.

Këmbëngulja nga AKEP në kërkesën për zbatimin me rigorozitet të ligjit nr. 9918/2008 dhe kritereve të përcaktuara në Rregulloren Nr. 22, datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore dhe rrjeteve me fibra optike ndër-urbane të komunikimeve elektronike”, ka bërë që të rritet përgjegjshmëria tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, pasi rezulton se sistemimet e kabllave dhe rrjeteve bëhen në mënyrë më të kujdesshme dhe shumë operatorë tashmë përdorin instalime të teknologjive bashkëkohore me preferencë fibrën optike (Fiber To The Home, FTTH).

Duhet vënë në dukje se, sipërmarrësit e komunikimeve elektronike vazhdojnë të kenë shqetësimin për sa i përket mundësive të krijuara nga organet e pushtetit vendor për shtrimin e infrastrukturës nëntokësore dhe dhënien e lejeve të ndërtimit për këtë infrastrukturë të domosdoshme për rrjetet e tyre të komunikimeve elektronike.

Gjithashtu, këta sipërmarrës hasin vështirësi deri edhe në pengesa për të drejtat e përdorimit të infrastrukturës fizike teknike të përbashkët, nën administrimin e bashkive, për shkaqe subjektive të administratorëve të këtyre godinave.

Pavarësisht interesimit dhe përpjekjeve të AKEP përmes komunikimeve shkresore për të nxitur organet kompetente të pushtetit vendor në përdorimin e autoritetit të tyre në përputhje me legjislacionin përkatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, por ky problem akoma nuk ka arritur të marrë zgjidhjen e duhur në shumë bashki të vendit.

AKEP nuk ka kompetenca për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe administratorëve të objekteve si dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe administratorëve për sa i përket shërbimeve të aksesit në godinat që këta të fundit administrojnë.

AKEP mbetet i gatshëm për të kontribuar në koordinimin e punës në nivel ndërinstitucional në mënyrë që sipërmarrësit dhe të gjithë operatorët e tregut të komunikimeve elektronike të gjejnë ligjshmërinë e domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së tyre në ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike ndaj qytetarit në nivelet dhe standardet e kërkuara.

AKEP në bashkëpunim me pushtetin lokal ka ndjekur hapat zhvillimor për infrastrukturën nëntokësore duke detyruar sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për të kaluar infrastrukturën ajrore në tubacionet e reja nëntokësore. Vlen për t’u përmendur bashkëpunimi i frytshëm me Bashkinë e Tiranës për këtë problematikë.

Me gjithë punën e bërë për ndërgjegjësimin e sipërmarrësve dhe operatorëve të komunikimeve elektronike për të zbatuar me rigorozitet kërkesat e rregullores dhe ligjit, ka akoma probleme që kërkojnë angazhim nga ana e AKEP, por për të siguruar efikasitet në zgjidhjen e këtij problemi, ashtu si më parë do të duhet të vazhdojë bashkërendimi i punës midis AKEP, OSHEE dhe Bashkive, ku nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi midis tre institucioneve do të shmangte vonesat në ndërhyrjen për përmirësimin e situatës.

- 12) Të punojë për ngritjen e një regjistri “Do Not Call Me”, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, për të rregulluar aktivitetet e tele-marketuesve që bëjnë thirrje telefonike të padëshiruara për individë privatë. Skema e regjistrimit do të mundësojë përdoruesit që të bëjnë “opt-out”, pra të mos marrin thirrje të pa kërkuara nga kompanitë tele-marketing.

### **Pa Realizuar**

AKEP me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 20, datë 22.05.2019, ka miratuar dokumentin për këshillim publik “Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike” e cila përfshin ndër të tjera si Aneks të veçantë detyrimet që operatorët e shërbimeve telefonike publike kanë për krijimin e data bazave përkatëse si dhe për krijimin e regjistrit kombëtar “Do Not Call Me”. Dokumenti u publikua në faqen zyrtare të AKEP më datë 11.06.2019 dhe këshillimi publik u mbyll më datë 13.09.2019.

AKEP pas përfundimit të këshillimit publik dhe marrjes së komenteve nga të gjitha palët e interesuara, zhvilloi një takim me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit (KMDPI), për të diskutuar mbi Aneksin 1 të draft-Rregullores për krijimin e regjistrit “Do Not Call Me” dhe masat e nevojshme për respektimin e të drejtës së pajtimtarëve për mos të marrë thirrje të pa kërkuara nga shoqëritë tregtare.

Dokumenti i rregullores së konsumatorit, i cili përmban krijimin e regjistrit përcakton detyrime për sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve publike telefonike për të regjistruar zgjedhjen e pajtimtarit për thirrjet e pa kërkuara sikundër edhe për shoqëritë tregtare të marrin akses në këtë regjistër.

Sqarojmë se AKEP nuk ka kompetenca ligjore për të vendosur masa administrative ndaj shoqërive tregtare që nuk respektojnë zgjedhjen e pajtimtarit. Ndërkohë kjo mundësi ekziston për Komisionerin e të dhënave personale, nëpërmjet përcaktimeve të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

AKEP është në proces të miratimit të dokumentit final të rregullores, përfshirë dhe përcaktimet për regjistrin “Do Not Call Me”.

- 13) Të vijojë punën, gjatë vitit 2019, për konsolidimin dhe reduktimin e rregulloreve ekzistuese, duke pasur parasysh jo vetëm rregulloret lidhur me mbrojtjen e konsumatorit, por edhe ato të cilat kanë të bëjnë me aktorët e tjerë në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare.

### **Realizuar**

AKEP nëpërmjet Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 20, datë 22.05.2019, ka miratuar dokumentin për këshillim publik “Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike” e cila ndër të tjera parashikon një konsolidim nga 3 në 1 të rregulloreve aktuale.

AKEP pas përfundimit të këshillimit publik 13.09.2019 dhe marrjes së komenteve nga të gjitha palët e interesuara, si dhe takimeve të zhvilluara pas këshillimit publik me Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit (KMDPI), Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe operatoreve celularë, është në proces të miratimit të versionit final të rregullores.

Gjithashtu, AKEP ka përgatitur dhe është në proces të miratimit të unifikimit të Rregullores “Metodika

e Inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” dhe Rregullores “Metodika e Inspektimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare” në një të vetme, ndërkohë që akti në fjalë do të dalë në këshillim publik dhe më pas do të miratohet nga organet drejtuese të AKEP.

14) Të bashkëpunojë me MIE në përgatitjen dhe implementimin e akteve nënligjore të ligjit 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, si dhe të luajë një rol proaktiv në lehtësimin dhe zbatimin e rregullave të reja që pritet të miratohen, me qëllim promovimin e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës, investimet e përbashkëta në rrjete dhe koordinimin e punëve civile, si dhe aksesin në rrjetin e brendshëm të ndërtesave.

### **Realizuar**

AKEP në kuadër të bashkëpunimit institucional ka dhënë kontributin e tij në përpunimin e akteve nënligjore, si dhe në dhënien e vlerësimeve, ndihmesës dhe ekspertizës së tij, sa herë i është kërkuar nga MIE.

AKEP ka qenë pjesë aktive e grupeve përkatëse të punës të udhëhequra nga MIE.

15) Të marrë masa për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me rregullat e BE-se për sigurinë kibernetike, si dhe të rrisë më tej bashkëpunimin me Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike (ALCIRT), në lidhje me identifikimin e kërcënimeve të mundshme kibernetike dhe njoftimin e operatorëve në kohën e duhur për të marrë masa të menjëhershme.

### **Realizuar**

AKEP ka ndjekur me rigorozitet procesin e zbatimit nga ana e sipërmarrësve të detyrimeve ligjore lidhur me marrjen e masave për sigurinë e rrjeteve dhe/ose shërbimeve. AKEP ka administruar raportimet e masave të sigurisë dorëzuar nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe ka vlerësuar nëse këto raporte dhe masat teknike dhe organizative të përcaktuara, janë konform me përcaktimet e nenit 122 “Masat Mbrojtëse”, të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe me Rregulloren Nr.37, datë 29.10.2015 “ Mbi Masat Teknike dhe Organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

Në fokus në vitin 2019 ka qenë kontrolli i sipërmarrësve nëse në faqet e tyre elektronike kanë publikuar një udhëzim të dukshëm në lidhje me ndërgjegjësimin dhe njohjen e publikut rreth rreziqeve, sulmeve dhe incidenteve më të zakonshme të sigurisë, ku pjesë e rëndësishme e saj është siguria e fëmijëve në internet.

Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike kanë detyrimin e dërgimit të një raporti pranë AKEP, i cili përfshin informacion mbi masat e duhura teknike dhe organizative në fushat e sigurisë.

Gjatë vitit 2019 nga 203 sipërmarrës të komunikimeve elektronike:

- 158 sipërmarrës kanë depozituar në AKEP, raportin mbi masat teknike dhe organizative të sigurisë në përputhje me Rregulloren Nr.37, datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe

organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;

- 45 sipërmarrës nuk e kanë dërguar/depozituar këtë raportim.

Monitorimi i kësaj çështjeje, do të jetë përparësi për vitin 2020.

AKEP ka komunikuar dhe bashkëpunuar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe UNICEF-in në lidhur me hartimin e udhëzimit “Masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe /ose të dëmshme në internet”.

AKEP ka komunikuar dhe bashkëpunuar me AKCESK në lidhje me hartimin e strategjisë për sigurinë kibernetike.

Si dhe gjatë vitit 2019 është rritur bashkëpunimi me AKCESK në lidhje me identifikimin e kërcënimeve kibernetike, sulmeve apo incidenteve kibernetike dhe njoftimin e sipërmarrësve në kohën e duhur për marrjen e masave të menjëhershme. Për vitin 2019, janë raportuar nga AKCESK 5 raste në lidhje me incidente apo sulme kibernetike, të cilat u janë dërguar menjëherë sipërmarrësve të komunikimeve elektronike.

- 16) Të bashkëpunojë me institucionet e tjera shtetërore për të bërë të mundur që deri në fund të vitit 2019 të finalizohet zbatimi në të gjithë Shqipërinë i përdorimit të numrit të emergjencës 112, përfshirë edhe identifikimin e vendndodhjes nga gjenerohet thirrja.

## **Pa Realizuar**

Numri 112 është pjesë e planit të numeracionit bazuar në ligjin 9918/2008 dhe të gjithë operatorët e rrjeteve publike telefonike kanë detyrim të rrugëzojnë thirrjet drejt këtij numri dhe operatorët kryesorë janë duke e kryer këtë.

Ndërkohë, implementimi efektiv i numrit unik të emergjencave 112, mbetet ende problematik dhe kërkon koordinim midis strukturave përkatëse që trajtojnë llojet dhe numrat e ndryshme të emergjencave dhe operatorëve të telekomunikacioneve të cilët rrugëzojnë në mënyrën e duhur thirrjet drejt numrit 112. Për këtë AKEP mendon se është i nevojshëm hartimi i një akti nënligjor nga strukturat përkatëse për trajtimin e thirrjeve drejt numrit 112 dhe numrave të tjerë të emergjencave.

Një rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet kapaciteteve të pajisjeve teknike si dhe stafit të strukturave të emergjencave për trajtimin e këtyre thirrjeve, për të bërë të mundur përdorimin e elementëve të avancuar që mundësojnë aparatet dhe rrjetet celulare.

Implementimi i këtij numri ka nisur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë nëpërmjet një projekti të financuar nga BE dhe po realizohet me disa faza duke nisur si projekt pilot me qytetin e Tiranës. AKEP me iniciativën e vet ka filluar këtë proces në vitin 2018, ku ka organizuar takime me shumicën e strukturave të emergjencave dhe operatorët kryesorë të telefonisë, si dhe gjatë vitit 2019, ka vijuar takimet me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

Dokumenti “Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të

komunikimeve elektronike publike” nxjerrë në këshillim publik ka të përfshirë një nen të veçantë për detyrimet e operatorëve për aksesin e pajtimtarëve në shërbimet e emergjencës dhe përcjelljen nga operatorët tek organet kompetente të emergjencave që trajtojnë këto thirrje, si dhe informacionin për vendndodhjen e numrit thirrës (Caller Location Information). Për thirrjet nga rrjetet celulare, operatori celular i transmeton automatikisht platformës përkatëse së numrave të emergjencës informacion mbi vendndodhjen e thirrësit bazuar në informacionin e rrjetit (network based information) si dhe në raste kur është teknikisht e mundur (në varësi të llojit/modelit të aparatit celular) dhe informacionin mbi vendndodhjen në bazë të aparatit celular.

Në kuadër të monitorimi për zbatimin e Vendimeve me nr.21-24, datë 24.06.2019 dhe Udhëzimeve përkatëse, AKEP gjatë periudhës Korrik – Shtator 2019 ka kryer inspektime te tre operatorët celularë, dhe në përfundim të procedurës së inspektimit pas konstatimeve të disa problematikave, ka lënë detyra dhe rekomandime përkatëse.

Nga monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Vendimeve dhe Udhëzimeve të AKEP të nxjerra në zbatim të RRA janë këto rezultate:

- Të tre operatorët celularë në Shqipëri kanë respektuar tavanet e përcaktuara madje duke ofruar tarifa edhe më të ulëta se këto tavane për pajtimtarët e tyre.
- Vodafone Albania nuk ka pasur nevojë për zgjidhjen alternative të përkohshme për përdoruesit e paketave aktive domestike, të aplikuar nga gjithë operatorët e tjerë celularë në rajon, dhe ka filluar aplikimin e Udhëzimit të AKEP prej datës 1 korrik 2019 për BP dhe prej datës 15.06.2019 për roamingun me Kosovën.
- Altelecom ka njoftuar se prej datës 11 dhjetor 2019 ka filluar aplikimin e Udhëzimit të AKEP për përdoruesit aktivë të paketave domestike (me parapagim dhe paspagim), duke çuar në ulje të mëtejshme të tarifave të përdoruesve për roamingun në BP.
- Telekom Albania ka filluar aplikimin e Udhëzimit pa zbritje të njëjësive nga paketa domestike nga data 24.12.2019.

## ANEKS 2







### VENDIMET E KËSHILLIT DREJTUES TË AKEP PËR VITIN 2019

Vendimi	Data	Titulli i Vendimit
Nr.1	15.01.2019	Për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të subjektit “Unifi Holding Inc, Dega Shqipëri”, me objekt anulimin e vendimit për dënimin me gjobë me nr. serie 000145, nr.152, datë 16.12.2018”
Nr.2	15.01.2019	“Shqyrtimi i ankimit administrativ të sipërmarrësit “Egis-Tel 2004” sh.p.k., kundër vendimit përfundimtar të inspektimit nr.176 datë 03.12.2018”
Nr.3	01.02.2019	Mbi “Shqyrtimin e kërkesës së sipërmarrësit “ Telekom Albania sh.a” për shtyrjen e mëtejshme të datës së zhvillimit të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz)”, ref. 1x10 MHz i çiftuar -800-2018”, miratuar me vendim të KD nr. 42, datë 05.07.2018”
Nr.4	11.02.2019	Për “Disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ administrativ “Rregullore për funksionimin e administratës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.06, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP, i ndryshuar”
Nr.5	19.02.2019	Për “Miratimin e raportit përmbledhës të KVO-së, njoftimin e fituesit dhe botimin e fituesit të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: «Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz(792-862 MHz) ref. 1x10 MHz i çiftuar -800-2018”
Nr.6	04.03.2019	Për “Miratimin e Autorizimit Individual sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a për përdorimin e frekuencave blloku A2, 801-811 MHz(10 MHz), i çiftuar me 842-852 MHz (10MHz), të brezit 800MHz (792-862-MHz) të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz), ref. 1x10 MHz i çiftuar -800-2018”, zhvilluar në AKEP datë 07.02.2019”
Nr.7	15.03.2019	Për “Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Rregullimi i tarifave të Roaming-ut midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës”
Nr.8	21.03.2019	Për “Dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e transaksionit të pritshëm për shitjen e aksioneve të sipërmarrësit Telekom Albania sh.a”
Nr.9	28.03.2019	“Mbi kërkesën e sipërmarrësit Albtelecom sh.a. për ndryshimin e Autorizimit Individual të përdorimit të frekuencave 900 MHz dhe 1800 MHz.
Nr.10	17.04.2019	Për “Miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”
Nr.11	17.04.2019	Për “Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregut me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare”
Nr.12	17.04.2019	Për “Miratimin e raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2018”

Nr.13	26.04.2019	Për “Miratimin e raportit përmbledhës të vlerësimit “Mbi përmbushjen e kushteve të përdorimit të frekuencave GSM 900 dhe GSM 1800 të sipërmarrësit Albtelecom sh.a., të shoqëruar me propozimin për çmimin referencë minimal, për rinovimin e Autorizimit Individual”
Nr.14	07.05.2019	Për “Miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor “”
Nr.15	11.05.2019	Për “Miratimin e Dokumentit “Rregullimi i tarifave të shërbimeve Roaming Ndërkombëtar Shqipëri-Kosovë, Dokumenti përfundimtar”
Nr.16	11.05.2019	Për “Rregullimin e shërbimeve dhe tarifave Roaming Ndërkombëtar, Shqipëri-Kosovë të ofruara nga sipërmarrësi Albtelecom sh.a”
Nr.17	11.05.2019	Për “Rregullimin e shërbimeve dhe tarifave Roaming Ndërkombëtar, Shqipëri-Kosovë të ofruara nga sipërmarrësi Telekom Albania Sh.a”
Nr.18	11.05.2019	Për “Rregullimin e shërbimeve dhe tarifave Roaming Ndërkombëtar, Shqipëri-Kosovë të ofruara nga sipërmarrësi Vodafone Albania Sh.a”
Nr.19	20.05.2019	Për “Përdorimin e komisionit të përfituar si agjent tatimor, nga AKEP, në formën e shpërblimit për vështirësi në punë, për vitin 2019”
Nr.20	22.05.2019	Për “Miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”
Nr.21	24.06.2019	Për “Miratimin e dokumentit “Rregullimi i tarifave të shërbimeve Roaming Ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor, dokumenti përfundimtar”.
Nr.22	24.06.2019	Për “Rregullimin e shërbimeve dhe tarifave roaming ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor, të ofruara nga sipërmarrësi Telekom Albania sh.a”
Nr.23	24.06.2019	Për “Rregullimin e shërbimeve dhe tarifave roaming ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor, të ofruara nga sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a”
Nr.24	24.06.2019	Për “Rregullimin e shërbimeve dhe tarifave roaming ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor, të ofruara nga sipërmarrësi Albtelecom sh.a”
Nr.25	23.07.2019	Për “Shtyrjen e afatit të këshillimit publik për dokumentin: “Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”
Nr.26	23.07.2019	Mbi “Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit “Netsyscom sh.p.k” kundër masës administrative të dënimit me gjobë”
Nr.27	25.07.2019	Mbi “ Vrijimin e procedurës së zhvillimit të tenderit publik për dhënien në përdorim të frekuencave në brezin 800 MHz, spektri i paalokuar”
Nr.28	01.08.2019	Për “Miratimin e dokumentit të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz, spekter i paalokuar” dhe njoftimin për tenderin publik, ref.1x10 MHz i çiftuar-800-2019
Nr.29	16.08.2019	Vendim i ndërmjetëm për “Shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual në brezat 900 MHz dhe 1800 MHz të sipërmarrësit Albtelecom sh.a”

Nr.30	20.08.2019	Për "Shqyrtimin e ankimit administrativ të "Fondacionit ABC", kundër masës administrative të dënimit me gjobë"
Nr.31	29.08.2019	Për "Ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz spekter i paalokuar" ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2019"
Nr.32	20.09.2019	"Mbi miratimin e raportit përmbledhës të KVO-së, njoftimin e fituesit dhe botimin e fituesit, të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz) spekter i paalokuar" ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2019"
Nr.33	27.09.2019	"Për miratimin e Autorizimit Individual të sipërmarrësit Telekom Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave blloku A3: 811-821 MHz (10 MHz) i çiftuar me 852-862 MHz (10 MHz) të brezit 800 MHz (790-862 MHz), të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz), spekter i paalokuar, ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2019", zhvilluar në AKEP datë 09.09.2019
Nr.34	14.10.2019	"Për pajisjen e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a me Autorizim Individual për përdorim frekuencash në brezin 3600-3800 MHz, për kërkim, matje dhe provë"
Nr.35	14.10.2019	"Mbi shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Neofone sh.p.k"
Nr.36	14.10.2019	Për miratimin e dokumentit "Plani i masave organizative për verifikimin/identifikimin e subjekteve që ofrojnë shërbimin e tranzitimit të thirrjeve telefonike ndërkombëtare"
Nr.37	31.10.2019	Për "Miratimin e rinovimit të Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz dhe 1800 MHz të sipërmarrësit Albtelecom sh.a."
Nr.38	31.10.2019	Për një ndryshim në VKD nr.21, date 01.12.2017, për "Dhënia e Autorizimit Individual, rrjedhë e përfundimit të procedurës së miratimit paraprak të transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication sh.a, të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a."
Nr.39	31.10.2019	"Caktimi i fondit të shpenzimeve administrative dhe projektbuxhetin e vitit 2020 të AKEP"
Nr.40	15.11.2019	"Për miratimin për këshillim publik të dokumentit "Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio"









# 2019

RAPORTI VJETOR



**AKEP**  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE